



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 486 Akti

Nr. 636 Vendimi
Tiranë, më 15.3.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 9.3.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0 (*underground*), salla B, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arben Kostandini**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, subjektin e rivlerësimit Arben Kostandini, vëzhguesin ndërkombëtar z. Francesco Ciardi, pasi shqyrtoi në seancën dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Kostandini ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Olsi Komici.
3. Me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Arben Kostandini, si dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues komisioneren Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Francesco Ciardi.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për të tria kriteret e vlerësimit.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 16.2.2023 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Arben Kostandini, bazuar në të tria kriteret, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 16.2.2023 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka dërguar nëpërmjet *email*-it datë 3.3.2023 prapësimet dhe provat pranë Komisionit, në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.
9. Komisioni, me anë të postës elektronike, në datën 6.3.2023, njoftoi subjektin për seancën dëgjimore të datës 9.3.2023 (ora 13:00).

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 9.3.2023 (ora 14:30), salla B, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

11. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, duke u mbrojtur edhe me përfaqësuesen ligjore, av. A. S. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Z. Arben Kostandini ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b, Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

14. Për subjektin e rivlerësimit Arben Kostandini, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin tri kritere: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

15. ILDKPKI-ja ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm e të arsytuar¹. Në përfundim të veprimeve verifikuese, bazuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

16. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacioneve të marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vëren se në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë, sipas nenit 31/1² të ligjit nr. 84/2016, subjekti

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2018, dërgohet nga ILDKPKI-ja akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Arben Kostandini.

² Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

Arben Kostandini ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 25.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi³. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar pasuritë si vijon:

❖ Pasuritë e subjektit të rivlerësimit

1. Apartament me sip. 75.2 m², në rrugën “****”, pallati “****”, shk. ****, ap. ****, Tiranë dhe shtesë anësore me sip. 40 m², në proces legalizimi. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: kontratë privatizimi datë 9.11.1993. Trashëgimia e babait me vendimin nr. ****, datë 10.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Trashëgimia e nënës sipas aktit noterial nr. ****, datë 12.3.2015. Kontrata e privatizimit dhe shtesa anësore është paguar nga prindërit e subjektit. Kontratë dhurimi nr. ****, datë 18.9.2015, nga vëllai R. K.

1.1 Këtë pasuri, subjekti e ka deklaruar që nga DIPP-ja e vitit 2003 e në vijim. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Kontratë dhurimi nr. ****, datë 18.9.2015. Dhuruar 3/9 pjesë e pasurisë apartament 2+1, me nr. pasurie ****, z. k. ****. Pjesa 3/9 e pasurisë”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.2 Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti, ndër të tjera, ka depozituar: (a) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 25.9.2015, ku subjekti figuron pronar i vetëm i pasurisë së llojit “apartament” me sip. 75.50 m², me nr. ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****; (b) kontratë shitjeje⁴ datë 6.1.1994, e lidhur midis shitësit Ndërmarrje Komunale Banesa nr. **** dhe blerësve F., N. dhe Arben Kostandini, për shitjen e apartamentit 2+1 në katin 3, kundrejt çmimit 1,572 lekë; (c) kontratë privatizimi datë 9.11.1993, e lidhur midis palëve si më lart, për të njëjtin apartament; (ç) vendim gjyqësor nr. **** datë 10.11.2011⁵, për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë, që përcakton si trashëgimtarë ligjorë të shtetasit F. K. bashkëshorten N. dhe dy djemtë e tij Arben e R. K.; (d) vendim⁶ datë 10.11.2011, për dëshminë e trashëgimisë, që përcakton si trashëgimtarë ligjorë të shtetasit N. K. dy djemtë e saj Arben e R. Kostandini; (dh) kontratë dhurimi⁷ datë 18.9.2015, ku shtetasi R. K. i dhuron subjektit pjesën e tij të apartamentit; (e) formular vetëdeklarimi në emër të subjektit për legalizimin e shtesës së apartamentit; (ë) vërtetim nr. ****, datë 23.1.2017, nga ALUIZNI (Drejtoria Tirana ****).

1.3 ALUIZNI, Drejtoria Tirana ****, konfirmon⁸ se z. Arben Kostandini është subjekt i ligjit nr. 9482/2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” me anë të formularit të vetëdeklarimit për legalizim nr. ****, datë 14.11.2006. Bashkëlidhur formularit është edhe kërkesa për legalizim nr. ****, datë 14.11.2006, që subjekti i ka drejtuar Njësisë Bashkiake Nr. ****, në të cilën subjekti nuk ka deklaruar vitin se kur i ka kryer punimet për shtesën e apartamentit.

1.4 ASHK Drejtoria Tirana Veri, me vendimin nr. ****, datë 13.4.2021, konfirmon⁹ se në emër të subjektit është legalizuar shtesa anësore me sip. 41 m² në katin e dytë të pallatit ekzistues ku ai ka

³ Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.16 ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri më 19.1.2017. Në datën 18.1.2017 Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.1.2017. Si rezultat, afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31.1.2017.

⁴ Kontratë shitjeje nr. ****, datë 6.1.1994.

⁵ Vendim nr. ****, datë 10.11.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁶ Vendim noterial nr. **** rep., nr. **** kol., datë 12.3.2015, i noteres Dh. Q.

⁷ Kontratë dhurimi nr. ****, datë 18.9.2015.

⁸ Me shkresën nr. **** prot., datë 20.9.2018, të ALUIZNI-it, Drejtoria Tirana ****, drejtuar ILDKPKI-së (dosja *Vetting*).

⁹ Shkresë nr. **** prot., datë 8.11.2022, e ASHK Drejtoria Tirana Veri, drejtuar Komisionit.

në pronësi apartamentin me sip. 75.2 m² dhe se subjekti ka paguar¹⁰ taksën përkatëse në vlerën 6,590 lekë.

1.5 Në pyetësin nr. 2, subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me vlerën e investuar për ndërtimin e shtesës, duke deklaruar se ndërtimi i shtesës është bërë në vitin 1996 - 1997 si shtesë anësore e pallatit 5-katësh, ***, shkalla ***, ku ai banonte dhe është në funksion të apartamentit ekzistues. Vlera e investimit është rreth 400,000 lekë, krijuar nga kursimet familjare ndër vite. Punimet janë kryer me 6 punëtorë ndërtimi, prandaj subjekti nuk disponon preventiva apo fatura për këtë ndërtim. Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar aktet e përmendura në përgjigje, planimetrinë e shtesës anësore të katit të dytë, si dhe raportin e vlerësimit teknik të kryer nga ekspert privat në lidhje me vlerën e ndërtimit që ka rezultuar 381,852 lekë. Në vijim, subjekti deklaroi se në lidhje me mobilimin e shtesës ka përdorur mobiliet ekzistuese, si dhe ka depozituar deklaratën noteriale¹¹, ku shtetasi L. S. deklaroi se është djali i tezes dhe për apartamentin e ri i ka bërë disa mobilie të reja, si dhe i ka përshtatur disa prej tyre që i ka pasur në apartamentin e mëparshëm. Këto punime ia ka bërë falas nisur nga marrëdhënia e veçantë.

1.6 Për sa më lart, duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar dhe nuk ka paraqitur dokumentacion të kohës se kur ka kryer punimet për shtesën e apartamentit, Komisioni ka vlerësuar të marrë në konsideratë si vit ndërtimi vitin 2006, kur subjekti ka bërë vetëdeklarimin për efekt legalizimi pranë ALUIZNI-t. Referuar çmimit të koston së ndërtimit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim EKB) për vitin 2006¹², që ka qenë 25,262 lekë/m², kostoja e shtesës rezultoi të jetë 1,035,742 lekë, pra kostoja e deklaruar nga subjekti në pyetësin nr. 2 është më e ulët se kostoja referencë.

Analiza e mundësisë financiare për krijimin e shtesës anësore

1.7 Në pyetësin nr. 2 subjekti ka deklaruar si burim për pagimin e investimit për ndërtimin e shtesës prej 400,000 lekësh kursimet familjare gjatë viteve të mëparshme.

1.8 Komisioni analizoi burimet e ligjshme financiare të përdorura për ndërtimin e shtesës në vitin 2006 me kursime familjare. Komisioni, duke iu referuar edhe jurisprudencës së konsoliduar nga Kolegji¹³ në lidhje me përcaktimin e vlerës së shtesës, e cila është ndërtuar me grupe punëtorësh dhe jo me firmë ndërtimi, ka përllogaritur koston e ndërtimit duke iu referuar çmimeve të përcaktuara nga EKB-ja, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi. Komisioni mori në konsideratë në analizë financiare si vlerë të investuar për shtesën me sip. 41 m², shumën prej 1,035,742 lekësh, të përllogaritur sipas koston së përcaktuar nga EKB-ja për vitin 2006 dhe jo shumën 400,000 lekë të vlerësuar në aktekspertim.

1.9 Në analizën financiare të mëposhtme për prindërit e subjektit, të dhënat e pasqyruara për periudhën 1998 – 2006 janë kumulative, meqenëse ata nuk kanë qenë subjekte deklaruese, ndërsa për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e tij janë marrë në konsideratë vetëm të ardhurat, shpenzimet dhe ndryshimet e likuiditetit për vitin 2006, referuar faktit se në DIPP-të e viteve 2003, 2004 dhe 2005 ata nuk kanë deklaruar kursime të cilat mund të kenë shërbyer më vonë si burim krijimi për ndërtimin e shtesës.

¹⁰ Sipas mandatpagesës datë 9.4.2021, të "Tirana Bank".

¹¹ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 29.7.2020, e shtetasit L. S.

¹² Udhëzimi nr. 5, datë 7.9.2006, "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja dhe koeficientit 'K' për vitin 2006".

¹³ Vendim nr. 6, datë 17.3.2022, i Kolegjit.

Tabela nr. 1

	Përshkrimi	Periudha 1988 – 2006
Nr.	Të ardhurat	2,483,002
1	Të ardhura nga paga e babait	0
2	Të ardhura nga paga/pensioni i nënës	1,367,154
3	Të ardhura nga paga e subjektit, viti 2006	800,891
4	Të ardhura nga paga e bashkëshortes, viti 2006	314,957
	Detyrime	0
	Shpenzime	1,760,501
1	Shpenzime jetike	1,760,501
	Pasuri	1,654,358
1	Privatizuar apartamenti me sip. 75.5m ² , në datën 9.11.1993	1,570
2	Ndërtuar shtesa me sip. 41 m ² në vitin 2006	1,035,742
3	Ndryshim likuiditeti	617,046
	Mundësia financiare për ndërtimin e shtesës	-931,857

1.10 Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, se duket që subjekti i rivlerësimit:

- nuk ka provuar me dokumentacion vitin e ndërtimit të shtesës së pallatit;
- nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 e në vijim (por edhe në deklaratat e mëparshme të pasurisë) shtesën anësore dhe vlerën e saj;
- nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* vlerën e investimit të shtesës anësore;
- së bashku me prindërit e tij nuk kanë pasur të ardhura financiare të mjaftueshme për ndërtimin e shtesës me sip. 41 m² në vitin 2006, pasi rezultojnë me balancë financiare negative në shumën -931,857 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.11 Në lidhje me vitin e ndërtimit të shtesës, në prapësime subjekti ka deklaruar se ndërtimi i shtesës është bërë në vitin 1996 - 1997 si shtesë anësore e pallatit 5-katësh, shk. 7, duke e mbështetur këtë deklaram në: disa ortofoto; pamje nga *google*; akteksptimin datë 1.3.2023 nga eksperti gjeodet dhe vlerësues, ing. A. S., i cili ka konkluduar se shtesa anësore e pallatit është ndërtuar me 4 kate mbi tokë dhe shtesa me sip. 41m² është ndërtuar para vitit 1999.

1.12 Në lidhje me mosdeklarimin e shtesës anësore dhe vlerës së saj në DIPP-në e vitit 2006 e në vijim (por edhe në deklaratat e mëparshme të pasurisë), subjekti shpjegon se shtesa është deklaruar për legalizim në vitin 2006, por legalizimi është kryer në vitin 2021 dhe para legalizimit, bazuar në ligjin nr. 9049/2003, ky “ndërtim” nuk përbënte detyrim për deklaram në “formën e shpenzimit të deklarueshëm”. Detyrimi për deklaram është vendosur me ligjin nr. 85/2012, “Për ndryshimin e ligjit nr. 9049/2003”, për shpenzimet mbi vlerën 500,000 lekë gjatë vitit të deklarimit. Për këto arsye, meqenëse shtesa është bërë para vitit 1999, mosdeklarimi i shpenzimeve të kryera për ndërtimin e shtesës nuk është në shkelje të ligjit nr. 9049/2003.

1.13 Në lidhje me mosdeklarimin e vlerës së investimit të shtesës anësore në deklaratën *Vetting*, subjekti shpjegon se nuk ka deklaruar vlerën e investimit, për arsye se kjo shtesë është bërë me 6 punëtorë ndërtimi dhe me procedurat e ndërtimit janë marrë prindërit e tij, prandaj nuk disponon asnjë dokument apo faturë për pagesat e kryera dhe vlerën totale të investimit. Sipas akteksptimit të bërë nga eksperti, vlera e investimit është rreth 400,000 lekë, por edhe nëse i referohemi kostos së miratuar nga EKB-ja për vitin 1997 (vlera 16,657 lekë/m² – 30% e zërave të kostove që nuk

përfshihen në ndërtimet informale) rezulton se vlera e shpenzuar është 477,969 lekë, vlerë e përafërt me shumën e përllogaritur prej 400,000 lekësh.

1.14 Në lidhje me mungesën e të ardhurave financiare të mjaftueshme të subjektit dhe prindërve të tij, për ndërtimin e shtesës me sip. 41 m² në vitin 2006, subjekti shpjegon se sipas vërtetimit datë 12.12.2022, lëshuar nga ISSH-ja, babai i tij ka përfituar në total shumën 1,174,038 lekë nga pensioni i pleqërisë dhe statusi i veteranit për periudhën 1.9.1982 – 30.4.2003, shumë kjo që mundëson ndërtimin e shtesës anësore me të ardhura të ligjshme.

Vlerësimi i Komisionit

1.15 Në lidhje me vitin e ndërtimit të shtesës së pallatit, Komisioni vëren se subjekti arriti të provojë nëpërmjet provave të paraqitura në prapësime se shtesa prej 41 m² është ndërtuar në vitet 1996 - 1997.

1.16 Në lidhje me shpjegimet e subjektit për mosdeklarimin e shtesës anësore dhe vlerës së saj në DIPP-në e vitit 2006 e në vijim (por edhe në deklaratat e mëparshme të pasurisë), Komisioni, nisur nga fakti që u provua se shtesa është ndërtuar në vitet 1996 - 1997, vlerëson se kjo shtesë duhej të deklarohet nga subjekti në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, si deklarim për herë të parë kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i cili përcakton¹⁴ qartë detyrimin e subjektit për të deklaruar pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato. Gjithashtu, në formularin e deklarimit, pjesë e këtij ligji, përcaktohet si objekt deklarimi çdo lloj pasurie e regjistruar ose jo në regjistrat publikë. Për këto arsye, shtesa me sip. 41 m² e objektit ekzistues duhej të deklarohet në vitin 2003 si një pasuri e paluajtshme e re, e cila ishte ndërtuar me kursime familjare dhe është përdorur nga subjekti dhe familja e tij, përfshirë edhe prindërit.

1.17 Vendimi nr. 35, datë 23.12.2020, i Kolegjit (pika 83), të cilit i referohet subjekti i rivlerësimit, nuk trajton të njëjtin rast si me rastin e subjektit të rivlerësimit, pasi rasti referues ka të bëjë me një pasuri që, siç thekson Kolegji, nuk është pasuri e paluajtshme në kuptim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” dhe as të dispozitave të Kodit Civil (objekti shtesë ishte pa themele dhe i mbështetur në avllinë e fqinjët, për të cilin nuk plotësohet kriteri i trupëzimit të tij me tokën, në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme). Për sa më lart, ky prapësim i subjektit për mosdeklarimin e shtesës nuk bazohet në prova e në ligj.

1.18 Në lidhje me prapësimet e subjektit për konstatimin në lidhje me mosdeklarimin e vlerës së investimit të shtesës anësore në deklaratën Vetting, Komisioni mban në konsideratë faktin se ky detyrim përcaktohet në formularin nr. 4 “Deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit”, pjesë e ligjit nr. 84/2016. Në këtë deklaratë përcaktohen si objekt deklarimi vlera e krijimit të pasurisë dhe çmimi i blerjes dhe në mungesë të dokumenteve për këto të deklarohet shuma e shpenzimeve të kryera.

1.19 Në lidhje me prapësimet e subjektit se familja e tij ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme shtesën e pasurisë, të krijuar në vitet 1996 - 1997 dhe se në analizën financiare nuk duhet të përfshihet 30% e zërave të kostove në ndërtimet informale, Komisioni vlerëson se të ardhurat e prindërve të paraqitura nga subjekti janë të ligjshme, ndërsa pretendimi i tij për t’i zbritur 30% të zërave të kostos së ndërtimit nuk është i mbështetur në dokument ligjor ose praktikën e ndjekur nga Kolegji. Sipas praktikës së Kolegjit¹⁵, bazuar në manualët e preventivimit të punimeve

¹⁴ Ligji nr. 9049/2003, neni 4/a “pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato”; neni 6 që përcakton detyrimin e subjekteve që në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimin e tyre.

¹⁵ Vendimi nr. 7/2022 (JR), datë 29.3.2022, subjekti i rivlerësimit S. K.

të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit, miratuar me udhëzimin nr. ***, datë 8.5.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, elementet e kostos që zbriten janë fitimi i planifikuar dhe fondi rezervë në masën 8,83% të kostos totale të ndërtimit. Nga analiza financiare e rishikuar rezultoi se kostoja totale e ndërtimit për këtë pasuri do të ishte 619,269 lekë.

1.20 Pavarësisht përfshirjes në analizën financiare të rishikuar të tri elementeve: (i) shpenzimeve për ndërtimin e shtesës llogaritur deri në vitin 1997; (ii) të ardhurave nga pensioni i babait; dhe (iii) zbritjes së kostos së ndërtimit – analiza financiare për periudhën 1988 – 1997, kumulative deri në momentin e ndërtimit (dhe jokumulative deri në vitin 2002), rezulton me balancë negative prej 184,083 lekësh, sipas tabelës nr. 2 të paraqitur si vijon:

Tabela nr. 2

	Përshkrimi	Periudha 1988 – 1997
Nr.	Të ardhurat	1,284,577
1	Të ardhura nga paga e babait	403,394
2	Të ardhura nga paga/pensioni i nënës	251,496
3	Të ardhura nga paga e subjektit	629,688
	Detyrime	0
	Shpenzime	847,821
1	Shpenzime jetike	847,821
	Pasuri	620,839
1	Privatizuar apartamenti me sip. 75.5 m ² , në datën 9.11.1993	1,570
2	Ndërtuar shtesa me sip. 41 m ² në vitin 1996 - 1997	619,269
	Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri	-184,083

1.21 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar shtesën anësore prej 41 m² të apartamentit me sip. 75.2 m², në rrugën “****”, në vitet 1996 -1997, të cilën nuk e ka deklaruar në deklaratën e para fillimit të detyrës të vitit 2003; nuk ka deklaruar vlerën e investimit të saj në deklaratën *Vetting*; si dhe ka rezultuar me pamundësi të ardhurash të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në vlerën -184,083 lekë.

2. Apartament me sip. 126 m², në rrugën “**”, pallati “****”, shk. ***, ap. ***, Tiranë. Blerë me kontratë shitjeje nr. ***, datë 23.9.2016. Vlera: 9,500,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

Burimi i krijimit: (i) kursime në vite në vlerën 7,000,000 lekë; (ii) kredi për blerje apartamenti nga Banka Amerikane e Investimeve, në shumën 2,500,000 lekë, me kontratë huaje hipotekore nr. ***, datë 13.10.2016, me noter J. Zh., me afat 7 vjet.

2.1 Kjo pasuri është deklaruar në mënyrë të njëjtë në DIPP-në e vitit 2016.

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.2 Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka depozituar: (a) kontratë shitjeje datë 23.9.2016¹⁶, e lidhur midis shitësit, shoqëria “L.” sh.p.k., dhe blerësit Arben Kostandini, për blerjen e apartamentit me sip. 126 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në rrugën “****”, Tiranë, kundrejt çmimit 9,500,000 lekë, për të cilin është dakordësuar që do të paguhet nga subjekti në shumën 7,000,000 lekë në momentin e nënshkrimit të kontratës nëpërmjet llogarisë së noterit dhe shuma 2,500,000 lekë do të paguhet me lëvrimin e kredisë bankare; (b) certifikatë për vërtetim

¹⁶ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 23.9.2016, e noterit J. Zh.

pronësie e apartamentit, datë 1.7.2011, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.; (c) mandat bankar datë 23.9.2016, nga “Credins Bank”, për pagesën e shumës 7,000,000 lekë nga subjekti në llogari të noterit; (ç) vërtetim datë 11.1.2017, nga Banka Amerikane e Investimeve (ABI Bank), që konfirmon se subjekti ka marrëdhënie kredie me këtë bankë; (d) kontratë huaje hipotekore¹⁷, datë 13.10.2016, e lidhur mes huadhënësit ABI Bank dhe huamarrësve Arben e F. Kostandini, për dhënien e huas në shumën 2,500,000 lekë; si dhe (dh) kontratë hipoteke¹⁸ datë 13.10.2016, e lidhur midis të njëjtave palë për vënien në hipotekë të apartamentit me sip. 126 m², pronë e subjektit, me qëllim garantimin e kredisë.

2.3 Referuar çmimit të EKB-së për vitin 2016¹⁹, për blerje në zonën 10/2 Tiranë, i cili është 139,500 lekë/m², rezulton se për sip. 126 m² çmimi i blerjes së apartamentit duhej të ishte në total 17,577,000 lekë dhe jo 9,500,000 lekë. Pra, duket se subjekti e ka përfituar këtë apartament me çmim më të ulët se pothuajse gjysma e çmimit referencë.

2.4 Komisioni hetoi edhe për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe administratorit të saj, por nga hetimi nuk rezultoi²⁰ ndonjë situatë të tillë.

2.5 Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se nga data 1.12.2010 deri në datën 23.9.2016 ka banuar në apartamentin tek rruga “****”, nd. ***, pallati “****” shk. ***, ap. ***, Tiranë, që e ka pasur në përdorim nga shoqëria “****” sh.p.k., pa pagesë.

2.6 FSHU-ja konfirmon se subjekti ka lidhur për këtë apartament kontratën e furnizimit nr. ***, që në datën 13.4.2007. Sipas konsumit që pasqyrohet në pagesat e kryera për këtë kontratë, rezulton se apartamenti ka filluar të banohet në shtator të vitit 2010.

2.7 Sa më lart, Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar as në DIPP-të vjetore e as në deklaratën *Vetting* trajtimin e tij preferencial nga shoqëria “****” sh.p.k. për përdorimin e këtij apartamenti pa pagesë, për një kohë të gjatë dhe as për çmimin e blerjes dyfish më të ulët se çmimi referencë.

2.8 Në lidhje me këtë fakt, në pyetësin nr. 2, subjekti ka shpjeguar se me shtetasit V. dhe E. K. (drejtues të shoqërisë “****” sh.p.k.) njihen që fëmijë dhe kanë miqësi shoqërore e familjare, përfshirë edhe shtetasin M. L. (ortak i kësaj shoqërie dhe vëllai i shtetasës E. K.). Për këtë arsye, subjekti me bashkëshorten e tij kanë porositur verbalisht apartamentin 2+1 me sip. 126 m², të cilin pas ndërtimit e kanë marrë në përdorim pa pagesë në datën 1.12.2010, derisa të plotësonin paratë dhe të lidhnin kontratën e shitjes në datën 23.9.2016. Subjekti pretendon se trajtimin preferencial nuk e ka deklaruar sepse nuk kishte dokument të shkruar. Përdorimin e apartamentit nuk e ka çmuar se duhej ta deklaronte, meqenëse marrëdhënia ishte verbale dhe do ta deklaronte pasi të hartohej kontrata e shitjes. Bashkëlidhur përgjigjes subjekti ka depozituar deklaratën datë 30.7.2020, ku shtetasja E. K., si përfaqësuese ligjore e shoqërisë “****” sh.p.k., deklaroi se për shkak të marrëdhënieve shoqërore shumë të mira kanë lidhur me shtetasit Arben e A. Kostandinin marrëveshjen verbale për përdorimin e apartamentit pa pagesë deri në shitjen e tij, meqenëse ata nuk e kishin vlerën e plotë të shitjes në dhjetor të vitit 2010, kur e morën në përdorim.

2.9 Në pyetësin nr. 3, subjekti ka deklaruar se për shkak të miqësisë që kanë pasur me bashkëshortët Kosta, pronarë të shoqërisë “****” sh.p.k., nuk i është bërë ndonjë trajtim preferencial në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit, për aq sa është rënë dakord, përveçse

¹⁷ Kontratë huaje hipotekore nr. ***, datë 13.10.2016.

¹⁸ Kontratë hipoteke nr. ***, datë 13.10.2016.

¹⁹ Udhëzim nr. 3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2016”.

²⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

lënies në përdorim të apartamentit deri në pagimin e çmimit. Bashkëlidhur përgjigjes subjekti ka depozituar disa kontrata shitjeje apartamenti²¹, të ngjashme që shoqëria “****” sh.p.k. ka lidhur me banorë të ndryshëm në të njëjtin pallat ku subjekti ka blerë apartamentin e tij. Rezulton se çmimi për metër katror i këtyre apartamenteve varion nga 97,139 lekë/m² – 111,976 lekë/m², ndërsa çmimi i apartamentit që ka blerë subjekti është 75,396 lekë/m².

2.10 Pra, çmimi i apartamentit që ka blerë subjekti është jo vetëm më i ulët se çmimi referencë i EKB-së, por edhe më i lirë se çmimi i kontratave të ngjashme, fakt ky që e vendos subjektin në kushtet e një trajtimi preferencial nga shoqëria “****” sh.p.k., pavarësisht nga marrëdhënia shoqërore që ata pretendojnë. Sidoqoftë, për Komisionin mbeten ende të paqarta shkaqet e përdorimit të apartamentit me sip. 126 m² pa asnjë lloj kundërshtpërblimi për 6 vjet pa ndërprerje, si dhe blerja e tij me çmim sa gjysma e vlerës së çmimit referencë e më të lirë se apartamentet e ngjashme në të njëjtin objekt.

Analiza e mundësisë financiare të subjektit për të blerë këtë apartament

2.11 Komisioni analizoi fillimisht mundësinë financiare të subjektit dhe familjes së tij për të kursyer ndër vite shumën 7,000,000 lekë, që i ka paguar shoqërisë “****” sh.p.k. në datën 23.9.2016, nëpërmjet llogarisë së noterit J. Zh. në “Credins Bank”. Për këtë arsye, bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në DIPP-të periodike, Komisioni analizoi ecurinë e likuiditeteve *cash* ndër vite, shtesave/pakësimeve.

2.12 Deklarimi i kursimeve *cash* ndër vite²²

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.12.1 Në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 11.1.2011, subjekti ka deklaruar se kursimet prej 2,300,000 lekësh, të deklaruara në DIPP-në e vitit 2008, përbëjnë shumën e akumuluar në vitet 2005 – 2008 të pagave të tij dhe të bashkëshortes, të cilat deri në datën 31.12.2007 kanë qenë të kursyera në llogaritë e pagave në “Raiffeisen Bank” dhe në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 1,630,360 lekë. Nga kjo shumë kanë tërhequr nga bankat shumën prej 1,511,000 lekësh gjatë vitit 2008 dhe së bashku me kursimet e atij viti është grumbulluar në total shuma 2,300,000 lekë, e cila nuk është përdorur, por është gjendje në banesë për ta përdorur kur të ishte nevoja.

2.12.2 Në pyetësin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të shpjegojë ndryshimet e gjendjes *cash* (shtesa/pakësime) ndër vite dhe të përcaktojë gjendjen *cash* në datën 31 dhjetor të çdo viti. Në përgjigje, subjekti ka pasqyruar për çdo vit, 2003 – 2017, kursimet familjare në datën 31 dhjetor (gjendjen e parave *cash* në banesë të akumuluar nga pagat, likuiditetet në banka dhe kursimet kumulative), si dhe ka shpjeguar²³ se në lidhje me kursimet 2,300,000 lekë, që ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, pjesë e kësaj shume është edhe shuma 1,200,000 lekë që bashkëshortja e tij ka tërhequr nga “Intesa Sanpaolo Bank” dhe është mbajtur *cash* në banesë për t’u përdorur sipas

²¹ Kontratë nr. ***, datë 22.8.2011; kontratë nr. ***, datë 31.3.2016; kontratë nr. ***, datë 18.7.2011; kontratë nr. ***, datë 28.7.2011; kontratë nr. ***, datë 18.7.2011.

²² Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar: “Kursime 130,000 lekë. Pjesa 100%”; në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “Kursime 2,300,000 lekë”; në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: “Kursime 4,000,000 lekë”, por në ILDKPKI-në e datës 1.10.2010 ka sqaruar se janë 400,000 lekë të reja; në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: “Shtuar gjendje *cash* në banesë për vitin 2010, vlera 1,200,000 lekë. Pjesa 50%. Burimi i krijimit...”; në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: “Shtuar gjendje *cash* në banesë për vitin 2011, vlera 1,000,000 lekë. Pjesa 50%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat”; në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “Shtuar gjendje *cash* në banesë për vitin 2012, vlera 1,600,000 lekë. Pjesa 50%. Burimi i krijimit: të ardhura nga pagat, nga trashëgimia dhe nga puna jashtë orarit e bashkëshortes”; në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: “Shtuar gjendje *cash* në banesë për vitin 2013. Vlera 1,100,000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat”; në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Kursyer nga pagat 750,000 lekë, gjendje *cash* në banesë”; në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “Kursyer 300,000 lekë, gjendje *cash* në banesë”.

²³ Përgjigja nr. 12 e pyetësin nr. 2.

nevojave të familjes. Shuma 2,300,000 lekë është kursyer një pjesë në bankë dhe pjesa tjetër *cash* në banesë, e cila përfaqëson kursimet e viteve 2004, 2006, 2007 dhe 2008, siç ka sqaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 11.1.2011.

2.12.3 Në tabelën e mëposhtme nr. 3 janë paraqitur: (i) deklaramet e kursimeve *cash* në deklaratat periodike; (ii) shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin nr. 2 në lidhje me deklarinin periodik të kursimeve *cash*; si dhe (iii) shpjegimet e dhëna prej tij në ILDKPKI (për deklarinin e vitit 2008 është pyetur nga ILDKPKI-ja, ndërsa për deklarinin e vitit 2009 subjekti, me vullnetin e tij, ka bërë saktësim të deklaratës periodike në lidhje me kursimet *cash*).

2.12.4 Në DIPP-në e vitit 2007 subjekti deklaroi për herë të parë kursime në shumën 130,000 lekë, por nuk ka përcaktuar në këtë deklarin nëse kursimet janë *cash* apo likuiditete bankare. Për këtë arsye, Komisioni ka verifikuar gjendjen e llogarive bankare, si dhe shtesën e tyre për vitin 2007. Nga informacioni bankar rezultoi se gjendja e llogarive bankare në datën 31.12.2006 është 1,050,040 lekë dhe në datë 31.12.2007 është 1,691,095 lekë, pra deklarimi i subjektit në DIPP-në e vitit 2007 nuk i referohet gjendjes së llogarive bankare, as shtesës së tyre për vitin 2007 prej 641,055 lekësh (1,691,095 - 1,050,040), si dhe as kursimeve në total (*cash* dhe në bankë), duke lënë në këtë mënyrë të kuptohet se subjekti për vitin 2007 i është referuar kursimeve *cash* kur deklaroi kursime në shumën 130,000 lekë.

2.12.5 Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, subjekti ka deklaruar se për periudhën 2003 – 2006 ka pasur kursime *cash*, konkretisht: 200,000 lekë në vitin 2003; 500,000 lekë në vitin 2004; 545,100 lekë në vitin 2005; dhe 30,200 lekë në vitin 2006, ndërsa për vitin 2007 deklaroi gjendje *cash* shumën 8,500 lekë dhe gjendje në llogari bankare shumën 1,691,094 lekë. Por, nga leximi i deklaratave periodike rezultoi se për periudhën 2003 – 2007 subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*, me përjashtim të vitit 2007, ku deklaroi 130,000 lekë kursime dhe ku sipas arsyetimit të mësipërm subjekti i referohet gjendjes *cash*.

2.12.6 Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin nr. 2, për periudhën 2003 – 2007, janë kontradiktore me deklaramet e tij në DIPP-të përkatëse. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar në të njëjtën mënyrë si në vitin 2007, “kursime në shumën 2,300,000 lekë”. Edhe në këtë deklarin, për të kuptuar se kujt i referohet subjekti me fjalën “kursime”, Komisioni ka ndjekur të njëjtën logjikë²⁴ si në leximin e DIPP-së së vitit 2007 dhe ka arritur në konkluzionin se subjekti në deklarinin e tij në DIPP-në e vitit 2008 i referohet “kursimeve *cash*” në shumën 2,300,000 lekë. Ky konkluzion përforcohet edhe nga deklarimi i subjektit kur është pyetur në ILDKPKI në vitin 2011²⁵.

2.12.7 Nga informacioni bankar rezultoi se gjendja e llogarive në datën 31.12.2007 është 1,691,095 lekë dhe në datën 31.12.2008 është 179,275 lekë, pra në vitin 2008 subjekti ka pakësuar gjendjen e llogarive bankare me 1,511,820 lekë, për të cilën, sipas shpjegimeve në procesverbalin

²⁴ Ka krahasuar dhe verifikuar nëse deklarimi në DIPP i kursimeve 2,300,000 lekë i referohet kursimeve në bankë (gjendjes ose ndryshimit të llogarive bankare), nga ku sipas dokumentacionit bankar rezultoi se gjendja e llogarive bankare më 31.12.2008 është në shumën 179,275 lekë, ndërsa ndryshimi i llogarive bankare është për vitin 2008 - 1,511,820 lekë (pra llogaritë bankare janë pakësuar me 1,511,820 lekë për vitin 2008).

²⁵ Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 11.1.2011, subjekti ka deklaruar: “...shuma e kursimeve të deklaruara në vitin 2008 prej 2,300,000 lekësh përbën shumën e lekëve të akumuluar në vitet 2005, 2006, 2007 dhe 2008 të pagave të mia dhe të bashkëshortes, të cilat deri më 31.12.2007 kanë qenë të kursyera në llogaritë e pagave në ‘Raiffeisen Bank’ dhe ‘Intesa Sanpaolo Bank’ në shumën 1,630,360 lekë. Nga kjo shumë gjatë vitit 2008 kemi tërhequr nga bankat shumën prej 1,511,000 lekësh dhe së bashku me kursimet e atij viti është grumbulluar në total shuma 2,300,000 lekë, e cila nuk është përdorur, por është gjendje në shtëpi për ta përdorur kur të më lindë nevoja. Pra si burim për këto kursime kanë shërbyer të ardhurat familjare ndër vite nga pagat”.

e ILDKPKI-së, pretendon se është burim krijimi për gjendjen *cash* prej 2,300,000 lekësh në datën 31.12.2008.

2.12.8 “Intesa Sanpaolo Bank”²⁶ konfirmon tërheqjen e shumës 1,200,000 lekë në datën 31.12.2008, me përshkrimin “për rregullim shtëpie”. Në pyetësin nr. 2, në lidhje me këtë veprim, subjekti ka shpjeguar se për shkak të ndryshimit të kreditimit të pagës së bashkëshortes së tij nga “Intesa Sanpaolo Bank” tek “Union Bank” është bërë tërheqja e shumës 1,200,000 lekë për t’u mbyllur kjo llogari. Si shkak për tërheqjen e parave është përdorur termi “rregullim shtëpie” nga banka në mënyrë të njëanshme, por në fakt paratë janë tërhequr dhe janë mbajtur *cash* në banesë për t’u përdorur sipas nevojave të familjes. Shuma e mësipërme është pjesë e shumës së deklarimit për vitin 2008, ku është deklaruar shumë e kursyer prej 2,300,000 lekësh, një pjesë në bankë dhe pjesa tjetër *cash* në banesë, e cila përfaqëson kursimet e viteve 2005 – 2008, kjo sqaruar në procesverbalin e datës 11.1.2011 në ILDKPKI. Komisioni, nga analizimi tërësor i deklarimeve të subjektit në pyetësin nr. 2 dhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, nuk e konsideroi vlerën 1,200,000 lekë si shpenzim për rregullim shtëpie në vitin 2008, por si pjesë e kursimeve në vlerën 2,300,000 lekë.

2.12.9 Gjithashtu, në pyetësin nr. 2, subjekti ka deklaruar se për vitin 2008 gjendja *cash* është 2,090,000 lekë, gjendja e llogarive bankare është 209,365 lekë dhe kursimet e akumuluar janë në shumën 2,299,365 lekë. Ky deklarim është kontradiktor me deklarimin e subjektit në procesverbalin e ILDKPKI-së së vitit 2011, ku ai deklaroi se shuma 2,300,000 lekë është gjendje *cash* në banesë, shumë të cilën Komisioni e ka marrë në analizën financiare.

2.12.10 Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në shumën 4,000,000 lekë. Komisioni ka administruar përgjigjen e ILDKPKI-së²⁷ dhe gjithë dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit pranë këtij institucioni, midis të cilave është edhe shkresa e datës 1.10.2010, me lëndë “sqarim në lidhje me deklarimin e pasurisë”, ku subjekti ka shpjeguar se: “...në deklarimin tim periodik vjetor 2009, në faqen 3 të deklaratës, kam deklaruar shtesë nga kursimet në vlerën 4,000,000 lekë, ndërkohë që i kam shprehur në lekë të vjetra. Pra, deklaroj se shtesa nga kursimet për vitin 2009 është në vlerën 400,000 lekë”.

2.12.11 Në pyetësin nr. 2, subjekti ka deklaruar se për vitin 2009 gjendja *cash* është 2,144,924 lekë, gjendja e llogarive bankare është 555,076 lekë dhe kursimet e akumuluar janë në shumën 2,700,000 lekë.

2.12.12 Për sa më lart, Komisioni në pasqyrimin e gjendjes *cash* ka marrë në konsideratë deklarimin e subjektit të rivlerësimit në datën 1.10.2010 dhe ka konsideruar për vitin 2009 shtesë të kursimeve *cash* në shumën 400,000 lekë, nga ku gjendja *cash* në datën 31.12.2009 është në shumën 2,700,000 lekë.

2.12.13 Në DIPP-në e viteve 2010 – 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “shtuar gjendja *cash*”. Edhe për këtë periudhë, shpjegimet e dhëna në pyetësin nr. 2 nga subjekti i rivlerësimit janë kontradiktore me deklaratimet periodike, pasi në këtë pyetësor subjekti deklaroi si shtesa “kursimet *cash* + bankë”.

2.12.14 Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit, me përjashtim të DIPP-së së vitit 2014, nuk ka deklaruar asnjëherë gjendjen e llogarive bankare (as llogaritë e pagave dhe as llogarinë e depozitës bankare që ka pasur në “Union Bank”).

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 3.11.2022.

²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 11.3.2021, e ILDKPKI-së.

2.12.15 Shpjegimet e dhëna në pyetësoin nr. 2, se në datën 31.12.2014 kursimet e akumuluar janë 7,208,690 lekë, nga të cilat 6,698,759 lekë *cash* dhe 509,931 lekë në llogari bankare, janë përsëri kontradiktore me deklarinimin periodik në DIPP-në e vitit 2014, pasi në këtë DIPP subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi ndryshime në gjendjen *cash*²⁸, por vetëm ndryshime në llogaritë e tij bankare²⁹.

2.12.16 Komisioni, në përcaktimin e kursimeve *cash* në vitin 2014, ka mbajtur në konsideratë deklarinimin e subjektit në DIPP-në e vitit 2014, ku sipas ecurisë kronologjike të deklarimit të gjendjes *cash*, gjendja në datën 31.12.2014 është në shumën 7,600,000 lekë, e cila është mbartur e pandryshuar nga gjendja *cash* e datës 31.12.2013.

2.12.17 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “*Kursime nga pagat 750,000 lekë, gjendje cash në banesë*”. Në pyetësoin nr. 2, subjekti deklaroi gjendje *cash* në shumën 7,247,938 lekë. Komisioni, duke iu referuar mënyrës se si ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në vitet 2010 – 2013, si dhe faktit që në vitin 2015 nuk rezultoi asnjë blerje/investim i kryer, e ka konsideruar shumën 750,000 lekë si shtesë kursimesh *cash* për vitin 2015 dhe gjendja *cash* e akumuluar në fund të vitit 2015 shkon 8,350,000 lekë.

2.12.18 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Kursime gjendje cash në banesë shumën 300,000 lekë*”. Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 pakësimin e gjendjes *cash* për 7,000,000 lekë si burim për blerjen e apartamentit, por kur ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar si burim shumën 7,000,000 lekë kursime ndër vite.

Analiza e mundësisë financiare të subjektit për të krijuar kursime *cash* me burime të ligjshme

2.12.19 Komisioni konstaton se për periudhën 2007 – 2013 analiza financiare e subjektit të rivlerësimit ka rezultuar me balanca negative në shumën 5,349,314 lekë për të përballuar shpenzimet dhe krijuar likuiditetet, sipas tabelës nr. 3 në vijim.

2.12.20 Në këto kushte, Komisioni vlerësoi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme kursimet *cash* të deklaruara në deklaratat periodike deri në momentin e përdorimit të tyre si burim për blerjen e apartamentit. Sipas deklarimeve periodike gjendja *cash* e deklaruar deri në vitin 2015 është në vlerën 8,350,000 lekë, por për krijimin e kësaj gjendjeje ndër vite subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për vitet 2007 – 2013.

2.12.21 Në vitin 2007 subjekti deklaroi për herë të parë “kursime *cash* prej 130,000 lekësh”, por në këtë vit analiza financiare ka rezultuar me balancë negative në shumën -690,609 lekë, pra në këtë vit subjekti nuk ka pasur mundësi të krijojë likuiditetet *cash* prej 130,000 lekësh me burime të ligjshme. Me këtë mënyrë Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit për të krijuar me të ardhura të ligjshme shtesat e likuiditetit *cash* për çdo vit, për vitet 2007 – 2015. Nga kjo analizë ka rezultuar se mundësia për të kursyer me të ardhura të ligjshme rezultoi si diferencë midis “shtesës së gjendjes *cash*” për secilin vit dhe “rezultatit negativ” të atij viti (shihni tabelën në vijim).

²⁸ Nëse Komisioni do të mbante në konsideratë deklarinimet e subjektit në pyetësoin nr. 2, ku subjekti deklaroi 5,070,544 lekë gjendje *cash* më 31.12.2013 dhe 6,698,759 lekë gjendje *cash* më 31.12.2014, rezultoi se kemi të bëjmë me shtesë gjendjeje *cash* prej 1,628,215 lekësh për vitin 2014, e cila nuk është i deklaruar në DIPP-në e vitit 2014.

²⁹ Në DIPP-në e vitit e vitit 2014, subjekti deklaroi: “*Kursyer nga pagat 1,029,256 lekë, nga të cilat 359,658 lekë në llogarinë rrjedhëse të pagës sime në ‘Credins Bank’ dhe 669,608 lekë në llogarinë rrjedhëse të pagës së bashkëshortes në ‘Union Bank’*”.

2.12.22 Në rastin kur “rezultati negativ” i vitit në vlerë absolute është më i madh sesa “shtesa e gjendjes *cash*” për atë vit, atëherë e gjithë “shtesa e gjendjes *cash*” është krijuar me burime të paligjshme dhe subjekti, jo vetëm nuk ka mundur të krijojë shtesë të gjendjes *cash*, por as të ruajë të njëjtin nivel kursimesh nga viti paraardhës. Ndërsa, në rastin kur “rezultati negativ” në vlerë absolute është më i vogël sesa “shtesa e gjendjes *cash*”, atëherë vetëm pjesa e “shtesës së gjendjes *cash*” që ka mbetur pas zbritjes së vlerës së “rezultatit negativ” është me të ardhura të ligjshme.

Tabela nr. 3

Declaratë periodike	Deklarimi i cash-it në deklaratat periodike	Gjendja e cash-it në datë 31 dhjetor të çdo viti sipas deklarimeve	Deklarimi i kursimeve në pyetësin nr.2 sipas subjektit			Shpjegime të dhëna në ILDKPKI
			Kursimet cash në shtëpi në datë 31.12	Likuiditete në bankë në datë 31.12	Kursime kumulative	
2003			200,000	0	200,000	
2004			500,000	0	500,000	
2005			545,100	404,867	949,967	
2006			30,200	1,049,774	1,079,974	
2007	Kursime 130,000 lekë	130,000	8,500	1,691,094	1,699,594	
2008	Kursime 2,300,000 lekë	2,300,000	2,090,000	209,365	2,299,365	<p>Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datë 11.1.2011 subjekti ka deklaruar: "Dua të sqaroj se shuma e kursimeve të deklaruara në vitin 2008 prej 2,300,000 lekë përbën shumën e lekëve të akumuluar në vitet 2005,2006,2007 dhe 2008 të pagave të mia dhe të bashkëshortes të cilat deri më 31.12.2007 kanë qenë të kursyera në llogaritë e pagave në Raiffeisen Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank në shumën 1,630,360 lekë.</p> <p>Nga kjo shumë gjatë vitit 2008 kemi tërhequr nga bankat shumën prej 1,511,000 lekë dhe së bashku me kursimet e atij viti është grumbulluar në total shuma 2,300,000 lekë e cila nuk është përdorur, por është gjendje në shtëpi për ta përdorur kur të më lindë nevoja. Pra si burim për këto kursime kanë shërbyer të ardhurat familjare ndër vite nga pagat."</p>
2009	Kursime 4,000,000 lekë	2,700,000	2,144,924	555,076	2,700,000	<p>Me shkresën nr.*** prot, datë 11.3.2021 ILDKPKI I ka vënë në dispozicion Komisionit gjithë dokumentacionin e depozituar nga subjekti I rivlerësimit pranë këtij institucioni.Ndër të tjera është depozituar nga subjekti i rivlerësimit edhe shkresa e datës 1.10.2010 me lëndë " Sqarim në lidhje me deklarimin e pasurisë" në të cilën subjekti ka shpjeguar se : " Me anë të këtij sqarimi dua të sqaroj se në deklarimin tim periodik vjetor 2009 në faqen 3 të deklaratës kam deklaruar shtesë nga kursimet në vlerën 4,000,000 lekë ndërkohë që i kam shpreh në lek të vjetra. Pra deklaroj se shtesa nga kursimet për vitin 2009 është në vlerën 400,000 lekë</p>
2010	Shtuar gjendja cash në banesë për vitin 2010. Vlera 1,200,000 lekë	3,900,000	2,634,666	1,241,670	3,876,336	
2011	Shtuar gjendja cash në banesë për vitin 2011 të ardhurat nga pagat 1,000,000 lekë	4,900,000	4,535,109	364,891	4,900,000	
2012	Shtuar gjendja cash në banesë për vitin 2011 të ardhurat nga pagat, nga trashëgimia dhe nga puna jashtë orarite b/sh 1,600,000 lekë	6,500,000	4,559,320	1,940,680	6,500,000	
2013	Shtuar gjendja cash në banesë për vitin 2013 të ardhurat nga pagat 1,100,000 lekë	7,600,000	5,070,544	2,529,456	7,600,000	
2014	Kursyer nga pagat 1,029,2656 lekë nga të cilat 359,658 lekë në llogarinë rrjedhëse të pagës sime në bankën Credins dhe 669,608 lekë në llogarinë rrjedhëse të pagës së b/sh në bankën "Union"	7,600,000	6,698,759	509,931	7,208,690	
2015	Kursyer nga pagat 750,000 lekë gjendje	8,350,000	7,247,938		7,247,938	
2016	Kursyer 300,000 lekë gjendje cash në banesë	8,650,000	pakësuar cash 7,000,000 lekë për blerjen e apartamentit		300,000	
Vetting 25.1.2017	cash në shtëpi. Vlera 300,000	300,000		700,000	1,000,000	

Tabela nr. 4

Periudha	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
PASURI	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-911,315	-379,523
Ndryshim likuiditeti (bankë+cash)	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-1,470,755	-379,523
Likuiditet në bankë	1,691,095	179,275	555,367	1,242,834	1,366,092	1,942,775	2,600,302	1,129,547	24
Likuiditet në cash	130,000	2,300,000	2,700,000	3,900,000	4,900,000	6,500,000	7,600,000	7,600,000	8,350,000
<i>Shtesa cash</i>	130,000	2,170,000	400,000	1,200,000	1,000,000	1,600,000	1,100,000	0	750,000
TE ARDHURA	1,367,291	1,407,700	1,681,317	1,757,771	1,785,793	1,729,135	1,667,311	2,310,100	1,355,287
SHPENZIME	1,286,845	818,562	1,074,360	1,204,012	1,095,446	986,055	1,130,090	1,645,270	839,828
Rezutati	-690,609	-69,041	-169,135	-1,333,709	-432,910	-1,433,604	-1,220,306	1,576,145	894,982

2.12.23 Në përfundim, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të kursejë *cash* me të ardhura të ligjshme vetëm shumën 3,561,295 lekë deri në vitin 2015.

Tabela nr. 5

Periudha	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Totali
PASURI	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-911,315	-379,523	
Ndryshim likuiditeti (bankë+cash)	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-1,470,755	-379,523	
Likuiditet në bankë	1,691,095	179,275	555,367	1,242,834	1,366,092	1,942,775	2,600,302	1,129,547	24	
Likuiditet në cash	130,000	2,300,000	2,700,000	3,900,000	4,900,000	6,500,000	7,600,000	7,600,000	8,350,000	
<i>Shtesa cash</i>	130,000	2,170,000	400,000	1,200,000	1,000,000	1,600,000	1,100,000	0	750,000	
TE ARDHURA dokumentuar	1,367,291	1,407,700	1,681,317	1,757,771	1,785,793	1,729,135	1,667,311	2,310,100	1,355,287	
SHPENZIME	1,286,845	818,562	1,074,360	1,204,012	1,095,446	986,055	1,130,090	1,645,270	839,828	
Rezutati	-690,609	-69,041	-169,135	-1,333,709	-432,910	-1,433,604	-1,220,306	1,576,145	894,982	
Mundësia për të kursyer cash me të ardhura të ligjshme	0	2,100,959	230,865	-133,709	567,090	166,396	-120,306	0	750,000	3,561,295

2.13 Në lidhje me burimin e dytë të deklaruar për pagesën e apartamentit “kredi bankare në shumën 2,500,000 lekë”, ABI Bank³⁰ konfirmon kredinë bankare, e cila është disbursuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 18.10.2016 dhe në datën 20.10.2016 është transferuar në llogarinë e noterit J. Zh.

2.14 Në tabelën nr. 6 në vijim është analizuar mundësia financiare për blerjen e apartamentit sipas burimeve të deklaruara, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi financiare për të blerë apartamentin me sip. 126 m² me çmimin 9,500,000 lekë.

Tabela nr. 6

	Përshkrimi	
a)	Burimet	6,061,295
1	Kursime <i>cash</i> ndër vite me burime të ligjshme	3,561,310
2	Kredi bankare ABI Bank, datë 20.10.2016	2,500,000
b)	Pasuri	9,500,000
1	Apartament me sip. 126 m ² , blerë më 23.9.2016	
2	* Paguar me depozitim <i>cash</i> në llogarinë e noterit J. Zh., datë 23.9.2006, me burim kursimet <i>cash</i>	7,000,000
3	* Transferuar në llogarinë e noterit J. Zh. 20.10.2016, me burim kredinë bankare	2,500,000
c)	Mundësia financiare për blerjen e apartamentit	- 3,438,705

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2021.

2.15 Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, që duket se subjekti i rivlerësimit:

- Ka përfituar trajtim preferencial nga shoqëria “****” sh.p.k., për shkak të blerjes me çmim disa herë më të ulët të apartamentit krahasuar me çmimin referencë dhe me çmimin e kontratave të ngjashme, si dhe në lidhje me lënien e këtij apartamenti në përdorim për 6 vjet rresht pa kundërshtim, ndërkohë që nuk ka bërë deklaratime në lidhje me këtë trajtim preferencial.

- Nuk ka deklaruar përdorimin e apartamentit pa kundërshtim në DIPP-në e viteve 2010 – 2016 dhe as adresën e këtij apartamenti si adresë banimi, pavarësisht përdorimit të tij.

- Ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën -3,438,705 lekë për të blerë apartamentin me sip. 126 m² nga shoqëria “****” sh.p.k.

- Nisur nga këto konstatime, duket e dyshimtë marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri (apartament), të cilën duket se mund ta ketë blerë që në vitin 2010, por për shkak të mungesës së burimeve financiare e deklaroi blerjen e saj dhe e formalizon me kontratë shitblerjeje në vitin 2016, për efekt të ligjit *Vetting* nr. 84/2016 të miratuar në këtë vit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.16 Në lidhje me pikën e parë të konstatimeve, subjekti ka shpjeguar në prapësime se: “...është dakordësuar verbalisht me drejtuesit e shoqërisë ‘****’ sh.p.k. përpara vitit 2010 (kur ai po ndërtohej) për porositjen (blerjen në të ardhmen) të apartamentit... për çmimin e blerjes së apartamentit është dakordësuar me miqtë e tij që në vitin 2005. Çmimi i apartamentit është dakordësuar në momentin fillestar kur kemi vendosur të blejmë këtë apartament përpara se ta merrnim në përdorim”.

2.17 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se çmimi dhe përdorimi i apartamentit janë përcaktuar jo për shkak të detyrës, por për shkak se me drejtuesit e shoqërisë “****” sh.p.k. njihej që fëmijë dhe kanë miqësi shumë të mirë familjare e shoqërore. Gjithashtu, duke iu referuar për këtë fakt jurisprudencës³¹ së Kolegjit, nenit 23 të ligjit nr. 9367/2005 dhe faktit që Komisioni nuk ka konstatuar konflikt interesi të subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k. e drejtues të saj, subjekti pretendon se nuk ndodhet përpara trajtimit preferencial nga kjo shoqëri.

2.18 Pyetjes që Komisioni i drejtoi subjektit gjatë seancës dëgjimore se përse nuk e lidhi kontratën e shitblerjes me miqtë, të cilët, siç u theksua, i dhanë një çmim preferencial për apartamentin, por kjo kontratë u vonua për 6 vjet, subjekti iu përgjigj se bisedimet janë bërë dhe çmimin e caktuan në kohën kur kishte filluar të ndërtohej pallati dhe kanë qëndruar në kuadrin e miqësisë deri kur subjekti të siguronte paratë dhe atëherë do të lidhej kontrata e shitblerjes.

2.19 Vëzhguesi ndërkombëtar, gjatë seancës dëgjimore, i ka drejtuar subjektit pyetjen “Përse nuk keni bërë një dokument me shkrim me shoqërinë ‘****’ sh.p.k., që të deklaronit siç duhet në DIPP trajtimin preferencial dhe përdorimin e apartamentit?”. Subjekti është përgjigjur se kur nuk kishte një gjë të shkruar nuk kishte çfarë të deklaronte.

2.20 Në lidhje me pikën e dytë të konstatimeve, subjekti ka shpjeguar se referuar jurisprudencës³² së Kolegjit, detyrimi për të deklaruar pasuritë e paluajtshme në përdorim apo zotërim të subjekteve është përcaktuar për herë të parë në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, po sipas kësaj jurisprudence, Kolegji ka vlerësuar se: “...referuar dispozitave të Kodit Civil mbi të drejta reale, posedimi i sendeve të paluajtshme deri në kalimin e

³¹ Vendimet nr. 16/2020 dhe nr. 42/2022 të Kolegjit.

³² Vendimi nr. 35, datë 15.12.2020, i Kolegjit.

titullit të pronësisë, nuk konsiston në krijimin në favor të subjektit të rivlerësimit të ndonjë të drejte reale në sendin e tjetrit për sa kohë nuk provohet që mbi këto sende të paluajtshme të jetë vendosur në favor të subjektit të rivlerësimit një hipotekë/servitut/e drejtë banimi apo përdorimi/uzufrukt apo enfiteozë. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 4, germa 'a' e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, për sa i takon detyrimit për deklarimin e të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme”.

2.21 Pyetjes që Komisioni i drejtoi subjektit gjatë seancës dëgjimore se përse nuk e kishte deklaruar si adresë banimi adresën e apartamentit të ri që kishte marrë nga shoqëria “****” sh.p.k., pavarësisht se ndodhej në të njëjtën rrugë me apartamentin e vjetër, subjekti iu përgjigj se apartamentet janë në të njëjtën rrugë dhe kanë distancë nga njëri-tjetri jo më shumë se 150-200 m, prandaj nuk e ka vlerësuar se duhej ta deklaronte, por banon njëkohësisht edhe tek banesa e vjetër.

2.22 Në lidhje me pikën e tretë të konstatimeve, subjekti pretendon se duke marrë për bazë metodologjinë e Komisionit, nga analiza e ligjshmërisë së gjendjes *cash* rezulton se vlera e *cash*-it e krijuar me të ardhura të ligjshme është 6,693,106 lekë dhe se në momentin e blerjes së pasurisë do të rezultonte në një vlerë më të madhe (e mjaftueshme për të përballuar pagesën prej 7,000,000 lekësh) për shkak të mundësisë së kursimit deri në shtator të vitit 2016. Në analizën e kësaj mundësie financiare që ka paraqitur, subjekti ka pretenduar dhe ka përfshirë këto elemente:

- i) Të ardhurat nga puna e bashkëshortes në klinika private për vitet 2010 (500,000 lekë), 2011 (450,000 lekë) dhe 2012 (250,000 lekë), të deklaruara në DIPP-të përkatëse, në një total prej 1,150,000 lekësh; sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, detyrimin për mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim e ka shoqëria/personi fizik që përfiton shërbimin dhe bashkëshortja e tij nuk ka qenë në dijeni për mospërmbushjen e detyrimeve nga subjekti tregtar. Për të gjitha këto arsye subjekti pretendon se ndodhet në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016.
- ii) Të ardhurat nga trashëgimia e nënës në shumën 700,000 lekë në vitin 2012, pasi me përfshirjen e të ardhurave nga pensioni i babait deri më 30.4.2003, kryerjen e investimit për shtesën në vitet 1996 – 1997, analiza financiare deri në vitin 2002 rezulton me një balancë pozitive.
- iii) Shpenzimet e jetesës për vitin 2007 janë vlerësuar të barabarta me vitin 2008, sipas praktikës së konsoliduar të organeve të *Vetting*-ut dhe sipas një vlerësimi se e dhëna statistikore e vitit 2007 nuk ka një rritje të logjikshme.
- iv) Pasqyrimin e gjendjeve *cash* sipas analizave të kryera nga subjekti, bashkëlidhur prapësimeve.

2.23 Në analizën e ligjshmërisë së kursimeve *cash* sipas versionit të parë (tabela nr. 1, pika 36 e prapësimeve) në shumën 6,763,952 lekë deri në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit, përveçse merr në konsideratë të ardhurat nga bashkëshortja për vitet 2010 - 2012 në vlerën 1,150,000 lekë, të ardhurat nga trashëgimia e nënës në vitin 2012 në shumën 700,000 lekë, shpenzimet jetike për vitin 2007 llogaritur sa viti 2008, si dhe gjendjen *cash* sipas deklarimit në pyetësonin nr. 2 (me përjashtim të viteve 2014 - 2015), pasi për vitin 2014 subjekti shpjegon se shtesa e gjendjes *cash* duhet të përlllogaritet të paktën në vlerën 1,281,811 lekë (vlera e likuiditetit të tërhequr nga banka nga bashkëshortja në datën 5.2.2014, blerjen e automjetit dhe shpenzimet e udhëtimit, siç është deklaruar në pyetësonin nr. 2). Për vitin 2014 subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e llogarive bankare dhe as shtesën e likuiditetit *cash* sepse ka menduar se likuiditeti ka kaluar nga banka në shtëpi.

Tabela nr. 7

Periudha	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Totali
PASURI	619 735	599 999	400 000	1 200 000	1 000 000	1 600 000	1 100 000	441 342	-379 547	
Ndryshim likuiditeti (bankë+cash)	619 735	599 999	400 000	1 200 000	1 000 000	1 600 000	1 100 000	-118 098	-379 547	
Likuiditet në bankë	1 691 095	210 000	555 076	1 265 334	364 891	1 940 680	2 529 456	1 129 547	0	
Likuiditet në cash	8 906	2 090 000	2 144 924	2 634 666	4 535 109	4 559 320	5 070 544	6 352 355	7 102 355	
<i>Shtesa cash</i>	130 000	2 081 094	54 924	489 742	1 900 443	24 211	511 224	1 281 811	750 000	
TE ARDHURA dokumentuar	1 367 291	1 407 700	1 681 317	2 257 771	2 185 793	2 679 135	1 667 311	2 310 100	1 355 287	
SHPENZIME	790 105	818 562	1 074 360	1 204 012	1 095 446	986 055	1 130 090	1 645 270	839 828	
Rezultati	-42 549	-10 860	206 957	-146 241	90 348	93 080	-562 779	223 488	895 006	
Mundësia për të kursyer cash me të ardhura të ligjshme	0	2 070 234	261 881	343 501	1 990 791	117 291	-51 555	1 281 811	750 000	6 763 953

2.24 Në analizën e ligjshmërisë së kursimeve *cash* sipas versionit të dytë (tabela nr. 2, pika 43 e prapësimeve) në shumën 6,693,106 lekë deri në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit, përveçse merr në konsideratë të ardhurat nga bashkëshortja për vitet 2010 - 2012 në vlerën 1,150,000 lekë, të ardhurat nga trashëgimia e nënës në vitin 2012 në shumën 700,000 lekë, shpenzimet jetike për vitin 2007 llogaritur sa viti 2008, si dhe gjendjen *cash* sipas deklaramit në DIPP, me përjashtim të vitit 2014 ku përfshin si shtesë të gjendjes *cash* vlerën 1,281,811 lekë (pjesa e mbetur nga tërheqja e depozitave), të cilën kërkon që Komisioni ta marrë parasysh për arsye se: (i) kalimi i parave nga banka në shtëpi është e njëjta gjë; (ii) balanca pozitive për vitin 2014 llogaritur në shumën 1,576,145 lekë vjen pikërisht nga tërheqja e depozitave dhe mosdeklarimi i shtesës së gjendjes *cash*; (iii) periudha e shkurtër kohore nga tërheqja deri më 31.12.2014 dhe trendin e shpenzimeve të familjes në të gjithë periudhën e deklaramit; si dhe (iv) gjendjen e rënduar emocionale; (v) jurisprudencën e Kolegjit në raste të ngjashme (në seancën dëgjimore) – subjekti i është referuar vendimeve nr. 29/2002, nr. 1/2021 dhe nr. 1/2022 të Kolegjit.

Tabela nr. 8

Periudha	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Totali
PASURI	771 055	658 180	776 092	1 887 468	1 123 258	2 176 683	1 757 527	370 496	-379 523	
Ndryshim likuiditeti (bankë+cash)	771 055	788 180	776 092	1 887 468	1 123 258	2 176 683	1 757 527	-188 944	-379 523	
Likuiditet në bankë	1 691 095	179 275	555 367	1 242 834	1 366 092	1 942 775	2 600 302	1 129 547	24	
Likuiditet në cash	130 000	2 300 000	2 700 000	3 900 000	4 900 000	6 500 000	7 600 000	8 881 811	9 631 811	
<i>Shtesa cash</i>	130 000	2 170 000	400 000	1 200 000	1 000 000	1 600 000	1 100 000	1 281 811	750 000	
TE ARDHURA dokumentuar	1 367 291	1 407 700	1 681 317	2 257 771	2 185 793	2 679 135	1 667 311	2 310 100	1 355 287	
SHPENZIME	790 105	818 562	1 074 360	1 204 012	1 095 446	986 055	1 130 090	1 645 270	839 828	
Rezultati	-193 869	-69 041	-169 135	-833 709	-32 910	-483 604	-1 220 306	294 334	894 982	
Mundësia për të kursyer cash me të ardhura të ligjshme	0	2 100 959	230 865	366 291	967 090	1 116 396	-120 306	1 281 811	750 000	6 693 106

2.25 Në lidhje me pikën 4 të konkluzioneve “duket e dyshimtë marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri (apartament), të cilën duket se mund ta ketë blerë që në vitin 2010, por për shkak të mungesës së burimeve financiare e deklaroi blerjen e tij dhe e formalizon me kontratë shitblerje në vitin 2016”, subjekti pretendon se bazuar në arsyetimet e tij si më lart, me të cilat ka provuar të kundërtën e barrës së provës, ky dyshim i Komisionit është i pabazuar.

Vlerësimi i Komisionit

2.26 Në lidhje me pikën e parë të konkluzioneve, pretendimin e subjektit se ai nuk ndodhet përpara një trajtimi preferencial sepse ka miqësi shumë të mira familjare e shoqërore që nga fëmijëria dhe jo për shkak të detyrës, si dhe për faktin se Komisioni nuk ka konstatuar konflikt interesi midis subjektit dhe shoqërisë “***” sh.p.k. e drejtuesve të saj, Komisioni nuk e vlerëson bindës, për këto arsye:

- *Së pari*, vetë jurisprudenca³³ e Kolegjit, së cilës i referohet subjekti i rivlerësimit, ka pranuar³⁴ se favorizimet e subjektit nga persona fizikë apo juridikë për shkak të marrëdhënieve të ngushta të miqësisë konsiderohen si trajtim preferencial (dhe jo si konflikt interesi), pavarësisht se nuk ekzistojnë rrethana konflikti për shkak të detyrës. Gjithashtu, kjo jurisprudencë³⁵ pranon se trajtimi preferencial jo domosdoshmërisht lidhet me konfliktin e interesit dhe mund të ekzistojë edhe pa provuar gjendjen e këtij konflikti.

- *Së dyti*, pretendimi i subjektit në prapësime se për çmimin e blerjes së apartamentit është dakordësuar me miqtë e tij që në vitin 2005, ndërsa në pyetësin nr. 3 ka deklaruar se çmimi është dakordësuar në vitin 2006, ndërkohë që në deklaratën e datës 30.7.2020 znj. E. K., administratore e shoqërisë “****” sh.p.k., nuk ka deklaruar asgjë në lidhje me dakordësinë për çmimin, duken si përpjekje të subjektit të rivlerësimit për deklaruar një vit sa më të hershëm për të justifikuar çmimin e ulët në krahasim me vitet më pas.

2.27 Në vlerësimin e Komisionit, këto fakte tregojnë më shumë për një marrëdhënie të konsoliduar e të sigurtë të vetë subjektit të rivlerësimit me këtë pronë, që del jashtë kufijve normalë, logjikë e juridikë të shfrytëzimit të një marrëdhënieje huapërdorjeje. Gëzimi i të gjithë fryteve të një pasurie në raport të shproporcionuar me atë që duhet të ofrojë vetë marrëdhënia ligjore në bazë të së cilës mbahet sendi, të krijojnë mosbesim mbi vetë natyrën e marrëdhënies.

2.28 Në lidhje me detyrimin e subjektit për të deklaruar këtë trajtim preferencial, Komisioni sjell në vëmendje se ky detyrim i ka lindur subjektit në vitin 2012, kur me ligjin nr. 85/2012, që ndryshon ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, është shtuar germa “f” në nenin 4 të këtij ligji, që përcakton: “*Subjektet detyrohen të deklarojnë dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik apo juridik prej nga vijnë këto apo krijohen dhuratat ose trajtimet preferenciale*”. Referuar DIPP-së së vitit 2012 dhe DIPP-së më pas, nuk ka rezultuar që subjekti të ketë deklaruar ndonjë trajtim preferencial.

2.29 Për sa më lart, Komisioni nuk e mori në konsideratë prapësimin e subjektit për pikën e parë të konstatimeve.

2.30 Në lidhje me pikën e dytë të konkluzioneve të Komisionit, për të cilin subjekti ka prapësuar se referuar jurisprudencës³⁶ së Kolegjit dhe dispozitave të Kodit Civil mbi të drejtat reale, ai nuk ka pasur detyrimin e përcaktuar në nenin 4, germa “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, për deklarimin e të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme, Komisioni i referohet sërish këtij vendimi, sipas të cilit: “...posedimi i sendeve të paluajtshme deri në kalimin e titullit të pronësisë nuk konsiston në krijimin në favor të subjektit të rivlerësimit të ndonjë të drejte reale në sendin e tjetrit, për sa kohë nuk provohet që mbi këto sende të paluajtshme të jetë vendosur në favor të subjektit të rivlerësimit një hipotekë/servitut/e drejtë banimi apo përdorimi/uzufrukti apo enfiteozë”. Në këtë vështrim, rasti i subjektit të rivlerësimit Arben Kostandini paraqet situatën kur subjekti dhe shoqëria “****” sh.p.k. e pranojnë vetë që kanë pasur marrëdhënie huapërdorjeje të apartamentit dhe subjekti e ka përdorur për banim këtë apartament prej 6 vjetësh. Pra, provohet se

³³ Vendimet nr. 16/2020 dhe nr. 42/2022 i Kolegjit.

³⁴ Vendimi nr. 42/2022 (pikat 19.12, 19.18 dhe 19.19) të Kolegjit: “*Nga ana tjetër, dhënia e huas nga shoqëria ‘{***}’ sh.p.k. nuk mund të konsiderohet e dhënë në kushtet e një trajtimi preferencial ndaj subjektit të rivlerësimit për shkak të procedurës së prokurimit, por për shkak të marrëdhënies së miqësisë së ngushtë të administratorit dhe ortakëve të shoqërisë me subjektin e rivlerësimit, marrëdhënie e cila është konfirmuar nga vetë subjekti përpara se Komisioni të hetonte për këtë situatë dhe nuk duhet të kualifikohet si interes privat, kur nuk lidhet me ushtrimin e funksionit të drejtuesit të gjykatës*”.

³⁵ Vendimi nr. ***, f. 21, pika 14.7.

³⁶ Vendimi nr. 35, datë 15.12.2020, i Kolegjit.

subjekti e ka përdorur për banim këtë apartament si pronar sepse ka përcaktuar çmimin së bashku me shitësin që në fillim të marrëdhënies dhe bazuar në raportet e miqësisë ka pasur sigurinë që nuk do e humbiste të drejtën e përdorimit dhe banimit mbi këtë apartament. Neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”*.

2.31 Gjithashtu, subjekti ka qartësuar në seancën dëgjimore se që në vitin 2010, jo vetëm ka hyrë për banim në këtë apartament, por ka filluar ta përshtatë dhe arredoje sipas dëshirës së tij, fakt që lë të kuptohet edhe një herë se kishte sigurinë që ky apartament tashmë ishte i tij dhe po sillej në një aspekt si pronar i tij.

2.32 Në kontekst të kësaj situatë faktike dhe ligjore si më lart, subjekti i rivlerësimit kishte ndërgjegjësimitin e duhur për të deklaruar këtë marrëdhënie të tij me këtë pasuri. Mosdeklarimi i kësaj marrëdhënieje dhe përpjekja për ta justifikuar me shkakun se nuk kishte një dokument të shkruar, mund të konsiderohet si përpjekje e subjektit për të shmangur përgjegjësinë për mosdeklarimin e kësaj marrëdhënieje ndër vite, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

2.33 Për sa më lart, prapësimet e subjekti për këtë konstatim të Komisionit nuk janë bindëse dhe nuk merren në konsideratë.

2.34 *Në lidhje me pikën e tretë të konkluzioneve për mungesën e burimeve të ligjshme:*

- Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij në klinikat private. Vërtetimi i depozituar nga spitali “****”³⁷ nuk vërteton as shumën e përfutuar pranë këtij institucioni dhe as pagesën e detyrimeve tatimore.

- Subjekti ka bërë deklarime kontradiktore në lidhje me shumat e përfituara nga bashkëshortja e tij, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti pretendon të ardhura në shumën 650,000 lekë (2011 - 2012), ndërsa në DIPP-në e viteve 2010 – 2012 dhe në prapësime pretendon të ardhura në shumën totale 1,150,000 lekë.

- Deri në vitin 1997 (analizimi i mundësisë për ndërtimin e shtesës) prindërit e subjektit kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme. Për periudhën 1998 – 2002 analiza kumulative e familjes rezulton me balancë pozitive. Për vitet 2003 – 2006 analiza financiare e familjes së subjektit, pjesë e së cilës kanë qenë edhe prindërit e tij, rezulton gjithashtu me balancë pozitive. Duke qenë se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur detyrim për deklarim dhe se në periudhat e sipërcituara (1998 – 2002 dhe 2003 – 2006) analiza ka rezultuar me balanca pozitive, ata kanë pasur mundësi që gjatë kësaj kohe me të ardhura të ligjshme të kursejnë shumën 700,000 lekë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2012, si shumë e përfutuar nga trashëgimia.

- Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me balancën negative për vitin 2007, nuk qëndrojnë dhe, për këtë arsye, nuk merren në konsideratë nga Komisioni³⁸.

³⁷ Vërtetim datë 3.3.2003, i spitalit “****”.

³⁸ Shihni paragrafin 18.1, vendimi nr. 25/2021 (JR), datë 29.7.2021, subjekti i rivlerësimit A. Y. Komisioni i ka përlogaritur shpenzimet e jetesës për vitin 2007 sipas të dhënave të vitit 2006, duke zhvlerësuar standardet e raportuara nga institucioni i specializuar INSTAT dhe të përdorura ndër vite, me arsyetimin se vlera e përlogaritur është “dukshëm jo e saktë”, pasi duhet të ishte nën nivelin e vlerave zyrtare, të përcjella nga INSTAT-i ILDKPKI-së ndër vite. Kjo zgjedhje e Komisionit, në rastin e subjektit, bie ndesh me mënyrën e vlerësimit të këtij zëri shpenzimesh, të konsoliduar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit.

Autoriteti i vetëm i specializuar për të përcaktuar shpenzimet e jetesës është INSTAT-i, shkresës së të cilit i është referuar edhe Komisioni.

- Ligjshmëria e gjendjes *cash* sipas versionit të parë (tabela nr. 01, pika 36 e prapësimeve)³⁹, nga ku subjekti sipas përlllogaritjeve të tij rezulton me mundësi për të kursyer në shumën 6,763,952 lekë deri në vitin 2015, nuk qëndron, pasi subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat e bashkëshortes; pretendimi për llogaritjen e shpenzimeve jetike për vitin 2007 nuk qëndron; si dhe tërheqja e depozitave në vitin 2014 dhe mosdeklarimi i tyre si kursim *cash*, pavarësisht balancës pozitive të vitit, nuk provon se subjekti i ka kursyer ato për vitin 2014, për aq kohë sa ai nuk i ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 si shtesë të kursimeve *cash*. Ndër të tjera, pasqyrimi i gjendjes *cash* sipas versionit të parë të subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, pasi ai nuk përputhet as me deklaratimet periodike dhe as me përgjigjet e dhëna në pyetësor. Gjithashtu, në analizën financiare të përgjithshme (faqe 18 e prapësimeve) pasqyron një gjendje *cash* të ndryshme nga ajo e pasqyruar në tabelën nr. 1, të ndryshme edhe nga përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

- Ligjshmëria e gjendjes *cash* sipas versionit të dytë (tabela nr. 2, pika 43 e prapësimeve), nga ku subjekti sipas përlllogaritjeve të tij rezulton me mundësi për të kursyer në shumën 6,693,106 lekë deri në vitin 2015, nuk qëndron, pasi subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat e bashkëshortes; pretendimi për llogaritjen e shpenzimeve jetike për vitin 2007 nuk qëndron; si dhe tërheqja e depozitave në vitin 2014 dhe mosdeklarimi i tyre si kursim *cash*, pavarësisht balancës pozitive të vitit, nuk provon se subjekti i ka kursyer ato për vitin 2014, për aq kohë sa nuk i ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 si shtesë të kursimeve *cash*. Edhe pasqyrimi i gjendjes *cash* sipas versionit të dytë të subjektit nuk qëndron, sepse pavarësisht se ai merr në konsideratë deklaratimet periodike të gjendjes *cash* deri në vitin 2013, ndryshe nga Komisioni ai përlllogarit si shtesë të kursimeve *cash* për vitin 2014 edhe shumën 1,281,811 lekë, e cila nuk provohet të jetë deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 sipas ligjit nr. 9049/2003, por është vetëm deklarative.

- Në përfundim, për sa është arsyetuar më sipër, rezulton se nga analiza e rishikuar financiare, ligjshmëria e kursimeve *cash* deri më 31.12.2015 është në shumën 4,261,295 lekë (njohur vetëm të ardhurat nga trashëgimia e nënës prej 700,000 lekësh në vitin 2012).

Tabela nr. 8

Periudha	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Totali
PASURI	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-911,315		
Ndryshim likuiditeti (bankë+cash)	771,055	788,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-1,470,755		
Likuiditet në bankë	1,691,095	179,275	555,367	1,242,834	1,366,092	1,942,775	2,600,302	1,129,547		
Likuiditet në cash	130,000	2,300,000	2,700,000	3,900,000	4,900,000	6,500,000	7,600,000	7,600,000		
<i>Shtesa cash</i>	130,000	2,170,000	400,000	1,200,000	1,000,000	1,600,000	1,100,000	0		
TE ARDHURA dokumentuar	1,367,291	1,407,700	1,681,317	1,756,811	1,784,833	2,431,055	1,667,311	2,310,100		
SHPENZIME	1,286,845	818,562	1,074,360	1,204,012	1,095,446	986,055	1,130,090	1,645,270		
Rezutati	-690,609	-69,041	-169,135	-1,334,669	-433,870	-731,683	-1,220,306	1,576,145		
Mundësia për të kursyer cash me të ardhura të ligjshme	0	2,100,959	230,865	-134,669	566,130	868,317	-120,306	0	750,000	4,261,295

Për rrjedhojë, subjekti ka pasur mungesë burimesh të ligjshme prej -2,738,705 lekësh për blerjen e apartamentit, paraqitur në tabelën nr. 9 si vijon:

³⁹ Kursimet *cash* në këtë version për vitet 2014 - 2015 ndryshojnë nga përgjigjet e dhëna në pyetësorin nr. 2.

Tabela nr. 9

	Përshkrimi	
a)	Burimet	6,761,295
1	Kursime <i>cash</i> ndër vite me burime të ligjshme	4,261,295
2	Kredi bankare në ABI Bank, datë 20.10.2016	2,500,000
b)	Pasuri	9,500,000
1	Apartament me sip. 126 m ² , blerë më 23.9.2016	
2	* Paguar me depozitim <i>cash</i> në llogarinë e noterit J. Zh., datë 23.9.2006, me burim kursimet <i>cash</i>	7,000,000
3	* Transferuar në llogarinë e noterit J. Zh., datë 20.10.2016, me burim kredinë bankare	2,500,000
c)	Mundësia financiare për blerjen e apartamentit	- 2,738,705

2.35 Në lidhje me konkluzionin përmbledhës të Komisionit se: “*Duket e dyshimtë marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri (apartament), të cilën ai duket se mund ta ketë blerë që në vitin 2010, por për shkak të mungesës së burimeve financiare e deklaroi blerjen e tij dhe e formalizoi me kontratë shitblerjeje në vitin 2016, për efekt të ligjit të Vetting-ut në vitin kur u miratua ky ligj*”, Komisioni i referohet pikërisht vendimit nr. 35, datë 15.12.2020, të Kolegjit, sipas të cilit: “*...trupi gjykues e gjen të padrejtë e të pabazuar konkluzionin e Komisionit për marrëdhënie të dyshimta huapërdorje, për sa kohë asnjë nga situatat e parashikuara në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, për të cilat përcaktohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, jo vetëm nuk ka rezultuar e provuar gjatë hetimit administrativ, por as dyshime të arsyeshme nuk janë ngritur në drejtim të sa më sipër*”.

2.36 Në rastin konkret, nisur nga rrethanat e: (i) përdorimit për banim të apartamentit me sipërfaqe të konsiderueshme prej 126 m², për një periudhë të gjatë kohore, të pandërprerë dhe pa kundërshtim (kur palët duke përfitur nga marrëdhënia miqësore e pretenduar mund të ishin dakordësuar edhe për shlyerje me këste të çmimit të apartamentit); (ii) përcaktimit të çmimit të apartamentit disa herë më të ulët se çmimi zyrtar referencë dhe se çmimi i kontratave të ngjashme; (iii) konfirmimit zyrtar nga FSHU-ja se subjekti ka lidhur kontratë dhe ka konsum të energjisë elektrike që në shtator të vitit 2010; (iv) mosdeklarimit të përdorimit të apartamentit në asnjë DIPP vjetore dhe as të adresës së tij si adresë të dytë banimi, por vetëm në pyetësor gjatë hetimit *Vetting*; (v) mosdeklarimit të trajtimit preferencial nga ana e subjektit; si dhe (vi) mosformalizimit të marrëdhënies së pretenduar të përdorimit me një akt të shkruar – atëherë marrëdhënia e subjektit me këtë pasuri bëhet e dyshimtë, duke çuar drejt dyshimit të arsyeshëm se subjekti ndër vite ka ndërmarrë hapa për të fshehur këtë pasuri për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare dhe formalizimin e saj vetëm në prag të deklarimit *Vetting*, ndërsa në deklarimin *Vetting* ka ndërmarrë hapa për të deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë pasuri dhe, për rrjedhojë, nuk arriti të bindë Komisionin për të kundërtën e këtij konstatimi.

2.37 Në vlerësimin e Komisionit, këto fakte tregojnë më shumë për një marrëdhënie të konsoliduar e të sigurt të vetë subjektit të rivlerësimit me këtë pronë, që del jashtë kufijve normalë, logjikë e juridikë të shfrytëzimit të një marrëdhënieje huapërdorjeje. Gëzimi dhe përdorimi i kësaj pasurie në raport të drejtë me atë që duhet të ofrojë vetë marrëdhënia ligjore në bazë të së cilës mbahet sendi, të krijojnë mosbesim mbi vetë natyrën e marrëdhënies.

2.38 Për këto arsye edhe ky konkluzion i Komisionit është i bazuar në vështrim të vendimit nr. 35, datë 15.12.2020, të Kolegjit.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- Ka përfituar trajtim preferencial nga shoqëria “****” sh.p.k., për shkak të blerjes me çmim disa herë më të ulët të apartamentit krahasuar me çmimin referencë dhe çmimin e kontratave të ngjashme, si dhe në lidhje me lënien e këtij apartamenti në përdorim për 6 vjet rresht pa kundërshtëpërblim, ndërkohë që nuk ka bërë deklarime në lidhje me këtë trajtim preferencial.

- Nuk ka deklaruar përdorimin e apartamentit pa kundërshtëpërblim në DIPP-të e viteve 2010 – 2016 dhe as adresën e këtij apartamenti si adresë banimi, pavarësisht përdorimit të tij.

- Ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën -3,438,705 lekë për të blerë apartamentin me sip. 126 m² nga shoqëria “****” sh.p.k.

- Qëndron dyshimi i arsyeshëm se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ndër vite këtë marrëdhënie me këtë pasuri (apartament), për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare dhe për ta formalizuar atë vetëm në vitin 2016, për efekt të procesit të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, veprime këto që në tërësinë e tyre të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia.

3. Automjet tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 2002, me targa *, sipas kontratës nr. ***, datë 30.5.2014, notere Sh. Gj.. Vlera: 4,000 euro. Pjesa takuese: 100%.**

Burimi i krijimit: kursimet ndër vite.

3.1 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: “*Blerje automjeti tip ‘Mercedes-Benz’ ***, me kontratë nr. ***, datë 30.5.2014. Vlera: 4,000 lekë*”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

3.2 DPSHTRR-ja ka depozituar⁴⁰ pranë Komisionit dosjen e këtij automjeti, ku rezulton se sipas faturës së shitjes shtetasi F. H. e ka blerë automjetin tip “Daimler Chrysler 200 CDI”, viti i prodhimit 2002, në Gjermani në vlerën 3,200 euro dhe e ka zhdoganuar në datën 26.5.2014 përkundëjt pagesës prej 93,992 lekësh. Pra, vlera totale e automjetit shkon 541,416 lekë (139.82 euro/lekë x 3,200 euro = 447,424 + 93,992 lekë = 541,416 lekë). Me kontratë shitblerjeje⁴¹ datë 30.5.2014, shtetasi F. H. ia ka shitur automjetin subjektit në vlerën 4,000 euro ose 559,440 (4,000 euro x 139,86 euro/lekë).

3.3 Komisioni hetoi për konflikt interesi midis subjektit dhe shtetasit F. H., por nuk konstatoi⁴² ndonjë situatë të tillë.

Analiza e mundësisë financiare për krijimin e kësaj pasurie

3.4 Në pyetësin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të shpjegojë cilave kursime i referohet (*cash* apo bankë) kur deklaroi si burim krijimi “kursimet ndër vite” për këtë automjet. Në përgjigje subjekti shpjegon se automjeti është blerë në datën 30.5.2014 në shumën 4,000 euro, nga të cilat 3,000 euro janë nga shitja e automjetit tip “Alfa Romeo” me targa *** dhe pjesa tjetër prej 1,000 euro nga kursimet *cash* të vitit 2014.

3.5 Në lidhje me automjetin tip “Alfa Romeo” me targa ***, që subjekti e pretendon si një nga burimet e krijimit të automjetit tip “Mercedes-Benz”, Komisioni vëren se në DIPP-në e vitit 2014

⁴⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.11.2022, të DPSHTRR-së drejtuar Komisionit.

⁴¹ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 30.5.2014.

⁴² Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

subjekti ka deklaruar: “Shitje automjeti tip ‘Alfa Romeo’ me targa ***, me kontratë nr. ***, datë 29.7.2014. Vlera: 3,000 euro”. Gjatë hetimit për këtë automjet, ka rezultuar se:

3.6 DPSHTRR-ja ka depozituar⁴³ pranë Komisionit dosjen e automjetit tip “Alfa Romeo”, me këto dokumente: (a) certifikatë pronësie automjeti, datë 27.1.2004, lëshuar nga regjistri automobilistik italian, në emër të shtetasit A. S.; (b) akt zhdoganimi automjeti, datë 18.4.2004, me eksportues A. S. dhe importues Arben Kostandini, në vlerën totale 348,487 lekë (200,000 lekë çmimi i blerjes + 148,487 lekë taksa zhdoganimi e paguar nga subjekti sipas mandatit datë 18.4.2004 në Bankën e Kursimeve); (c) kontratë shitjeje⁴⁴ datë 3.1.2004, e lidhur midis shitësit A. S. dhe blerësit Arben Kostandini për blerjen e automjetit me çmimin 200,000 lekë; (ç) certifikatë pronësie datë 8.7.2009, e automjetit në emër të subjektit; dhe (d) kontratë shitjeje⁴⁵ datë 29.7.2014, e lidhur midis shitësit Arben Kostandini dhe blerësit A. A., për shitjen e këtij automjeti kundrejt çmimit 3,000 euro, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

3.7 Komisioni vëren se çmimi i blerjes së automjetit tip “Alfa Romeo”, i deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2003, nuk përputhet me çmimin e kontratës plus taksat e zhdoganimit, si dhe vëren se çmimi i shitjes është më i lartë se çmimi i blerjes i deklaruar, duke rezultuar një shitje me fitim.

3.8 Për sa më lart, subjekti ka shpjeguar në pyetësin nr. 2 se mospërputhja ka ndodhur për shkak se në vlerën e mjetit është përfshirë vlera e kontratës së blerjes, shpenzimet e zhdoganimit, pagesat për targat dhe taksat vjetore të atij viti, të cilat në total shkojnë 400,000 lekë. Për diferencën e çmimit të shitjes me çmimin e blerjes, nuk ka paguar tatim, pasi automjetit i ka bërë shërbime të cilat ia kanë rritur vlerën, shpenzime këto që janë pasqyruar në librin e automjetit që ia ka dorëzuar blerësit bashkë me automjetin dhe nuk ka asnjë kontakt me blerësin që nga koha e gjatë e shitjes.

3.9 Nga analiza e krahasimit të çmimit të blerjes së deklaruar të automjetit tip “Alfa Romeo”, me çmimin e shitjes së tij, duke marrë në konsideratë kursin e këmbimit të euros në datën 29.7.2014, kur është shitur automjeti nga subjekti, rezulton se subjekti e ka blerë këtë automjet në vlerën 400,000 lekë (përfshirë çmimin kontraktor, taksat doganore, targat dhe shpenzimet për taksat) dhe e ka shitur në çmimin 417,390 lekë, duke realizuar kështu 17,390 lekë fitim.

3.10 Shpjegimet e subjektit në lidhje me rritjen e vlerës së automjetit tip “Alfa Romeo” janë deklarative dhe nuk provohen me dokumentacion ligjor, prandaj Komisioni ka marrë në analizë financiare si vlerë të shitjes së mjetit vetëm shumën 400,000 lekë.

Analiza financiare e burimit të krijimit të automjetit

3.11 Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e krijimit të pasurisë automjet tip “Alfa Romeo” me vlerë 400,000 lekë, konkretisht pagesën e çmimit të blerjes 200,000 lekë në datën 3.1.2004 dhe pagesën e taksës doganore, taksë regjistrimi etj., në datën 18.2.2004, në shumën 200,000 lekë.

3.12 Nga leximi i DIPP-së së vitit 2003, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* dhe, për këtë arsye, duket se në datën 3.1.2004 ai nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të paguar shumën 200,000 lekë. Në datën 18.2.2004 të ardhurat totale për familjen e subjektit të rivlerësimit janë në shumën 178,287 lekë⁴⁶ dhe shpenzimet jetike janë në vlerën 61,719 lekë.

⁴³ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.11.2022, të DPSHTRR-së drejtuar Komisionit.

⁴⁴ Kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 3.1.2004.

⁴⁵ Kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 29.7.2014, e noterit I. I., e konfirmuar nga noteri me shkresën datë 27.11.2022.

⁴⁶ Të ardhurat për muajt janar - shkurt 2004 janë: për subjektin 123,316 lekë; për bashkëshorten 32,227 lekë; dhe për nënën e subjektit 16,794 lekë.

Mundësia për kursime në datën 18.2.2004, pas zbritjes së shpenzimeve jetike, është 116,568 lekë, pra më e vogël se shuma 200,000 lekë e paguar për blerjen e automjetit, taksën doganore, taksën e regjistrimit etj.

3.13 Në përfundim, sipas analizës financiare të kryer deri në datën 18.2.2004, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh financiare në shumën 283,432 lekë, paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr. 10

	Përshkrimi	Periudha 1.1.2004 – 18.2.2004
a)	Të ardhurat	178,287
1	Të ardhura nga paga e subjektit	123,316
2	Të ardhura nga paga e bashkëshortes	32,227
3	Të ardhura nga pensioni i nënës	22,744
b)	Detyrime	0
c)	Shpenzime	61,719
1	Shpenzime jetike	61,719
d)	Pasuri	400,000
1	Blerë automjet	400,000
	Mundësia financiare për blerjen e automjetit	-283,432

3.14 Për sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën -283,432 lekë për krijimin e pasurisë automjet tip “Alfa Romeo” në datën 18.2.2004.

3.15 Në vijim të analizës për automjetin tip “Mercedes-Benz”, për sa më lart, Komisioni vëren se deklarimi i subjektit në pyetësoin nr. 2 në lidhje me burimin e krijimit të automjetit tip “Mercedes Benz” është kontradiktor me deklarimin *Vetting*, por edhe fakti që automjeti tip “Alfa Romeo” është shitur nga subjekti në datën 29.7.2014, nuk e bën të mundur që shuma 3,000 euro, e përfituar prej tij nga shitja e këtij automjeti, të ketë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në datën 30.5.2014, pra 2 muaj përpara se të shiste automjetin tip “Alfa Romeo”.

3.16 Në lidhje me shumën 1,000 euro, për të cilën subjekti deklaroi si burim “kursimet *cash* të vitit 2014”, Komisioni analizoi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për krijimin e shumës 1,000 euro me të ardhurat e vitit 2014, që e ka përdorur më pas për pagesën e çmimit në datën 30.5.2014.

3.17 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti kishte mundësi të krijonte 1,000 euro nga të ardhurat e vitit në datën 30.5.2014.

3.18 Në përfundim, pas analizimit të burimeve të deklaruara, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë burimesh të ligjshme në shumën 3,000 euro, ose 419,580 lekë, për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” me çmim 4,000 euro.

Tabela nr. 11

	Përshkrimi	
	Burimet	139,860
1	Të ardhura nga shitja e mjetit, datë 29.7.2014 – 3,000 euro	0
2	Të ardhurat e vitit 2014 kursyer deri më 30.5.2014 – 1,000 euro	139,860
	Pasuri	559,440
1	Automjet tip “Mercedes-Benz”, ***, datë 30.5.2014, me çmim 4,000 euro	559,440
	Mundësia financiare për blerjen e automjetit	-419,580

3.19 Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket që subjekti i rivlerësimit:

- Nuk ka deklaruar burimin e krijimit të automjetit tip “Mercedes-Benz” në DIPP-në e vitit 2014.
- Nuk ka pasur burime të ligjshme në shumën 3,000 euro për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në datën 30.5.2014, pasi të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Alfa Romeo” janë përfituar në datën 29.7.2014, pra 2 muaj pas blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”.
- Ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën -283,432 lekë për krijimin e pasurisë automjetit tip “Alfa Romeo”, në datën 18.2.2014.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

3.20 Në lidhje me konkluzionin e parë dhe të dytë, në prapësime subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si në pyetësorë, pra automjeti është blerë në datën 30.5.2014, në shumën 4,000 euro, nga të cilat 3,000 euro janë nga shitja e automjetit tip “Alfa Romeo” me targa *** dhe pjesa tjetër prej 1,000 euro nga kursimet *cash* të vitit 2014.

3.21 Në fund të vitit 2013, ashtu siç ka konstatuar edhe Komisioni, subjekti prapëson se ka pasur likuiditete bankare. Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktësisht burimin “kursimet ndër vite”. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka vlerësuar se atë vit, në finale, ka ndërruar automjetin e vjetër me të ri dhe pa iu referuar llogaritjeve konkrete ka menduar se për automjetin e ri ka shpenzuar vetëm 1,000 euro shtesë, meqenëse 3,000 euro i kishte marrë nga shitja e automjetit të mëparshëm. Pavarësisht sa më sipër, subjekti shpjegon se i qëndron burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe se për shkak të tërheqjeve nga llogaritë bankare të bashkëshortes më 5.2.2014, në datën e blerjes së automjetit 30.5.2014 ka pasur mjaftueshëm likuiditete për të paguar vlerën e automjetit prej 4,000 euro. Në vijim, subjekti kërkon që analiza financiare për blerjen e automjetit në vitin 2014 duhet që të vlerësohet bazuar në analizën financiare të vitit 2014, ku edhe bazuar në analizën bashkëlidhur nga subjekti, rezulton se automjeti është krijuar me të ardhura të ligjshme.

3.22 Në lidhje me konkluzionin e tretë të Komisionit se: “Subjekti duket që ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën -283,432 lekë për krijimin e pasurisë automjetit tip ‘Alfa Romeo’ në datën 18.2.2014”, subjekti ka pretenduar se Komisioni ka përlllogaritur mundësinë e tij që nga data 1.1.2004, por edhe pse automjeti është blerë në vitin 2004 ai është deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 dhe, për këtë arsye, nuk është deklaruar vlera e kursimeve që ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti. Meqë analiza financiare e vitit 2003 rezulton pozitive në shumën 428,000 lekë, atëherë subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie. Gjithashtu, subjekti deri në vitin 2003 ka jetuar në ekonomi të përbashkët familjare me prindërit dhe një pjesë e të ardhurave administroheshin prej tyre dhe shpenzimet mbuloheshin edhe nga kursimet e tyre ndër vite.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni vëren se:

3.23 Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” me targa ***, në datën 30.5.2014, qëndrojnë, pasi provohet nga veprimet bankare në datën 5.2.2014 se shumat që bashkëshortja e subjektit ka tërhequr *cash* nga banka janë në vlerën totale prej 2,505,225 lekësh, pra disa herë më të larta se vlera 4,000 euro e blerjes së mjetit, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me barrën e provës janë në harmoni me burimin e krijimit të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

3.24 Edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Alfa Romeo”, qëndrojnë pasi jo vetëm provohet nga deklaratimet e pasurisë së subjekti e ka deklaruar blerjen e automjetit në deklaratën e vitit 2003 (plotësuar në datën 19.3.2004), pavarësisht se është blerë në janar/shkurt 2004, por subjekti ka rezultuar me balancë pozitive për vitin 2003. Duke qenë se në vitin 2003 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit (në datën 18.2.2004), ai nuk ka deklaruar kursimet *cash* në këtë vit (data e deklaratës 19.3.2004), pasi ato janë konsumuar pikërisht për blerjen e kësaj pasurie.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

4. Gjendje *cash* në banesë. Vlera: 300,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: _____.

4.1 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Kursyer 300,000 lekë, gjendje cash në banesë*”.

4.2 Deklarimi i gjendjes *cash* në deklaratën *Vetting*, datë 25.1.2017, përputhet me deklarin e gjendjes *cash* të deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 në shumën 300,000 lekë.

4.3 Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të krijuar gjendjen *cash* prej 300,000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *Vetting*, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit për vitin 2016 ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 3,128,203 lekë, për të mbuluar shpenzimet, për të krijuar pasuritë dhe për të shtuar gjendjen *cash* të deklaruar.

4.4 Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket që subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në vitin 2016 për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, ndër të cilat edhe vlerën 300,000 lekë kursime *cash*, të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se pas rillogaritjes së gjendjes së ligjshme *cash*, rezultati financiar për vitin 2016 për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, ndër të cilat edhe vlera 300,000 lekë kursime *cash*, ka rezultuar pozitiv.

Vlerësimi i Komisionit

4.6 Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me elementët e analizës financiare nuk qëndrojnë në atë masë sa balanca e vitit 2016 të rezultojë pozitive.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në vitin 2016 për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, ndër të cilat edhe krijimin e vlerës 300,000 lekë kursime *cash*, të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

5. Të ardhura nga trashëgimia e nënës në vitin 2012. Vlera: 700,000 lekë.

Burimi i krijimit: _____.

5.1 Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga trashëgimia e nënës. Vlera: 700,000 lekë*”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

5.2 Në pyetësonin nr. 2, në lidhje me burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, subjekti ka shpjeguar se ka jetuar me prindërit deri kur ata kanë ndërruar jetë dhe shpenzimet e jetesës kanë

qenë të përbashkëta. Gjatë gjithë jetës së tyre prindërit kanë kursyer shumën 700,000 lekë dhe një pjesë të pensionit të tyre e kanë pasur *cash* në banesë.

Analiza financiare e mundësisë së kursimit të shumës 700,000 lekë nga prindërit

5.3 Komisioni, për të verifikuar mundësinë për kursime në shumën 700,000 lekë në vitin 2012 nga prindërit e subjektit, me burim të ardhurat nga pagat dhe pensionet e tyre, mori në konsideratë këto rrethana: (i) faktin e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit se ai ka jetuar bashkë me prindërit; (ii) të ardhurat e krijuara deri në vitin 2006 janë konsumuar për ndërtimin e shtesës me sip. 41 m², të apartamentit në rrugën “****”; (iii) prindërit e subjektit nuk kanë detyrim për të deklaruar.

5.4 Në vijim të rrethanave më lart, Komisioni, për të verifikuar mundësinë për kursime në shumën 700,000 lekë, analizoi të ardhurat e krijuara nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, duke filluar nga viti 2007 deri në vitin 2012, pasi të ardhurat e krijuara deri në vitin 2006 janë konsumuar për ndërtimin e shtesës me sip. 41 m², të apartamentit në rrugën “*****”.

5.5 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme për periudhën 2007 – 2012 dhe në këto kushte nuk kanë pasur mundësi që prindërit e subjektit të kursejnë shumën 700,000 lekë.

5.6 Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket se nëna e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme financiare për të kursyer shumën 700,000 lekë deri në vitin 2012.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.7 Në prapësime, subjekti pretendon se nga analiza financiare deri në vitin 2002 është me rezultat pozitiv në shumën 1,858,670 lekë, e mjaftueshme kjo për të mbuluar shumën 700,000 lekë që i ka kaluar nëna në vitin 2012.

5.8 Nga analiza financiare, bashkëlidhur prapësimeve, është përlogaritur edhe pensioni i babait, i cili deri në datën 31.12.2002 është në shumën 1,105,659 lekë, ndërsa nëna ka pasur mundësi që të kursejë shumën 700,000 lekë. Kjo shumë është deklaruar rregullisht në DIPP-në e vitit 2012, si rrjedhojë, bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016 dhe në jurisprudencën e Kolegjtit, e ardhura që nëna kishte mundësi të krijonte me të ardhura të ligjshme duhet të përfshihet në analizën financiare.

Vlerësimi i Komisionit

5.9 Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me të ardhurat nga trashëgimia prej 700,000 lekësh, të deklaruara në DIPP-në e vitit 2012, qëndrojnë dhe, për këtë arsye, i ka përfshirë ato në analizën financiare të rishikuar.

5.10 Komisioni, pasi mori në konsideratë kryerjen e investimit në vitin 1996 - 1997, analiza kumulative e familjes për periudhën 1998 – 2002 rezultoi me balancë pozitive. Gjithashtu, edhe për vitet 2003 – 2006 analiza financiare e familjes së subjektit, pjesë e së cilës kanë qenë edhe prindërit e tij, rezultoi me balancë pozitive. Duke qenë se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur detyrim për deklarim dhe se në periudhat e sipërcituara (1998 – 2002 dhe 2003 – 2006) analiza ka rezultuar me balanca pozitive, ata kanë pasur mundësi që gjatë kësaj kohe me të ardhura të ligjshme të kursejnë shumën 700,000 lekë të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2012, si shumë e përfituar nga trashëgimia.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

6. Të ardhura nga kontrata e qirasë me nr. *, datë 16.9.2016, nga data 1.9.2019 deri më 31.10.2016** (lapsus në deklarin nga subjekti, duhet 1.9.2016 – 31.12.2016)⁴⁷. **Vlera: 144,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

Deklarimi ndër vite:

6.1 Në DIPP 2016-në e vitit, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga kontratat e qirasë nr. ***, datë 16.9.2016, nga data 1.9.2016 deri në datën 31.10.2016. Vlera: 144,000 lekë*”.

6.2 Në DIPP-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga kontratat e qirasë nr. ***, datë 16.9.2016, nga data 1.1.2017 deri në datën 31.12.2017. Vlera: 408,000 lekë*”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

6.3 Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka depozituar: (a) kontratë qiraje, datë 16.9.2016, e lidhur midis qiradhënësit Arben Kostandini dhe qiramarrësit G. M., për dhënien me qira të apartamentit me sip. 75,50 m², kundrejt vlerës 40,000 lekë/muaj, për një afat 2-vjeçar, qira e cila fillon nga data 1.9.2016; (b) urdhërpagesë të detyrimit tatimor mbi të ardhurat nga qiraja për muajt tetor - dhjetor 2016.

6.4 DRT-ja Tiranë konfirmon⁴⁸ se subjekti ka deklaruar dhe paguar detyrimin tatimor mbi të ardhurat nga qiraja për periudhën tetor 2016 – janar 2021.

6.5 Komisioni, referuar pagesave të kryera për tatimin, ka përfshirë në analizën financiare për vitin 2016 të ardhura *neto* nga qiraja në shumën 102,000 lekë [3 muaj x (40,000 lekë/muaj qiraja bruto – 6,000 lekë/muaj tatimi mbi qiranë) = 102,000 lekë].

6.6 Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket që në lidhje me vlerën e qirasë së përfutur për vitin 2016, subjekti ka bërë deklarin të pasaktë të kësaj vlere me një diferencë prej 42,000 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

6.7 Subjekti i rivlerësimit në prapësime shpjegon se ka bërë lapsus në përlllogaritjen e vlerës së qirasë sepse vlera e saktë është 136,000 lekë dhe jo 144,000 lekë (vlera e deklaruar), pasi tatimi në burim është përlllogaritur 4 x 40,000 lekë – 10%, ndërkohë që tatimi i paguar është 15%.

Vlerësimi i Komisionit

6.8 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse. Vlera e qirasë e llogaritur nga Komisioni prej 102,000 lekësh ka të bëjë jo vetëm me përqindjen e tatimit 10% të deklaruar nga subjekti, por edhe me mospagesën e tatimit për muajin shtator 2016. DRT-ja Tiranë konfirmon pagesën e tatimeve për muajt tetor - dhjetor 2016 dhe nuk konfirmohet pagesa për muajin shtator 2016. Pra, subjekti ka llogaritur të ardhura nga qiraja për 4 muaj x 40,000 lekë/muaj = 160,000 lekë – 16,000 lekë (10% tatimi) = 144,000 lekë. Komisioni ka përlllogaritur të ardhura nga qiraja 3 muaj x 40,000 lekë/muaj = 120,000 lekë – 18,000 lekë (15% tatimi) = 102,000 lekë.

⁴⁷ Referuar përgjigjes nr. 6, që subjekti ka dhënë në pyetësin nr. 1, ku ka deklaruar se ka marrë qiranë e apartamentit nga data 1.9.2016 deri në datën 31.7.2020, me vlerë 40,000 lekë/muaj, nga të cilat 60 lekë/muaj ka paguar tatimet në burim, si dhe referuar përlllogaritjeve të vlerës së qirasë dhe vlerës së tatimeve, duket se deklarimi në deklaratën *Vetting*, i periudhës së qirasë 1.9.2019 – 31.10.2016, është lapsus i subjektit dhe duhet të ishte periudha 1.9.2016 – 31.12.2016, gjatë së cilës krijohet shumta e të ardhurave nga qiraja prej 144,000 lekësh.

⁴⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2021, drejtuar Komisionit.

Diferenca 144,000 lekë – 102,000 lekë = 42,000 lekë është vlera e të ardhurave nga qiraja që subjekti ka deklaruar më tepër.

Për sa më lart, në lidhje me pasurinë “Të ardhura nga kontrata e qirasë nr. *, datë 16.9.2016, nga data 1.9.2016 deri në datën 31.12.2016, vlera 144,000 lekë”, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të kësaj vlere, me një diferencë prej 42,000 lekësh më tepër.**

7. Të ardhura nga puna e bashkëshortes në klinika private (jashtë orarit të punës) si mjeke laborator për vitet 2011 – 2012. Vlera: 650,000 lekë.

7.1 Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Paga e bashkëshortes mjeke, klinika mjekësore private ‘***’, Tiranë, shuma 500,000 lekë”*.

7.2 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Të ardhura nga puna jashtë orarit e bashkëshortes, klinika private Tiranë, shuma 400,000 lekë”*.

7.3 Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Të ardhura nga puna jashtë orarit e bashkëshortes, shuma 250,000 lekë”*.

7.4 Në pyetësin nr. 2, subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e tij, gjatë kohës që punonte si mjeke bakterologe në spitalin obstetrik gjinekologjik “****”, ka punuar jashtë orarit në disa klinika mjekësore private për vitet 2010 – 2014. Një pjesë e pagës nga kjo punë është mbajtur nga vetë subjekti (klinika e cila duhet të ketë derdhur edhe tatimet) dhe pjesën tjetër e ka përfituar nga puna e saj (jashtë orarit të punës). Për periudhën 2010 – 2012 janë deklaruar të ardhurat e fituara në vlerën 400,000 lekë dhe të ardhurat e fituara në vitin 2013 në vlerën 250,000 lekë. Subjekti shpjegon se nuk e di cilat janë klinikat private ku ka punuar bashkëshortja, pasi ajo nuk ka pasur kontratë pune dhe nuk është në dijeni nëse janë paguar tatimet nga këto klinika, prandaj, meqenëse edhe bashkëshortja nuk jeton më, në bazë të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, është në pamundësi objektive për të provuar këtë fakt.

7.5 Komisioni vëren se subjekti nuk provoi burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk i përfshiu këto të ardhura në analizën financiare.

7.6 Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket që të ardhurat e bashkëshortes në vlerën 650,000 lekë, të deklaruara në deklaratën *Vetting*, janë të ardhura të paligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

7.7 Në prapësime subjekti ka shpjeguar se në kushtet kur në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* bashkëshortja e tij kishte ndërruar jetë dhe në kushtet kur nuk i ka ruajtur DIPP-të vjetore, atëherë të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja duhet të përfshihen në analizën financiare bazuar në të dhënat e pasqyruara në DIPP-të vjetore, pasi: këto të ardhura për vitin 2010 (500,000 lekë), vitin 2011 (450,000 lekë) dhe vitin 2012 (250,000 lekë) janë deklaruar në DIPP-të përkatëse; bashkëshortja që i ka realizuar këto të ardhura nuk jeton më; kanë kaluar 11 vjet nga fundi i realizimit; sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, detyrimin për mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim e ka shoqëria/personi fizik që përfiton shërbimin dhe bashkëshortja e tij nuk ka qenë në dijeni për mospërmbushjen e këtij detyrimi nga subjekti tregtar. Për gjithë këto arsye, subjekti pretendon se ndodhet në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016.

7.8 Subjekti i ka bashkëlidhur prapësimeve vërtetimin datë 3.3.2023, nga spitali “****”, i cili konfirmon se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk ka ruajtur kontratën e shërbimit dhe

dokumentacionin e pagesave të kryera, prandaj nuk mund të konfirmojë as shumën e të ardhurave të përfituara dhe as pagesën e tatimit, por vetëm marrëdhënien e punësimit me bashkëshorten e subjektit në vitet 2010 – 2012.

Vlerësimi i Komisionit

7.9 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes së tij të deklaruara dhe pagesën e tatimit mbi këto të ardhura, pasi: deklarimi *Vetting* i të ardhurave nuk përputhet me deklaratimet periodike; subjekti nuk provoi pamundësinë objektive për të qenë në kushtet e nenit 32/2, pasi nuk paraqiti asnjë kërkesë drejtuar DPT-së për pagesën e tatimit në burim nga spitali “***” apo ndonjë institucion tjetër me të cilin bashkëshortja e tij ka pasur marrëdhënie shërbimi. Për këto arsye, Komisioni nuk i mori në konsideratë këto të ardhura në analizën financiare.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se të ardhurat e bashkëshortes në vlerën 650,000 lekë, të deklaruara në deklaratën *Vetting*, janë të ardhura të paligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

8. Analiza financiare për vitet 2003 – 2016

8.1 Nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe asaj *Vetting* për periudhën e hetimit 2003 – 2016, të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën -9,384,928 lekë për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasuritë.

8.2 Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Periudha	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A.PASURI	1,572	0	400,000	432,995	1,652,788	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-911,315	-379,523	6,239,624
Apartament me sip. 75.2 m ² dhe 40 m ² shtesë në Rr. *****, Tiranë	1,572				1,035,742										
Apartament me sip. 126 Rr. *****, Tiranë															9,500,000
Autoveturë tip Mercedes Benz, viti prodhimit 2002, me targa ***													559,440		
Autoveturë tip Alfa Romeo, viti prodhimit 1995, me targa ***			400,000												
DIFERENCA LIKUIDITETI (LIK. AKTUAL - LIKUIDITETI)	0	0	0	432,995	617,046	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-1,470,755	-379,523	-3,260,376
B.DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2,454,043
Kredi në *** në dt. 13.10.2016 në shumën 2,500,000															2,454,043
C.PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	1,572	0	400,000	432,995	1,652,788	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-911,315	-379,523	3,785,581
D.TE ARDHURA dokumentuar	3,789,473	881,847	1,086,175	1,242,597	1,293,162	1,367,291	1,407,700	1,681,317	1,757,771	1,785,793	1,729,135	1,667,311	2,310,100	1,355,287	1,630,173
Të ardhura nga paga ime si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë	2,668,730	605,088	760,361	773,592	800,891	831,863	821,670	992,386	1,007,523	1,002,664	1,014,400	1,033,631	1,238,092	1,240,764	1,411,949
Të ardhura nga paga e bashkëshortes si mjekje	373,260	144,886	179,812	304,523	314,957	350,975	389,311	476,570	480,382	549,380	212,604	633,680	672,008	0	0
Të ardhura nga puna e bashkëshortes në klinika private															
Të ardhura nga trashëgimia e nënës në vitin 2012											0				
Të ardhura nga kontrata e qerasë nr. ***, datë 16.9.2016															102,000
Pension familjar për djalim														114,523	116,224
Të ardhura nga pensioni i nënës	747,483	131,873	146,002	164,482	177,314	184,453	196,719	212,360	227,472	233,749	224,409				
Të ardhura nga pensioni i babait															
Të ardhura nga interesat bankare											60,234				
Të ardhura nga DRSSH (sipas bankave)									42,394		217,488				
Të ardhura nga shënjë e mjetit													400,000		
E.SHPENZIME	2,624,453	453,676	469,320	547,785	547,785	1,286,845	818,562	1,074,360	1,204,012	1,095,446	986,055	1,130,090	1,645,270	839,828	972,795
Shpenzime jetike	2,474,453	453,676	469,320	547,785	547,785	1,179,840	683,100	683,100	683,100	683,100	693,368	564,096	879,992	672,828	705,276
Shpenzime udhëtimit						107,005	135,462	245,260	380,312	271,746	156,437	429,744	608,778	0	4,058
Shpenzime mobilimi	150,000						0								
Shpenzim i kreditë															96,461
Shpenzime shkollimi								146,000	140,600	140,600	136,250	136,250	156,500	167,000	167,000
Rezultati financiar (D-C-E)	1,163,448	428,171	216,855	261,818	-907,411	-690,609	-69,041	-169,135	-1,333,709	-432,910	-1,433,604	-1,220,306	1,576,145	894,982	-3,128,203

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8.3 Ndër të tjera, subjekti ka pretenduar se Komisioni në analizën financiare ka përllogaritur tabelën të cilën e quan ligjshmëria e gjendjes *cash*. Gjendjen *cash* të krijuar me të ardhura të ligjshme e përllogarit në analizën e krijimit të pasurisë për vitin 2016, por pavarësisht kësaj metodologjie, në rezultatet e hetimit ngarkon edhe diferencat negative për krijimin e gjithë gjendjes *cash* në vitet 2007 – 2013, duke e dubluar gjendjen negative në mënyrë jo objektive. Në jurisprudencën e trupave gjyquese të rivlerësimit, subjektet nuk janë penalizuar duke e përllogaritur këtë gjendje dy herë. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me analizën financiare janë trajtuar gjerësisht në pikën 2 të prapësimeve (apartamenti me sip. 126 m², rruga *****, pallati *****)).

Vlerësimi i Komisionit

Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ai nuk duhet të ngarkohet dy herë për mungesën e burimeve të kursimeve cash në analizën financiare bazuar në jurisprudencën e Kolegjit (ai ka cituar dy vendime të Kolegjit E. Ll. dhe G. H.)

- Në lidhje me këtë pretendim, siç është përcaktuar edhe në metodologjinë e analizës financiare të kryer nga Komisioni, kursimet *cash* në banesë janë pasqyruar në analizën financiare, duke marrë parasysh: deklaratën vjetore të subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI; shpjegimet me shkrim të subjektit, të depozituara në ILDKPKI ndër vite; dokumentacionin justifikues ligjor të burimeve të krijimit; dhe mundësinë financiare për krijimin e kursimeve *cash* deri në momentin e përdorimit të tyre për krijimin e pasurive. Në analizën financiare të vitit 2016, Komisioni ka përfshirë në ndryshimet e likuiditeteve vetëm kursimet *cash*, që rezultuan të ishin krijuar me burime të ligjshme. Komisioni gjykon se kjo metodologji pasqyron me saktësi pozicionin financiar të subjektit të rivlerësimit, pasi një vlerësim i kundërt do të çonte në një situatë

paradoksale, pra njohjen e një burimi për të cilin nuk është provuar ligjshmëria. Vlerësimi i Komisionit është në përputhje me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit për çështjen në fjalë.

- Konkretisht, Komisioni gjykon se analiza financiare e viteve 2003 – 2015 duhet të vlerësojë mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar me të ardhura të ligjshme kursimet *cash* të deklaruara ndër vite, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka rezultuar në mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën -4,649,314.05 lekë. Duke ndjekur praktikën e Kolegjit (si në vendimin (JR) nr. 26, datë 6.7.2022, pikat 19.8, 24 dhe 25) vetëm kursimet e mundshme *cash* duhet të llogariten si burime të ligjshme për financimin e apartamentit në vitin 2016, pra 4,261,295 lekë. Ky vlerësim sjell rezultat negativ në analizën të vitit 2016, pra -2,428,203 lekë.

- Prandaj Komisioni gjykon se analiza financiare duhet të reflektojë mungesën e burimeve për krijimin e kursimeve *cash*, megjithatë pranon se është kjo e fundit që sjell si pasojë mungesën e burimeve për krijimin e apartamentit në vitin 2016. Ngarkimi dy herë i pretenduar është vetëm në dukje, pasi mungesa e përgjithshme e burimeve financiare për periudhën 2003 – 2016, marrë në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin e tij, është në vlerën -7,077,517 lekë.

- Si përfundim, Komisioni konstaton se ka mungesë të burimeve të ligjshme në lidhje me krijimin e kursimeve *cash*, të cilat janë deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2016, burime të cilat nuk përmbushin parashikimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3.

Për sa më lart, nisur nga analiza financiare e rishikuar për vitet 2003 – 2016, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën -7,077,517 lekë për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasuritë.

Periudha	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	620,841	0	400,000	432,995	617,046	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-911,315	-1,129,523	5,539,624
Apartament me sip. 75.2 m2 dhe 40 m2 shtesw në Rr. "****",Tiranë	620,841				0										9,500,000
Apartament me sip. 126 Rr. "****", Tiranë															
Autoveturë tip Mercedes Benz, viti prodhimit 2002, me targa ***													559,440		
Autoveturë tip Alfa Romeo, viti prodhimit 1995, me targa ***			400,000												
DIFERENCA LIKUIDITETI (LIK. AKTUAL - LIKUIDITETI)	0	0	0	432,995	617,046	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-1,470,755	-1,129,523	-3,960,376
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2,454,043
Kredi në ABI në dt. 13.10.2016 në shumën 2,500,000															2,454,043
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	620,841	0	400,000	432,995	617,046	771,055	658,180	776,092	1,887,468	1,123,258	2,176,683	1,757,527	-911,315	-1,129,523	3,085,581
TE ARDHURA dokumentuar	4,903,132	942,224	1,086,175	1,242,597	1,293,162	1,367,291	1,407,700	1,681,317	1,756,811	1,784,833	2,431,055	1,667,311	2,310,100	1,355,287	1,630,173
Të ardhura nga paga ime si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë	2,668,730	605,088	760,361	773,592	800,891	831,863	821,670	992,386	1,007,523	1,002,664	1,014,400	1,033,631	1,238,092	1,240,764	1,411,949
Të ardhura nga paga e bashkëshortes si mjekje	373,260	144,886	179,812	304,523	314,957	350,975	389,311	476,570	480,382	549,380	212,604	633,680	672,008	0	0
Të ardhura nga puna e bashkëshortes në klinika private															
Të ardhura nga trashëgimia e nënës në vitin 2012											700,000				
Të ardhura nga kontrata e qerasë nr. ***, datë 16.9.2016															102,000
Pension familjar për djalim														114,523	116,224
Të ardhura nga pensioni i nënës	747,483	131,873	146,002	164,482	177,314	184,453	196,719	212,360	226,512	232,789	226,330				
Të ardhura nga pensioni i babait	1,113,660	60,377													
Të ardhura nga interesat bankare											60,234				
Të ardhura nga DRSSH (sipas bankave)								42,394			217,488				
Të ardhura nga shija e mjetit													400,000		
SHPENZIME	3,911,276	453,676	469,320	547,785	547,785	1,286,845	818,562	1,074,360	1,204,012	1,095,446	986,055	1,130,090	1,645,270	839,828	972,795
Shpenzime jetike	3,761,276	453,676	469,320	547,785	547,785	1,179,840	683,100	683,100	683,100	683,100	693,368	564,096	879,992	672,828	705,276
Shpenzime udhëtimit						107,005	135,462	245,260	380,312	271,746	156,437	429,744	608,778	0	4,058
Shpenzime mobilimi	150,000						0								
Shpenzim i kreditë															96,461
Shpenzime shkollimi								146,000	140,600	140,600	136,250	136,250	156,500	167,000	167,000
Analiza dokumentuar (D-C-E)	371,015	488,548	216,855	261,818	128,331	-690,609	-69,041	-169,135	-1,334,669	-433,870	-731,683	-1,220,306	1,576,145	1,644,982	-2,428,203

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar⁴⁹ pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Arben Kostandini, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 18.11.2022. Sipas këtij raporti, Grupi i Punës së DSIK-së në përfundim të verifikimit ka konkluduar se:

a) *Subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë në deklaratën për kontrollin e figurës.*

b) *Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. Edhe pas përditësimit të informacionit nga organet ligjzbatuese nuk kanë rezultuar të dhëna për subjektin e rivlerësimit.

Nga hetimi i kryer, Komisioni nuk ngriti dyshime për sa i përket përshtatshmërisë së subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës në lidhje me kriterin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Grupi i Punës në KLGJ, në bazë të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016, ka hartuar raportin⁵⁰ mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Arben Kostandini, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Ky raport për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ. Duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: aftësitë profesionale;⁵¹ (a) aftësitë organizative⁵²; (b) etika dhe angazhimi ndaj vlerave

⁴⁹ Me shkresat nr. ***, datë 30.11.2022 dhe nr. ***, datë 31.10.2017, të DSIK-së.

⁵⁰ Raporti nr. *** prot., datë 18.12.2020 i KLGJ-së.

⁵¹ Aftësitë profesionale ku përfshihen: *Njohuritë ligjore dhe Arsyetimi ligjor*. Në lidhje me *njohuritë ligjore*, subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 8 dokumentet ligjore, subjekti identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet e zbatimit të saj dhe vetëm në një rast vendimi i tij është cenuar nga gjykatat më të larta, por që nuk lidhet me mënyrën e zgjidhjes së çështjes në themel, por për arsye procedurale (dosja 2). Në lidhje me *arsyetimin ligjor*, subjekti i rivlerësimit ka aftësi të mira. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij përgjithësisht janë të qarta, të kuptueshme dhe përmbajnë një arsyetim të thjeshtë. Megjithatë, në një vendim të përzgjedhur prej tij (dokumenti nr. 3) konstatohet një mangësi serioze në arsyetimin e vendimit, pasi në një pjesë të arsyetimit subjekti i referohet jo çështjes objekt gjykimi, por një çështjeje me palë të tjera, duke cenuar arsyetimin e vendimit. Duket se gjyqtari ka punuar *copy-paste*.

⁵² Aftësitë organizative, ku përfshihen: (a) *aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*; (b) *aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*; (c) *aftësia për të administruar dosjet*. Në lidhje me *aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë* – gjatë periudhës së rivlerësimit datë 8.10.2013 – datë 8.10.2016 subjekti i janë caktuar për gjykim gjithsej 2181 çështje, ku ka përfunduar 1986 prej tyre, duke mbartur vitin e fundit 123 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 91%. Si rezultat, subjekti i rivlerësimit ka respektuar dhe tejkaluar standardin sasior. Në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar respektimi i afatit ligjor ose afati standard i gjykimit. Në lidhje me *aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore*, subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara. Gjyqtari nuk disponon me vendim apo urdhër formal për vënien në lëvizje të çështjes (caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore), fakt që vlerësohet si mangësi në punën e tij. Në katër çështje civile themeli, gjyqtari ka kryer dhe dokumentuar rregullisht veprimet përgatitore. Në dosjen nr. 5 u konstatua si mangësi fakti që në përmbajtje të dosjes nuk ka as vendim për caktimin e seancës gjyqësore dhe nuk gjenden as akte për njoftimin e palëve ndërgjyqëse.

profesionale⁵³; dhe (c) aftësitë personale dhe angazhimi profesional, për të cilat Grupi i Punës ka konkluduar me një vlerësim pozitiv për subjektin e rivlerësimit⁵⁴.

Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket që subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e veprimeve përgatitore nuk ka shënuar as orën e fillimit dhe as orën e mbarimit të seancës, si dhe e përdor shumë rrallë regjistrimin audio të seancës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

3. Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se është korrekt me orarin e fillimit të seancës, që është pasqyruar në kapakun e dosjes dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje nga palët në proces. Në lidhje me përdorimin e rrallë të regjistrimit audio të seancës, subjekti sqaron se numri i sallave në gjykatë ka qenë i vogël në raport me numrin e gjyqtarëve. Për periudhën 2013 – 2018 nga kryesia e gjykatës i është lënë për përdorim salla audio 2 ditë/javë nga 4 orë. Për këto arsye, subjekti ka zgjedhur që me sistemin audio të zhvillojë seancat gjyqësore me shumë palë ndërgjyqëse dhe jo seancat përgatitore.

Vlerësimi i Komisionit

4. Në lidhje me shënimin e orës së fillimit dhe mbarimit të seancës, Komisioni sjell në vëmendje nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile, që përcakton të dhënat që duhen shënuar në procesverbalin e seancës, midis të cilave edhe ora e fillimit dhe e mbarimit të seancës. Pra, kjo dispozitë nuk përcakton që ora të pasqyrohet vetëm në kapakun e dosjes, siç pretendon subjekti. Sidoqoftë, faktin që subjekti e bën transparente në një lloj mënyre orën e fillimit të seancës, Komisioni do ta mbajë parasysh në vlerësimin tërësor të rrethanave në lidhje me këtë kriter vlerësimi. Në lidhje me regjistrimin audio të seancave, Komisioni e merr në konsideratë prapësimin e subjektit.

5. Raporti i Grupit të Punës së KLGJ-së gjithashtu është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e informacioneve, si më poshtë:

⁵³ *Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale*, që përfshin etikën në punë; integritetin; dhe paanësinë. Në lidhje me etikën në punë, nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, konstatohet se në periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, në ish-Inspektoratin e KLD-së nuk janë depozituar ankesa për shkelje etike për subjektin. Nga ministri i Drejtësisë nuk është depozituar asnjë kërkesë për procedimin disiplinor të subjektit. Gjithashtu, nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën në punë të subjektit. Në lidhje me integritetin, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në lidhje me paanësinë, nga 3+5 dokumentet ligjore nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, gjithashtu nuk u konstatua asnjë kërkesë për përjashtimin e tij. Nga ana tjetër, asnjë prej 3+5 dokumenteve ligjore të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të mos ketë respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

⁵⁴ *Aftësitë personale dhe angazhimi profesional*, ku përfshihen aftësitë e komunikimit; aftësia për të bashkëpunuar; dhe gatishmëria për t'u angazhuar. Në lidhje me aftësinë e komunikimit nuk janë konstatuar probleme të etikës nga subjekti me palët ndërgjyqëse. Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Në lidhje me aftësinë për të bashkëpunuar nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë evidentuar raste të shpeshta që të ketë pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore apo vonesa në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur. Në lidhje me gatishmërinë për t'u angazhuar, subjekti i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke marrë pjesë dhe certifikuar në 6 seminare të organizuara nga kjo shkollë, për një periudhë trevjeçare. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit Arben Kostandini ka shfaqur pak interes për të frekuentuar trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

C/1. FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

6. Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i nënshkruar pa mangësi nga subjekti, i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm bashkëlidhur.

Tri dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti nr. 1 – vendim gjyqësor civil nr. ***, datë 28.4.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Çështja me palë paditës “****”, i paditur personi fizik “T. T.”, person i tretë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me objekt “ndalimi i 240 epilatorëve të markës ‘****’ të hyjnë në tregun e brendshëm dhe shkatërrimin e tyre etj.”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 30.4.2015.

Dokumenti nr. 2 – vendim gjyqësor civil nr. ***, datë 9.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket çështjes civile me paditës R. Xh., i paditur V. Z., A. Z. etj., me objekt “njohje bashkëpronësie për 5/12 e pasurisë së përbashkët bashkëshortore të luajtshme e të paluajtshme për pjesën 5/12 të pasurisë me nr. *** dhe pasurisë nr. *** etj.”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë.

Dokumenti nr. 3 – çështja civile me paditës shoqëria “****” sh.p.k., të paditur ***, me objekt “shpërblim dëmi në vlerën 1,000,000 lekë për shkak të veprimeve të paligjshme me faj nga palët e paditura...”. Vendimi është i strukturuar në tri pjesë, por në një fragment të pjesës arsyetuese arsyetimi i subjektit të rivlerësimit paraqet një mangësi serioze. Duke analizuar elementet e dëmit jopasuror sipas përcaktimit të nenit 608 të Kodit Civil, rezulton se subjekti nuk i referohet zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe palëve në proces, por një procesi gjyqësor me palë të tjera. Duket qartë se në këtë pjesë subjekti abstragon nga padia objekt shqyrtimi dhe i referohet një procesi me palë të tjera. Subjekti ka punuar *copy-paste*, duke cenuar arsyetimin e vendimit.

Në lidhje me mangësinë e vërejtur në dokumentin nr. 3, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

7. Në prapësime, subjekti e pranon konkluzionin e Grupit të Punës, por sqaron se për çështje me problematika të njëjta ai përdor të njëjtin standard arsyetimi e, për pasojë, në këtë rast ka harruar të përshtasë emrat e subjekteve përkatëse në një fragment të arsyetimit, por gjithsesi në themel të arsyetimit nuk ndryshon. Për këtë rast, asnjë nga palët ndërgjyqëse nuk ka paraqitur kërkesë për korrigjimin e vendimit.

Vlerësimi i Komisionit

8. Komisioni, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e subjektit, vëren se gjatë arsyetimit të vendimit subjekti ka vijuar fjalinë duke përmendur emra të palëve të tjera ndërgjyqëse dhe rrethana të tjera. Në fakt, rrethanat kanë të bëjnë me dëmin pasuror për shkak të dëmtimit të reputacionit, pra rrethanat janë të së njëjtës natyrë me rrethanat objekt gjykimi, prandaj duket se veprimet e subjektit janë lapsus i paqëllimshëm dhe duke e parë këtë fragment me tërësinë e arsyetimit dhe dispozitivit të vendimit, nuk paraqet dëm serioz për palët dhe cilësinë e vendimit. Vendimi duket se ka qenë i qartë edhe për palët, përderisa ato nuk kanë kërkuar korrigjimin e tij. Për këto arsye, Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë prapësimin e subjektit.

Për sa më lart, duket se në tri dokumentet e paraqitura nga subjekti nuk janë konstatuar mangësi thelbësore deri në atë nivel që të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

C/2. PESË DOSJET E PËRZGJEDHURA SIPAS NJË SISTEMI RASTËSOR DHE OBJEKTIV

Dosja nr. 1 – çështja civile nr. ***, datë 2.3.2016 regjistrimi, që u përket palëve paditëse N. V., të paditur Drejtoria e Arkivit të ISSH-së Tiranë, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me objekt “njohje e pavërtetësisë së dokumentit fletë regjistri themeltar nr. ***, f. *** e kooperativës bujqësore *** lidhur me emrin dhe aftësinë për periudhën e viteve të punës 1976 – 1990”.

Seancat gjyqësore janë mbajtur në zyrën e gjyqtarit, por nuk është evidentuar në procesverbal shkaku se përse nuk është mbajtur seanca me audio. Çështja është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 23.5.2016, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 6.3.2018. Çështja është gjykuar brenda afatit 6-mujor të përcaktuar në pikën 5/e të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Është respektuar afati 10-ditor i dorëzimit të dosjes në sekretarinë gjyqësore. Vendimi është ndërtuar me tri pjesët e tij (hyrëse, përshkruese - arsyetuese dhe dispozitivi) dhe me elementet përbërëse të çdo pjese (ky shënim vlen për të 5 dosjet e shortcutara). Vendimi përmban një arsyetim të thjeshtë, por që plotëson standardet minimale të një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja nr. 2 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 17.7.2013 me paditës A. M., i paditur Komisioni i Prokurimit Publik, me objekt “Shpërblim dëmi i shkaktuar nga zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e kontratës së punës në masën 12 paga mujore. Pagimi i dëmshpërblimit prej 2 muajsh pagë për mosrespektim të procedurës së largimit nga puna. Shpërblimi për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës 2 muajsh. Pagimin e shpërblimit për vjetërsi në punë sa paga e një muaji e gjysmë”.

Në procesverbalet e seancave nuk pasqyrohet shkaku i moszhvillimit të seancës audio, si dhe ora e fillimit të seancës. Dosja gjyqësore është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore, në shkelje të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Çështja është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.11.2013, i cili është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ta prishë vendimin dhe ta kthejë çështjen për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Rezulton se fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pasur kompetencë lëndore që të gjykonte padinë, por në bazë të Dekretit të Presidentit nr. ***, datë 14.10.2013, është përcaktuar që në datën 4.11.2013 kompetenca lëndore i takonte Gjykatës Administrative dhe subjekti duhej të kishte hequr dorë nga gjykimi i padisë.

Dosja nr. 3 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 11.4.2014, me paditës Sh. M., i paditur Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë, me objekt “pavlefshmëri e titullit ekzekutiv fatura nr. ***”.

Në procesverbalet e seancave nuk pasqyrohet shkaku i moszhvillimit të seancës audio, si dhe ora e fillimit të seancës.

Çështja ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 25.6.2014, të subjektit dhe ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 18.6.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjykata e Lartë nuk është shprehur ende për këtë çështje.

Gjykimi ka përfunduar brenda afatit të parashikuar nga pika 5/e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Dosja gjyqësore është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të gjykatës brenda afatit 1-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile. Dosja është inventarizuar në mënyrë të rregullt.

Dosja nr. 4 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 27.11.2015, që u përket palës paditëse S. V., të paditur ISSH dhe DRSSH Tiranë, me objekt “njohja e pavërtetësisë së regjistrimit nr. ***, f. ***, sipas aktverifikimit datë 19.6.2014, të DRA Kukës, njohja e vjetërsisë në punë për vitin 1994 në bazë të librezës së punës, njohja e pavërtetësisë së vërtetimit të lëshuar nga DART Tiranë për pagat e periudhës tetor 1997, dhjetor 1997 – qershor 1998, nëntor 1998 – maj 2014”.

Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 25.5.2016. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 21.2.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka disponuar ende për këtë çështje.

Çështja është zhvilluar duke respektuar afatin sipas pikës 5/e të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit 10-ditor sipas nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Dosja nr. 5 – kërkesa penale nr. *** regjistri themeltar, datë 7.6.2015, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vlerësimi i ligjshëm i ndalimit dhe caktimi i masës së sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj personit nën hetim S. M.”.

Në dosje nuk ka akt të shkruar të gjyqtarit (vendim, urdhër) për caktimin e datës dhe orës së seancës gjyqësore. Në dosje nuk sqarohet se në ç’mënyrë u njoftua organi i prokurorisë dhe i ndaluarit për të marrë pjesë në seancë gjyqësore. Seanca e parë gjyqësore e datës 8.6.2015 është dokumentuar me procesverbal me shkrim. Në procesverbal nuk është shënuar as ora e fillimit dhe as ora e mbarimit të seancës gjyqësore. Seanca gjyqësore nuk është zhvilluar me regjistrim audio në funksion të transparencës së gjykimit.

Çështja është përfunduar me vendimin nr. ___, datë 8.6.2015, që është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 29.6.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor i dhënë janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës brenda afatit 5-ditor, sipas nenit 113 të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti ka respektuar afatin 48-orësh të përcaktuar nga neni 259, pika 5 e Kodit të Procedurës Penale, rrjedhimisht ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar, të përcaktuar nga neni 28, pika 2 e Kushtetutës dhe neni 5, pika 3 e KEDNJ-së.

Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket që në 5 dosjet e përzgjedhura për vlerësim, subjekti i rivlerësimit:

a) Në katër raste (dosjet nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 5), në procesverbalet e seancave nuk ka pasqyruar shkakun e moszhvillimit të seancës audio, madje në procesverbalin e seancës përgatitore të mbajtur nga vetë subjekti nuk ka përshkruar orën e fillimit të seancës.

b) Në një rast (dosja nr. 2), dosjen gjyqësore e ka dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 11.12.2013, pra 14 ditë nga shpallja e vendimit, duke shkelur afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

c) Në një rast (dosja nr. 2) nuk ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, pasi në bazë të Dekretit të Presidentit nr. ***, datë 14.10.2013, është përcaktuar që në datën 4.11.2013 kompetenca

lëndore i takonte Gjykatës Administrative, pavarësisht se fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pasur kompetencë lëndore që të gjykonte padinë.

d) Në një rast (dosja nr. 5) në dosje nuk ka mbajtur akt të shkruar (vendim, urdhër) për caktimin e datës dhe orës së seancës gjyqësore. Në dosje nuk sqarohet se në ç'mënyrë u njoftua organi i prokurorisë dhe i ndaluar për të marrë pjesë në seancë gjyqësore.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

9. Në prapësime, në lidhje me pikën e parë të konkluzionit, subjekti u përmbahet shpjegimeve që ka dhënë më lart në kreun C, pika 3.

10. Në lidhje me dosjen nr. 5, subjekti sqaron se kjo dosje i përket vlerësimit dhe caktimit të masave të sigurimit personal dhe njoftimi bëhej me shkresë përcjellëse për gjithë të ndaluarit e asaj dite që ishte seanca. Ndërsa prokurorët njoftoheshin me telefon për shkak të afatit të shkurtër të gjykimit të masave të sigurimit personal dhe kjo mënyrë përdorej si standard komunikimi nga të gjithë gjyqtarët e gatshëm. Për sa kohë që seanca e ka arritur qëllimin e saj duke u zhvilluar, atëherë nuk ka asnjë parregullsi njoftimi. Për sa i përket datës dhe orarit të fillimit të seancës, janë procesverbalet e seancave të cilat i reflektojnë ato.

Vlerësimi i Komisionit

11. Komisioni, pasi mori në shqyrtim prapësimet e subjektit, vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime për konstatimet b) dhe c) si më lart. Në lidhje me konstatimin d), shpjegimet e subjektit janë deklarative dhe nuk provohen së paku me një vërtetim nga kancelari i gjykatës për mënyrën e njoftimit. Ndërsa për pretendimin se data dhe ora e fillimit të seancës janë reflektuar në procesverbalet e seancave, ky pretendim nuk qëndron, pasi i vetmi procesverbal është ai i datës 8.6.2015 për caktimin e masës së sigurimit personal dhe nuk e përmban orën e fillimit të seancës.

12. Prapësimet e subjektit për konkluzionin a), Komisioni do t'i vlerësojë në tërësinë e rrethanave; dy konkluzionet b) dhe c) mbeten të pandryshuara; prapësimet për konkluzionin d) nuk janë shumë bindëse për Komisionin, por për sa kohë që seanca është zhvilluar dhe nuk ka sjellë pasoja të dëmshme për procesin, Komisioni nuk e vlerëson si një mangësi thelbësore për të ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- Në një rast (dosja nr. 2) dosjen gjyqësore e ka dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 11.12.2013, pra 14 ditë nga shpallja e vendimit, duke shkelur afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.
- Në një rast (dosja nr. 2) nuk ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, pasi në bazë të Dekretit të Presidentit nr. ***, datë 14.10.2013, është përcaktuar që në datën 4.11.2013 kompetenca lëndore i takonte Gjykatës Administrative, pavarësisht se fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pasur kompetencë lëndore që të gjykonte padinë.
- Veprimet e subjektit të rivlerësimit, duke mos evidentuar se në ç'mënyrë u njoftua organi i prokurorisë dhe i ndaluar për të marrë pjesë në seancë gjyqësore, nuk përbëjnë mangësi thelbësore për sa kohë seanca është zhvilluar rregullisht.

C/3. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-së

13. Subjekti është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 30.3.1995.

14. Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës së rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, në Inspektoratin e ish-KLD-së janë paraqitur për subjektin gjithsej 7

ankesa (6 në vitin 2014, 1 në vitin 2015). Dy ankesa të vitit 2014 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar. Pesë ankesa (4 në vitin 2014, 1 në vitin 2015) janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijon:

- 2 ankesa të vitit 2014, verifikuar për zvarritje, për njëren është vendosur evidentim për efekt vlerësimi etik e profesional të gjyqtarit dhe për tjetrën është vendosur tërheqja e vëmendjes me shkrim për gjyqtarin.

- 2 ankesa të vitit 2014, verifikuar për mosrespektim formal ligji, për njëren është vendosur evidentim për efekt vlerësimi etik e profesional, ndërsa për tjetrën është vendosur mbajtja e verifikimit në vijim deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Më pas, me krijimin e ILD-së, kjo praktikë i është dërguar për kompetencë këtij institucioni, me procesverbalin nr. *** prot., datë 28.7.2015.

- 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për zvarritje dhe mosrespektim formal ligji, është arkivuar, pasi nuk rezultuan shkelje nga ana e gjyqtarit.

15. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit për subjektin nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

16. Nga verifikimi i përgjigjeve të prokurorive të rretheve gjyqësore⁵⁵ ka rezultuar se nuk ka: të dhëna për procedim disiplinor; të dhëna nga agjencitë ligjzbatuese për veprime që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit; të dhëna për kontakte të subjektit me persona të papërshtatshëm; kopje të fashikujve të procedimeve penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara, ku përmendet subjekti i rivlerësimit; ankesa.

17. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë konfirmon⁵⁶ se për periudhën kohore 2011 – 2021 rezulton që ndaj subjektit të jetë regjistruar kallëzimi penal nr. ***, viti 2015, për veprën penale “shpërdorim detyre”, i cili është mosfilluar në datën 21.9.2015, si dhe ka dërguar bashkëlidhur fashikullin e mosfillimit të këtij kallëzimi, nga analiza e të cilit nuk u konstatuan mangësi të subjektit në lidhje me kriterin profesional.

18. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës konfirmon⁵⁷ se për periudhën kohore 1.1.2006 deri në datën e shkresës, rezulton që ndaj subjektit të jenë regjistruar: (a) materiali hetimor nr. ***, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal datë 2.10.2019; (b) materiali hetimor nr. ***, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën... (nuk ka datë); (c) materiali hetimor nr. ***, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal në datën 21.4.2020; (ç) procedimi penal nr. ***, datë 2.3.2020, i cili është nën hetim. Bashkëlidhur janë dërguar kopje të fashikujve si më lart (me përjashtim të fashikullit të procedimit penal nr. ***, datë 2.3.2020, që u kërkua nga Komisioni pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës).

19. Në lidhje me materialin hetimor nr. * dhe nr. ***, nga analiza e kryer_nuk konstatohen mangësi të subjektit të rivlerësimit në lidhje me kriterin profesional.**

⁵⁵ Shkresat kthim përgjigjeje të prokurorive të rretheve gjyqësore: Pogradec, me nr. *** prot., datë 24.2.2021; Sarandë, me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Shkodër, me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Lushnjë, me nr. *** prot., datë 23.2.2021; Mat, me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Elbasan, me nr. *** prot., datë 22.2.2021; Fier, me nr. *** prot., datë 25.2.2021; Krujë, me nr. *** prot., datë 5.3.2021; Gjirokastrë, me nr. *** prot., datë 16.2.2021; Korçë, me nr. *** prot., datë 26.2.2021; Pukë, me nr. *** prot., datë 16.2.2021; Dibër, me nr. *** prot., datë 24.2.2020; Tropojë, me nr. *** prot., datë 17.2.2021; Kavajë, me nr. *** prot., datë 10.3.2021; Kurbin, me nr. *** prot., datë 18.2.2021; Përmet, me nr. *** prot., datë 15.2.2021; Kukës, me nr. *** prot., datë 16.2.2018; Berat, me nr. *** prot., datë 15.2.2021; Lezhë, me nr. *** prot., datë 19.2.2021; dhe Vlorë, me nr. *** prot., datë 16.2.2021.

⁵⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021.

⁵⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2021.

20. Në lidhje me materialin hetimor nr. *,** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar kallëzimin nr. ***, datë 7.4.2020, të shtetasit S. Q., për veprat penale “shpërdorim detyrë”, “korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të drejtësisë”, “korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të drejtësisë”, dërguar për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Kallëzuesi akuzon disa shtetas, midis të cilëve edhe subjektin, për të cilin pretendon se është treguar i njëanshëm dhe ekspertja gjatë gjykimit ka favorizuar palën tjetër, duke dalë në rezultate të pavërteta e favorizuese.

21. Rezulton se kallëzuesi, që pretendonte bashkëpronësinë mbi një sipërfaqe trualli dhe pronësinë mbi një pikë karburanti si investim individual i ngritur në këtë truall, ka qenë në cilësinë e të paditurit në kërkesëpadinë e ngritur nga dy bashkëpronarët e tjerë, të cilët kërkonin pjesëtimin e kësaj pasurie.

22. Çështja e regjistruar⁵⁸ me nr. ***, datë 20.2.2018, për fazën e dytë të pjesëtimit është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili me vendimin e ndërmjetëm nr. ***, datë 11.7.2018, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes deri në përfundimin e shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese të vlefshmërisë së fazës së parë të gjykimit pranë kësaj gjykate. Ky vendim i subjektit të rivlerësimit është rrëzuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 21.11.2018, me arsyetimin se nuk është e nevojshme të pritet gjykimi në Gjykatën Kushtetuese. Me rekurs, çështja është dërguar në Gjykatën e Lartë, e cila rezulton që nuk është shprehur ende.

23. Komisioni vëren se subjekti nuk ka qenë në rastet që përcakton neni 297 i Kodit të Procedurës Civile, ndaj nuk ka vepruar drejt, duke vendosur pezullimin e gjykimit të fazës së dytë të pjesëtimit, e cila ishte një fazë vijuese e fazës së parë të pjesëtimit, ndërkohë që vendimi nr. ***, datë 19.2.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë në lidhje me fazën e parë të pjesëtimit ishte i formës së prerë, pasi ishte lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë dhe as Gjykata Kushtetuese që kishte regjistruar çështjen për gjykim nuk kishte vendosur pezullimin sipas nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Neni 371 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se: *“...në rastin kur vendimi i ndërmjetëm, që ka lejuar pjesëtimin, ka marrë formën e prerë, gjykata vazhdon gjykimin në fazën e dytë, duke marrë në shqyrtim kërkesat që mund të kenë bashkëpronarët...”*.

24. Në lidhje me kërkesën e të paditurit për përjashtimin e ekspertës, Komisioni vëren se subjekti nuk ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për kërkesat procedurale e të paditurit (kallëzuesit) gjatë gjykimit të fazës së dytë të pjesëtimit, kur i padituri nuk ka qenë dakord me aktekspertimin për vlerësimin e pronës dhe ka kërkuar të përsëritet akti me ekspert tjetër e, më pas, ka kërkuar në dy seanca rresht përjashtimin e ekspertës. Për këto arsye, i padituri ka kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i çështjes dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar këtë kërkesë⁵⁹.

25. Neni 125 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se: *“Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t’u përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi”*. Gjithashtu, neni 224/c, paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Civile, përcakton se: *“Kërkesa për përjashtimin e ekspertit duhet t’i dorëzohet gjykatës që shqyrton çështjen, e cila vendos për të”*.

⁵⁸ Me paditës A. B. e G. S., i paditur S. Q., me objekt “pjesëtim pasurie, faza e dytë”.

⁵⁹ Me vendimin nr. ***, datë 22.11.2019.

26. Në përfundim të hetimit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin datë 21.4.2020, në bazë të nenit 290, pika 1/ç dhe neni 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket që në lidhje me veprimet procedurale subjekti i rivlerësimit ka shkelur nenet 125, 224/c paragrafi 4, 297, 371 të Kodit të Procedurës Civile, duke pezulluar pa shkak ligjor gjykimin dhe duke mos disponuar me vendim të ndërmjetëm në lidhje me kërkesën e parë të palës së paditur për përjashtim të ekspertit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

27. Në prapësime, subjekti shpjegoi se ka çmuar që çështja të pezullohej derisa të dilte vendimi i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me vendimin e fazës së parë të pjesëtimit. Ndërsa në lidhje me përjashtimin e ekspertës nuk e ka çmuar që të vendosë përjashtimin e saj, por ka urdhëruar që ajo të verifikojë sërish aktin e ekspertimit në lidhje me pretendimet e palës së paditur, duke e ndryshuar dhe plotësuar atë. Në këtë moment, palët kanë kërkuar përjashtimin e subjektit dhe është ndjekur rruga procedurale.

Vlerësimi i Komisionit

28. Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në prapësime nuk janë bindëse, prandaj vlerëson të mos i marrë në konsideratë ato.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se në lidhje me veprimet procedurale subjekti i rivlerësimit ka shkelur nenet 125, 224/c paragrafi 4, 297, 371 të Kodit të Procedurës Civile, duke pezulluar pa shkak ligjor gjykimin dhe duke mos disponuar me vendim të ndërmjetëm në lidhje me kërkesën e parë të palës së paditur për përjashtimin e ekspertit.

29. Në lidhje me procedimin penal nr. ***, datë 2.3.2020, Komisioni ka administruar⁶⁰ fashikullin e këtij procedimi dhe, pas shqyrtimit të tij, rezulton se në datën 2.3.2020 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar për kompetencë⁶¹ procedimin penal nr. ***, për veprën penale “shpërdorim detyre”, në bazë të kallëzimit penal të shtetasve A. Ll. dhe M. Ll.

30. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, me kërkesën datë 9.11.2021, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës pushimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “shpërdorim detyre” (248 i Kodit Penal), me argumentin se në rastin konkret nuk ekziston të ketë pasur asnjë të dhënë apo fakt që trupi gjykues i shkallës së parë (ku bën pjesë edhe subjekti) dhe trupa e Gjykatës së Apelit Tiranë të kenë pasur ndonjë interes vetjak në gjykimin e kësaj çështjeje apo për më tepër që vendimi të jetë dhënë me keqbesim (trajtuar në denoncimet nr. *** dhe nr. *** në vijim).

31. Kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për pushimin e procedimit penal është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. ***, datë 6.12.2021.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shkresë nr. *** prot., datë 18.1.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁶¹ Sipas vendimit datë 16.1.2020 “Për shpallje të moskompetencës tokësore” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

DENONCIME

32. Denoncim nr. *, datë 25.5.2018, i shtetasit S. K.**, i cili pretendon se subjekti me një vendim të padrejtë i ka dhënë kundërshtarit të tij 250 m² tokë nga prona e tij, të cilën e ka me dokumente të rregullta, si dhe ka zhvilluar proces të parregullt ligjor e gjykim të njëanshëm. Gjyqtari Arben Kostandini ka zhdukur nga dosja gjyqësore qëllimisht dokumente, të cilat vërtetojnë se pala kundërshtarë nuk ka qenë fare aty dhe nuk ia ka vënë në dispozicion ekspertit këto dokumente. Bashkëlidhur denoncimit janë vendimi gjyqësor nr. ***, datë 3.4.2018, i subjektit të rivlerësimit dhe disa dokumente të tjera që kanë të bëjnë me pronësinë e palëve ndërgjyqëse mbi pronat objekt gjykimi.

Nga përmbajtja e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 3.4.2018, rezulton se subjekti ka gjykuar çështjen me paditës i kundërpaditur V. S., të paditur kundërpaditës bashkëpronarët A. (A., A., B., E., E.), T. Sh. dhe S. K., me objekt padie “1) Anulim i pjesshëm i vendimit nr. ***, datë 15.8.2002, të KKKP-së Tiranë, për sip. 250 m² truall, që krijon mbivendosje me sipërfaqen e truallit në pronësi të paditësit, e cila pozicionohet në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. *** dhe detyrimin e të paditurve që të njohin pronar paditësin për këtë sipërfaqe trualli; 2) detyrimin e ZVRPP-së Tiranë të fshijë regjistrimin e kësaj pasurie dhe regjistrimin në favor të paditësit etj.”.

Komisioni, pasi administroi⁶² dhe shqyrtoi dosjen gjyqësore të gjykuar me vendimin nr. ***, datë 3.4.2018, të subjektit të rivlerësimit, vëren se me kërkesën datë 15.9.2016, drejtuar subjektit, denoncuesi ka kërkuar kopje të të gjitha akteve që përmban dosja, me pretendimin se nga subjekti i janë vënë në dispozicion vetëm disa prej tyre. Në parashtresën datë 10.10.2016, që denoncuesi ka paraqitur në seancë gjyqësore, citon se ka marrë nga subjekti kopje të provave që ka depozituar paditësi në dosje dhe përmend pikërisht shkresat që janë në dosjen gjyqësore (të cilën e ka administruar edhe Komisioni), si dhe jep opinionin e tij rreth disa prej këtyre shkresave, por nuk pretendon se janë zhdukur prova nga dosja gjyqësore.

Sipas aktekspertimit teknik datë 24.4.2017, eksperti citon se për këtë akt është bazuar në dokumentacionin e dosjes gjyqësore dhe pyetjeve që i janë drejtuar nga gjyqtari Arben Kostandini, si dhe ka përshkruar dokumentet ligjore e hartografike, të paraqitura nga secila palë ndërgjyqëse në dosje.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes nuk konstatohet zhvillim i procesit të parregullt ligjor në aspektin procedural për sa pretendon denoncuesi, përveçse moszhvillimit të seancave audio dhe pasqyrimin e kohës së zhvillimit të tyre në procesverbal.

33. Denoncimet nr. *, datë 21.8.2019, nr. ***, datë 3.12.2021 dhe nr. ***, datë 19.6.2018, të shtetasi F. N.**, i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë me keqdashje vendim të padrejtë në interpretim të gabuar të ligjit material dhe në kundërshtim me provat dhe faktet e paanalizuara në seancë gjyqësore. Denoncuesi ka bërë kallëzim në prokurori për veprën penale “shpërdorim detyrë”. Kjo çështje është trajtuar në kreun C/3, pika 19. Bashkëlidhur denoncimit, është, midis akteve të tjera, edhe vendimi gjyqësor nr. ***, datë 12.1.2005, që ka disponuar subjekti i rivlerësimit.

Nisur nga data e vendimit gjyqësor, rezulton se çështja për të cilën ngre pretendime denoncuesi, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 41 pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më lart, Komisioni nuk mund të marrë në shqyrtim këtë denoncim.

⁶² Me shkresën nr. *** prot., datë 18.1.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën nr. *** prot., datë 9.1.2023, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

34. Denoncim nr. *, datë 24.7.2018, i shtetasit I. T.,** i cili ankohet se subjekti, me vendimin nr. ***, datë 13.3.2013, ka gjykuar padinë me objekt pushimin e tij nga puna. Nga rrethanat që citon denoncuesi (largohet nga puna kur ishte me raport mjekësor në periudhë leje të zakonshme, kishte rezultate të mira në punë, i duhej edhe 1 vit të dilte në pension etj.), ai pretendon për mënyrën e zgjidhjes së themelit të një konflikti marrëdhënieje punësimi, pavarësisht se si e ka vlerësuar subjekti në vendimmarrjen e tij dhe jo për shkelje procedurale të kryera nga subjekti.

Për sa më lart, në referim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni nuk mund ta marrë në shqyrtim këtë denoncim.

35. Denoncim nr. *, datë 19.9.2019, i shtetasit E. A.,** i cili, pasi përmend emrat e disa subjekteve të vlerësimit, pretendon se me vendimin nr. ***, datë 6.3.2018, gjyqtari Arben Kostandini ka rrëzuar padinë e tij kundrejt pagesës që mendon se ka marrë nga pala tjetër. Denoncuesi citon se “mendon” që subjekti ka marrë para, por nuk ka paraqitur asnjë provë për të provuar këtë. Pra, denoncimi ka të bëjë me vendimmarrje mbi themelin e çështjes dhe paraqet hipoteza për mitmarrje nga subjekti, por nuk paraqet asnjë provë apo *indicie* që provon mitmarrjen e kryer prej tij.

Për sa më lart, në referim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili nuk i jep Komisionit kompetencë të vlerësojë gjykimin e themelit të çështjes nga ana e subjektit, si dhe në kushtet e mungesës së provave për korrupsion, Komisioni nuk mund të marrë në shqyrtim këtë denoncim.

36. Denoncim nr. *, datë 30.4.2018 dhe denoncimi nr. ***, datë 2.10.2019, nga shtetasi A. Ll.** Në këto denoncime pretendohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka gjykuar çështjen nr. ***, datë 6.6.2016, me *paditës* A. Ll.; me *objekt* - Ndryshim i vendimit të KKKP-së, njohje trashëgimtar dhe dorëzimi i pasurisë trashëgimore; *të paditur* – I. Xh., Agjencia e Trajtimit të Pronave; *person i tretë* ZVRPP Tiranë. Me vendimin nr. ***, datë 12.2.2018, trupi gjykues i përbërë nga kryesuesja M. B. dhe anëtarët A. Zh. e Arben Kostandini vendosën rrëzimin e padisë, pasi kishin rrëzuar edhe kërkesën e paditësve për riçelje të hetimit gjyqësor dhe për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Ky vendim gjyqësor nuk është zbardhur deri në datën e denoncimit. Denoncuesi pretendon për proces të parregullt ligjor dhe ngre dyshim për ndikim të paligjshëm të palës së paditur ndaj trupit gjykues; shkelje haptazi të ligjit nga trupi gjykues duke u bazuar në dokumente të falsifikuara të paraqitura nga I. Xh., daja i denoncuesit dhe duke i hequr të drejtën e trashëgimisë nënës së tij nëpërmjet mospërfshirjes në dëshminë e trashëgimisë.

37. Nga përmbajtja e denoncimit dhe provave bashkëlidhur, si dhe nga dosja që Komisioni administroi⁶³ e shqyrtoi në lidhje me këtë çështje, vëren se për disa aspekte të çështjes denoncuesi pretendon për zgjidhjen e saj në themel. Bazuar në nenin 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për këtë pjesë të denoncimit Komisioni nuk ka kompetencë vlerësimi, prandaj nuk mund ta marrë në shqyrtim.

38. Nga ana tjetër, siç është trajtuar edhe në kreun C/3, pikat 29-30 më lart, në lidhje me pretendimin e denoncuesit për proces të parregullt ligjor, nuk rezultuan veprime në kundërshtim me rregullat procedurale. Vendimi nr. *, datë 12.2.2018, i Gjykatës së Rrethit**

⁶³ Shkresa nr. ***, datë 27.12.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shkresa nr. ***, datë 18.1.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjyqësor Tiranë, që ka rrëzuar padinë, është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila e ka lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 16.5.2019. Çështja, pasi u regjistrua për gjykim në Gjykatën e Lartë në datën 23.7.2019, pritet për gjykim.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.

39. Denoncim nr. *, datë 6.5.2022, i shtetasit Dh. B.,** i cili pretendon se gjyqtari Arben Kostandini kundrejt shumës 200,000 lekë, me vendimin nr. ***, datë 3.12.1997⁶⁴, me falsifikim, ka vendosur zgjidhjen e martesës së denoncuesit dhe bashkëshortes pa qenë fare të regjistruar në regjistrat e gjykatës, duke ndërruar numrin e aktit me atë të vendimit, të cilët i përkasin një vendimi tjetër gjyqësor. Me vërtetimin nr. ***, datë 22.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vërtetohet që në këtë gjykatë nuk është regjistruar asnjë padi me objekt zgjidhjeje martese midis denoncuesit dhe bashkëshortes së tij. Gjyqtari ka gjykuar edhe një çështje tjetër, ku denoncuesi është paditës i kundërpaditur ndaj të paditurit kundërpaditës, shoqërisë ndërtuese “Ndregjoni”, me objekt padie “detyrimi i të paditurit që të njohë pronësinë e apartamentit nr. *** në pallatin nr. ***, rruga “***, Tiranë” dhe objekt kundërpadie “zgjidhja e aktmarrëveshjes nr. ***, datë 8.4.2004, të lidhur midis palëve ndërgjyqëse”. Sekretarja e gjyqtarit i ka thënë denoncuesit se për vendimin ka një kosto, por denoncuesi citon se nuk i përgjigjej dot, sepse së pari ai kishte të drejtë në çështjen e tij dhe, së dyti, si pensionist nuk kishte para. Për këtë çështje, denoncuesi pretendon se për hakmarrje gjyqtari ka marrë vendim krejt të gabuar, të njëanshëm dhe korruptiv, duke rrëzuar padinë dhe pushuar kundërpadinë.

Në lidhje me vendimin nr. ***, datë 3.12.1997, për zgjidhjen e martesës së denoncuesit, Komisioni vëren se kjo çështje daton jashtë periudhës së rivlerësimit, përcaktuar në nenin 41, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, prandaj nuk mund ta vlerësojë. Gjithashtu, kopja e këtij vendimi nuk përmban asnjë nënshkrim të subjektit, sekretares së çështjes, kryesekretarit të gjykatës, që të ketë vërtetuar se vendimi ka marrë formë të prerë dhe as shënimin me vulë e nënshkrim nga arkivi i gjykatës, se ky vendim është nxjerrë nga arkivi dhe është i njëjtë me origjinalin. Pra, në kuptim të aktit ligjor, ky vendim nuk përmban elementet as të vendimit gjyqësor dhe as të provës në këtë hetim administrativ.

Në lidhje me çështjen tjetër civile të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 27.1.2021, nga shqyrtimi i akteve bashkëlidhur denoncimit, Komision vëren se denoncuesi trajton vetëm kërkesat e tij dhe qëndrimin e gjykatave në lidhje me zgjidhjen e themelit të çështjes dhe jo me veprime procedurale. Gjithashtu edhe pretendimi i denoncuesit se subjekti ka marrë vendim korruptiv, mbeti në nivelin e hipotezës, pasi nuk solli asnjë provë dhe asnjë *indicie* për veprime korruptive.

Për sa më lart, në referim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili nuk i jep Komisionit kompetencë të vlerësojë gjykimin e themelit të çështjes nga ana e subjektit, si dhe në kushtet e mungesës së provave për korrupsion, Komisioni nuk mund ta marrë në shqyrtim këtë denoncim.

40. Denoncimet nr. * dhe nr. ***, datë 23.5.2022; nr. ***, datë 4.1.2023, të shtetasit E. B.,** i cili, pasi përmend emrin e subjektit të rivlerësimit, pretendon se së bashku me prindërit e tij ka në pronësi me dokumentacion të rregullt një shtëpi që e ka vënë në garanci hipotekore për të garantuar kredinë që ka marrë nga banka për të rikonstruktuar këtë shtëpi. Gjykata nuk mori parasysh asgjë, por nxori jashtë prindërit e denoncuesit që jetojnë në këtë shtëpi. Gjyqtari Arben Kostandini merr vendime të menjëhershme për ekzekutim me përmbares; keqinterpreton dhe nuk vlerëson asnjë provë të dërguar; me vendimin nr. ***, datë 19.5.2022,

⁶⁴ Bashkëlidhur denoncimit.

ka rivendosur në posedim paditësit K. B. dhe M. B., të cilët nuk e kanë fituar asnjëherë të drejtën e posedimit dhe as të pronësisë.

Bashkëlidhur denoncimit, denoncuesi ka depozituar disa dokumente⁶⁵, midis të cilave edhe vendimin nr. ***, datë 19.5.2022, që ka dhënë subjekti i rivlerësimit. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se subjekti ka gjykuar çështjen me paditës K. B., M. B., i paditur E. B., ndërhyrës kryesor Xh. B., me objekt padie “Pushim i cenimit të posedimit nga i padituri dhe mospërsëritjen në të ardhmen. Rivendosjen në posedim të sendit. Dhënien e vendimit gjyqësor me ekzekutim të përkohshëm. Marrjen e masës së sigurimit të padisë”.

Rezulton se paditësi K. B. dhe i padituri E. B. janë vëllezër dhe babai i tyre është ndërhyrës kryesor, Xh. B.. Subjekti ka vendosur pranimin e padisë, rivendosjen e paditësve në posedim mbi sendin dhomë banimi me sip. 18.54 m², duke urdhëruar të paditurin E. B. të mos e përsërisë në të ardhmen cenimin mbi këtë dhomë. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

Neni 317 i Kodit të Procedurës Civile përcakton rastet kur gjykata jep vendim me ekzekutim të përkohshëm:

- a) detyrimi për ushqim;
- b) për shpërblimin nga puna;
- c) për rivendosjen në posedimin e banesës bashkëshortore.

Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast, gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci.

Nga përmbajtja e vendimit dhe të dhënat e akteve bashkëlidhur nuk rezulton që marrëdhënia objekt gjykimi të jetë detyrim për ushqim, shpërblim dëmi nga puna apo banesa objekt gjykimi të jetë pronë bashkëshortore. Gjithashtu, nuk rezulton që subjekti të ketë kërkuar nga pala paditëse garanci për ekzekutimin e përkohshëm. Në këto kushte, subjekti ka disponuar vendimin në kundërshtim me këtë dispozitë të ligjit procedural.

Në lidhje me pretendimet e tjera të denoncuesit, rezulton se kanë të bëjnë me themelin e çështjes, për të cilën në referim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, Komisioni nuk ka kompetencë vlerësimi.

Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provë, për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket që subjekti ka dhënë vendim me ekzekutim të përkohshëm në kundërshtim me nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se ka dhënë vendimin me ekzekutim të përkohshëm në bazë të nenit 317/c të Kodit të Procedurës Civile për rivendosjen në posedimin e dhomës së banimit. Kjo dispozitë është e aplikueshme në bazë të situatave të provuara në gjykim. Është bindja e brendshme e gjyqtarit për të dhënë vendimin e themelit me ekzekutim të përkohshëm ose jo, për më tepër që çështja është në shqyrtim në Gjykatën e Apelit dhe subjekti vlerëson se nuk është në kompetencë të Komisionit për shqyrtim, referuar edhe vendimit nr. 33/2021 të Kolegjit.

⁶⁵ Vendimet nr. ***, datë 2.10.1969 dhe nr. ***, datë 31.3.1970, të Gjykatës së Rrethit Tiranë; deklaratë datë 16.11.2006, e BKT-së; regjistrim hipotekor datë 28.1.1970; certifikatë pronësie datë 3.11.1970, e Hipotekës Tiranë; vërtetim datë 4.4.1972, i Bankës së Shqipërisë; preventiv etj.

Vlerësimi i Komisionit

Në lidhje me këtë prapësim, Komisioni vlerëson se ekzekutimi i përkohshëm është një veprim procedural dhe në kompetencë të Komisionit për t'u vlerësuar, por prapësimet e subjektit nuk janë bindëse për Komisionin.

Në lidhje me faktin që çështja është në gjykim pranë Gjykatës së Apelit dhe nuk mund të merret në shqyrtim nga Komisioni, rezulton se sipas akteve që ka paraqitur denoncuesi, me kërkesën ankimore të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 10.6.2022, është ankimuar vendimi nr. ***, datë 19.5.2022, i subjektit. Nga ana tjetër, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar faktin se ky ankim është regjistruar në Gjykatën e Apelit dhe është në pritje për gjykim. Vetëm ankimi nuk mjafton për të qenë të sigurt se kjo çështje është në gjykim pranë Gjykatës së Apelit, pasi pala ankuese mund edhe të ketë hequr dorë nga ankimi dhe, për këto arsye, ky prapësim nuk merret në konsideratë nga Komisioni.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti ka dhënë vendim me ekzekutim të përkohshëm në kundërshtim me nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile.

41. Denoncimet nr. *, datë 25.1.2019 dhe nr. ***, datë 26.7.2018, të shtetasi A. B. B.,** i cili denoncon subjektin për shkelje ligjore, pasi ka njohur trashëgimtarë të pronës personat që kanë vjedhur mbiemrin e familjes, ndërsa trashëgimtarët e vërtetë nuk figurojnë gjëkund. Bashkëlidhur denoncuesi ka depozituar disa akte në lidhje me identitetin e paraardhësit të tij dhe në lidhje me pronat e paluajtshme të tij. Në denoncimin nr. ***, përmenden shumë subjekte të rivlerësimit, përfshirë edhe z. Arben Kostandini. Midis këtyre akteve janë edhe vendimet gjyqësore nr. ***, datë 13.2.1996 dhe nr. ***, datë 9.8.1996, që ka marrë subjekti i rivlerësimit për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë së trashëgimlënësve I. dhe E. C.

Nisur nga data e vendimit gjyqësor, rezulton se çështja për të cilën ngre pretendime denoncuesi është jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 41, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më lart, Komisioni nuk mund të marrë në shqyrtim këtë denoncim.

42. Denoncim nr. *, datë 23.11.2021, i shtetasit V. S.,** i cili pretendon se subjekti po gjykon kërkesëpadinë që denoncuesi ka ngritur kundër motrave të tij S. B., M. B., L. Q.. Që në vitin 2018 dhe deri në datën e denoncimit nuk është zhvilluar asnjë seancë gjyqësore, por vetëm 3 seanca përgatitore brenda një viti. Denoncuesi ka depozituar dy kërkesa për sigurim padie, por subjekti nuk ka respektuar procedurën, pasi nuk është shprehur për këto kërkesa brenda 5 ditëve, madje ka refuzuar t'i marrë në shqyrtim. Në një seancë përgatitore, subjekti është shprehur se do ta rrëzojë kërkesëpadinë, duke paragjykuar kështu çështjen. Denoncuesi pretendon se subjekti ka abuzuar me detyrën duke bërë sarkazëm në seancat përgatitore. Denoncuesi ka bërë kërkesë për përjashtimin e subjektit nga gjykimi.

Komisioni, pasi administroi⁶⁶ e shqyrtoi dosjen e çështjes civile të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, me paditës V. S., të paditur S. B., M. B., L. Q., etj., person i tretë "Credins Bank", me objekt "1) Konstatim i pavlefshmërisë së pjeshme absolute të aktmarrëveshjes së qirasë nr. ***, datë 4.8.2017, e lidhur midis të paditurve dhe Bankës Credins, si dhe të deklaratës noteriale nr. ***, datë 4.8.2017; 2) detyrimin e të paditurve të më njohin pjesën time takuese prej 36.5 m² si bashkëpronar në ¼ pjesë ideale të pasurisë dyqan me sip. 146 m², të trashëguar nga babai dhe dhënë me qira 'Credins Bank'; 3) detyrimin e të paditurve të më kthejnë të ardhurat e munguara nga data 1.4.2017 e në vazhdim të pjesës sime prej 36.5 m² që i kanë përfituar me keqbesim nëpërmjet aktmarrëveshjes me 'Credins Bank'; 4) detyrimin e 'Credins Bank' të më paguajë të njëjtën vlerë për metër katror/muaj, për të cilën ka rënë dakord në

⁶⁶ Me shkresën nr. ***, datë 18.1.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

aktmarrëveshjen e qirasë datë 4.8.2017, por duke përllogaritur pjesën time takuese prej 36.5 m²”, vëren se:

- Çështja është regjistruar në datën 10.10.2019. Me vendimin datë 29.10.2019, “Për veprimet paraprake”, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet paraprake dhe caktimin e seancës përgatitore në datën 7.2.2020 (ora 12:00). Sipas procesverbalit, seanca pasardhëse përgatitore mban datën 20.7.2020 dhe jo 7.2.2020, pra është zhvilluar rreth 9 muaj pas datës kur janë kryer veprimet paraprake. Nuk ka asnjë vendim që justifikon shtyrjen e datës së seancës përgatitore. Sipas procesverbaleve të seancave përgatitore rezulton se:

- Që nga data 20.7.2020 deri në datën 26.4.2022, subjekti ka zhvilluar 10 seanca përgatitore (deri në datën e denoncimit janë zhvilluar 7 seanca përgatitore). Pra, provohet pretendimi i denoncuesit se nga data e depozitimit të padisë deri në datën e denoncimit nuk janë zhvilluar seanca gjyqësore, por vetëm përgatitore. Ka rezultuar se seancat përgatitore janë shtyrë për shkaqe të arsyeshme.

Në vijim, edhe pse subjekti ka caktuar seancën e datës 10.11.2022, në dosje nuk gjendet procesverbali i seancës gjyqësore së kësaj date. Nuk ka as procesverbal për arsyet e moszhvillimit të seancës së datës 10.11.2022 apo të shtyrjes së saj.

Nga procesverbalet e seancave rezulton se çdo seancë përgatitore është mbajtur në zyrën e subjektit, i cili nuk ka përshtetur në procesverbal arsyet e moszhvillimit të seancës audio dhe as orën e fillimit të seancës. Këto veprime janë kryer në kundërshtim me nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte, Komisioni nuk mund të konkludojë nëse janë të vërteta pretendimet e denoncuesit se në një seancë përgatitore subjekti është shprehur që do të rrëzojë kërkesëpadinë, duke paragjykuar kështu çështjen dhe se subjekti ka abuzuar me detyrën, duke bërë sarkazëm në seancat përgatitore.

Në seancën përgatitore datë 10.6.2021, paditësi i ka paraqitur subjektit kërkesën për sigurim padie, e cila duhej të shqyrtohej brenda 5 ditëve dhe, meqë nuk është shqyrtuar, i ka kërkuar që ta shqyrtojë në seancën e kësaj date. Subjekti, me vendimin datë 10.6.2021, e ka rrëzuar këtë kërkesë.

Nga përmbajtja e vendimit datë 10.6.2021, rezulton se paditësi, si masë për sigurimin e padisë ka kërkuar që: 1) “Credins Bank” të derdhë qiranë mujore prej 3,212 euro, që u përket palëve ndërgjyqëse në një llogari të ngrirë pa të drejtë tërheqjeje deri në datën kur vendimi gjyqësor i themelit të marrë formë të prerë; 2) bllokimin pranë ZVRPP-së Tiranë të pasurisë së paluajtshme që i kanë dhënë me qira “Credins Bank” për të penguar tjetërsimin e kësaj prone.

Në vendimin me të cilin ka rrëzuar kërkesën për sigurim të padisë, subjekti arsyeton se: “...kjo kërkesë nuk mund të pranohet, pasi vjen në kundërshtim me praktikën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendimi unifikues nr. 10/2004), ku kërkesa për sigurim padie është ngritur pasi është ngritur padia në datën 10.10.2019 e, për pasojë, nuk ka shkak të paraqitet më vete si kërkesë. Kërkesa e paraqitur në gjykatë në kushtet e nenit 204 të Kodit të Procedurës Civile është e pabazuar, pasi paraqitja në kushtet e këtij neni përbën një lejim për shqyrtim ekstraordinar të këtij kërkimi, përtej procedurës normale të parashikuar nga neni 202 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykata vëren se paditësi nuk ka paraqitur asnjë argument apo provë për të qartësuar gjykatën për këtë moment procedural të shqyrtimit të kërkesës së tij, çka e bën kërkesën e tij të pabazuar në ligj”.

Neni 203 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë. Neni 204 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të

sigurohet padia. Nga përmbajtja e këtyre dy dispozitave është e qartë se ligjvënësi ka përcaktuar dy momente kur paditësi ka të drejtë të kërkojë sigurimin e padisë: para fillimit të gjykimit dhe gjatë gjykimit në çdo fazë të tij. Këto dy dispozita lejuese e lënë në vullnetin e paditësit zgjedhjen e momentit se kur duhet të paraqesë kërkesën.

Në vendimin unifikues nr. 10/2004, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se: *“Gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtu, shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë, që të shmangë çdo lloj perceptimi sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim.*

Në radhë të parë, gjykata duhet të vlerësojë nëse masa e përkohshme për sigurimin e padisë është në përshtatje me kërkesat e nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile, në veçanti nëse ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit eventual për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Masa e sigurimit nuk mund të merret për t’u rivendosur gjendja e mëparshme e marrëdhënies kontraktore midis palëve, ashtu siç ka ekzistuar para lindjes së mosmarrëveshjes. Në asnjë rast nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkohshme të sigurimit të padisë urdhërimi që i padituri të kryejë atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri. E thënë ndryshe, masa e përkohshme e sigurimit të padisë, që vendoset nga gjykata, nuk ka kuptim të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmbushjen e kërkit të palës paditëse të shprehur në objektin e padisë”.

Parë nën dritën e këtij arsyetimi të Kolegjeve të Bashkuara, subjektit nuk i kërkohej të caktonte si masë sigurimi padie detyrimin e të paditurit, “Credins Bank”, që t’i paguante paditësit vlerën e plotë të qirasë që i takonte në raport me pjesën takuese të tij mbi sipërfaqen e pronës në bashkëpronësi të dhënë me qira, pasi ky detyrim kishte të bënte me themelin e padisë. Madje, as paditësi vetë nuk e ka kërkuar një gjë të tillë në kërkesën e tij për sigurim padie, por ka kërkuar që “Credins Bank” të derdhte qiranë në një llogari të ngurtësuar, nga e cila bashkëpronarët e tjerë qiradhënës të mos përfitonin, përveç vlerës së tyre, edhe vlerën që i takonte paditësit, vlerë e cila ekzistonte rreziku që të mos ia kthenin këtij edhe nëse pranohej padia, përderisa ata kishin vepruar deri tani në keqbesim ndaj tij. Pra, subjekti padrejtësisht ka rrëzuar kërkesën për sigurim padie.

Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket që subjekti i rivlerësimit ka zvarritur për 9 muaj procesin gjyqësor; nuk ka mbajtur procesverbal për zhvillimin e një seance gjyqësore dhe nuk ka zhvilluar seanca përgatitore audio, veprime këto në kundërshtim me nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe ka rrëzuar kërkesën e paditësit për sigurim padie, duke vepruar në kundërshtim me nenet 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me zvarritjen e procesit për 9 muaj, subjekti ka shpjeguar në prapësime se gjatë kësaj periudhe nga pala paditëse është saktësuar dy herë objekti i padisë, si dhe ka ndërruar jetë një nga të paditurit, për të cilin është bërë kalimi procedural sipas nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile.

Në lidhje me mungesën e procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 10.11.2022, ajo ndodhet në dosjen gjyqësore dhe është zhvilluar me sistem audio në sallë dhe janë shënimet e seancës dhe CD audio (bashkëlidhur prapësimeve janë kërkesat për ndryshim objekti, zëvendësimet procedurale dhe procesverbali i seancës datë 10.11.2022, bashkë me CD).

Në lidhje me masën e sigurimit ka disponuar me rrëzimin e saj sipas arsytimit të vendimit.

Vlerësimi i Komisionit

Në lidhje me prapësimin e subjektit se zvarritja e procesit për 9 muaj ka ardhur sepse gjatë kësaj periudhe nga pala paditëse është saktësuar dy herë objekti i padisë, si dhe është bërë zëvendësim procedural, Komisioni referuar provave të paraqitura nga subjekti vlerëson se këto veprime procedurale nuk e justifikojnë periudhën shumë të gjatë prej 9 muajsh. Veprimet paraprake janë kryer në datën 29.10.2019 dhe saktësimi i objektit të padisë është bërë në datën 9.3.2020, ndërsa kërkesa për përcaktimin e vlerës së padisë mban datën 20.7.2020. Pra, në këtë periudhë 9-mujore janë kryer vetëm këto dy veprime procedurale. Kërkesa për zëvendësim procedural mban datën 27.9.2021, pra pas periudhës 9-mujore të zvarritjes.

Në lidhje me seancën e datës 10.11.2022, subjekti ka paraqitur procesverbalin e shkruar dhe CD-në, prandaj Komisioni merr në konsideratë prapësimet për këtë pikë.

Në lidhje me konstatimin se subjekti ka rrëzuar kërkesën e paditësit për sigurim padie, duke vepruar në kundërshtim me nenet 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, subjekti nuk ka paraqitur argumente bindëse për Komisionin, prandaj nuk merren në konsideratë.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur për 9 muaj procesin gjyqësor dhe ka rrëzuar kërkesën e paditësit për sigurim padie, duke vepruar në kundërshtim me nenet 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

43. Denoncim nr. *, datë 6.10.2020, i shtetasit R. S.,** i cili në denoncimin e tij përmend emrat e disa prokurorëve, gjyqtarëve dhe avokatëve për disa konflikte gjyqësore ndër vite ku ka qenë palë. Emrin e subjektit Arben Kostandini denoncuesi e përmend vetëm një herë (f. 4 e denoncimit), duke cituar: *“Gjyqtari Arben Kostandini, i njëjti gjyqtar që 2 vite më parë e ka dërguar të njëjtën çështje për shqyrtim në Gjykatën Administrative, e shtyu çështjen për t’u dëgjuar në Gjykatën e Rrethit Tiranë për të 30-ën herë në datën 6.11.2020”*. Bashkëlidhur denoncimit, denoncuesi ka depozituar kopje të informacionit, datë 24.9.2020, nga faqja zyrtare e gjykatës, rreth procesit gjyqësor të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit Arben Kostandini.

Komisioni, pasi administroi⁶⁷ dhe shqyrtoi dosjen gjyqësore të çështjes, si dhe provat e paraqitura nga denoncuesi, vëren se kjo çështje me nr. *** është regjistruar në datën 1.3.2017 me paditës A. P., I. Sh., L. F., të paditur Bashkia Tiranë, I. S., me objekt: “1) konstatimi i pavlefshmërisë absolute të lejes së ndërtimit nr. ***, datë 14.2.1991, të lëshuar nga komiteti ekzekutiv Rajoni nr. ***, Tiranë, në emër të I. S. për ndërtimin e banesës 4 kate në rrugën “***”, Tiranë; 2) detyrimin e të paditurit I. S. të njohë paditësit si pronarë të truallit që zë ndërtesa me sip. 99 m² dhe 200 m² i blerë prej tij; 3) lirimimi dhe dorëzimi i truallit me sip. 200 m², zënë me ndërtim pa leje nga i padituri; 4) marrjen e masës së sigurimit duke mos lejuar tjetërsimin e truallit objekt gjykimi”.

Janë zhvilluar gjithsej 31 seanca që nga seanca e parë, datë 30.3.2017. Në seancën datë 28.6.2017, subjekti ka vendosur të kalojë në seancë gjyqësore, për të cilën ka caktuar datën 18.9.2017, pra rreth 3 muaj nga data e seancës paraardhëse. Numri i madh i seancave gjyqësore rezultojnë sepse janë shtyrë disa herë për shkaqe të arsyeshme; për 1 vit gjykimi i padisë ka qenë i pezulluar me kërkesën e paditësit; 7 seanca janë shtyrë për shqyrtimin e disa kërkesave të përsëritura të palëve për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga gjykimi, kërkesa të cilat janë rrëzuar të gjitha. Pra, nuk rezultojnë që seancat të jenë shtyrë pa shkaqe të arsyeshme. Për seancën e 29-të, datë 18.3.2020, nuk ka informacion, por rezultojnë që seanca pasardhëse e saj është caktuar në datën 8.7.2020, pra 3 muaj e 3 javë më vonë.

⁶⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.1.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Rezulton që e njëjta kërkesëpadi të jetë regjistruar për gjykim më parë, në datën 13.7.2016 dhe është shortuar subjekti për ta gjykuar. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 13.10.2016, ka konstatuar mungesën e kompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa ankim. Referuar vendimit unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara⁶⁸, subjekti ka disponuar drejt duke shpallur moskompetencën lëndore të çështjes, por nuk është e qartë arsyeja përse subjekti ka pranuar më pas të gjykojë sërish të njëjtën kërkesë-padi në gjykatën civile. Gjatë gjykimit nga subjekti në gjykatën civile, sipas procesverbalit të seancës gjyqësore datë 14.5.2019, paditësit kanë paraqitur vendimin nr. ***, datë 3.12.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, se duket që subjekti i rivlerësimit ka caktuar dy seanca me diferencë 3 muaj dhe 3 muaj e 3 javë nga seancat paraardhëse, duke zvarritur procesin gjyqësor, si dhe ka gjykuar një padi, e cila ishte në kompetencën lëndore të Gjykatës Administrative. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegojë përse ka gjykuar sërish në gjykatën civile të njëjtën kërkesëpadi, të cilën më parë e kishte kaluar për kompetencë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe të depozitojë kopjen e vendimit nr. *, datë 3.12.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.**

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se në datën 18.3.2020 nuk është zhvilluar seanca për shkak të pezullimit të gjykimeve nga Covid-19 dhe seanca është shtyrë në datën 8.7.2020. Me vendimin nr. ***, datë 13.10.2016, subjekti ka konstatuar mungesën e kompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo gjykatë ka ngritur pretendimin për konflikt kompetence në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. ***, datë 16.11.2016, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 13.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit. Në këto kushte ka qenë i detyruar nga vendimi i Gjykatës së Lartë që të vazhdonte gjykimin (bashkëlidhur si provë, vendimet gjyqësore të lartpërmendura).

Vlerësimi i Komisionit

Në lidhje me prapësimet, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime përse në datën 18.9.2017 ka caktuar seancën pasardhëse në datën 28.6.2017, pra 3 muaj më pas.

Në lidhje me seancën e datës 18.3.2020, subjekti ka paraqitur shënimin e sekretares gjyqësore, që vërteton se kjo seancë është shtyrë për në datën 8.7.2020 për shkak të pandemisë Covid-19. Ky prapësim është bindës për Komisionin.

Në lidhje me veprimin e subjektit që ka kërkuar kalimin e çështjes pranë Gjykatës Administrative Tiranë për shkak moskompetence lëndore, pasi kjo çështje ishte gjykuar më parë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioni, pasi shqyrtoi vendimin nr. ***, datë 16.11.2016, të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr. ***, datë 3.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vëren se vendimi gjyqësor nr. ***, datë 3.12.2018, nuk është administruar nga subjekti i rivlerësimit (siç ishte pretenduar nga denoncuesi) dhe, nga ana tjetër, me vendimin nr. ***, datë 16.11.2016, Gjykata e Lartë ka vendosur të prishë vendimin nr. ***,

⁶⁸ Kolegjet citojnë se: "...kur në objektin e gjykimit është kundërshtimi i një akti administrativ dhe nga pasojat e aktit prodhohen pasojat civile, në çdo rast kompetente është gjykata administrative".

datë 13.10.2016, që ka disponuar subjekti dhe dërgimin e çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vazhdimin e gjykimit. Në këto kushte, subjekti ka zbatuar vendimin e një gjykate më të lartë, e cila ka vlerësuar vendimmarrjen e tij.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur procesin gjyqësor, duke caktuar një seancë gjyqësore me 3 muaj diferencë nga seanca paraardhëse në vitin 2017.

44. Denoncim nr. *, datë 27.7.2018, i shtetasit T. Ç.,** i cili në denoncimin e tij ngre dyshime për afera korruptive, pasi vendimi gjyqësor është marrë “duke mbyllur sytë” për provat tërësisht në favor të palës tjetër. Në gjykim, gjykata thotë se është përmbushur kontrata e vitit 2014, por nuk shprehet për kontratën e vitit 2018, për të cilën denoncuesi ka shkuar në gjyq. Gjykata me dashje ka anashkaluar provën kryesore. Në vijim, denoncuesi pretendon se, megjithëse dëgjoi në gjyq që kontrata ishte lidhur në kushte mashtrimi, gjykata nuk bëri asgjë. Aftësitë profesionale të gjyqtarit dalin dukshëm në arsyetimin e vendimit. Qëndrim tërësisht i anshëm i gjykatës dhe mohim tërësisht i ligjit. Bashkëlidhur denoncimit, janë depozituar kërkesëpapia, vendimi gjyqësor nr. ***, datë 10.10.2017, që është marrë nga subjekti i rivlerësimit, kontratat dhe aktmarrëveshja objekt gjykimi.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, Komisioni vëren se, përveç pretendimit për afera korruptive që mbetet në kuadrin e dyshimit pasi denoncuesi nuk paraqiti asnjë provë për këtë, pretendimet e tjera në denoncim kanë të bëjnë me themelin e çështjes, për të cilën në referim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, Komisioni nuk ka kompetencë vlerësimi.

Për sa më lart, Komisioni nuk mund të marrë në shqyrtim këtë denoncim.

45. Denoncim nr. *, datë 29.1.2019, i shtetasit A. B.,** i cili në formularin e denoncimit citon vetëm emra të disa gjyqtarëve, si dhe numrin e datën e vendimit gjyqësor që ka disponuar secili prej tyre. Bashkëlidhur denoncimit janë depozituar vendimet gjyqësore të cituara në denoncim. Komisioni vëren se të gjitha vendimet, përfshirë edhe tri vendimet: nr. ***, datë 15.11.1994, ku subjekti i rivlerësimit Arben Kostandini është ndihmësgjyqtar në përbërje të trupit gjykues; nr. ***, datë 30.5.1996, si kryetari i trupit gjykues; nr. ***, datë 29.9.1994, si ndihmësgjyqtar i trupit gjykues, pra vendimet e disponuara nga subjekti i rivlerësimit janë jashtë periudhës së rivlerësimit të përcaktuar nga neni 41, pikat 3 dhe 4 e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më lart, Komisioni vlerëson të mos e marrë në shqyrtim këtë denoncim.

46. Denoncim nr. *, datë 28.2.2018, e shtetas N. Gj.,** e cila pretendon se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, për të cilin është nxjerrë një herë urdhër ekzekutimi nga një gjyqtar tjetër dhe ky urdhër ekzekutimi i dytë po i sjell pasoja të rënda. Bashkëlidhur denoncimit janë depozituar disa akte, nga ku rezulton se:

Me vendimin nr. ***, datë 10.10.2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁹ ka vendosur, midis të tjerash, pranimin e kërkesëpadisë; lirimin dhe dorëzimin e sendit kur paditësi R. F. të shlyejë shumën 2,993,000 lekë në favor të M. e A. S.; pasqyrimin e pavlefshmërisë kontratave në ZVRPP-në Tiranë dhe kalimin e apartamentit me sip. 50.6 m² në favor të paditësit R. F.; detyrimin e të paditurve M. e A. S. të shpërblejnë paditësin për përdorimin e sendit në shumën 30,000 lekë/muaj, duke filluar nga data 23.2.2005 deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi.

Në lidhje me ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 10.10.2005, janë disponuar nga gjyqtarë të ndryshëm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dy urdhër ekzekutime: nr. ***, datë 11.7.2011 për pjesën e kreditorëve A. e M. S. dhe nr. ***, datë 15.6.2007. Më pas, subjekti

⁶⁹ Vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 7.5.2007.

i rivlerësimit ka disponuar me vendimin nr. ***, datë 21.3.2017, duke pranuar kërkesën e kërkuases F. R. për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 10.10.2005, për pjesën e këtij vendimi që i përket kreditores F. R. dhe debitorës N. Gj.. Në vendim, subjekti citon se vendimi gjyqësor nr. ***, datë 10.10.2005, nuk është ekzekutuar vullnetarisht.

Në referim të nenit 513, paragrafi 2, i cili përcakton se: *“Kur duhet të dorëzohen disa pasuri të veçanta ose kur titulli ekzekutiv është dhënë në dobi ose kundër disa personave, mund të lëshohen urdhra ekzekutimi të veçantë, duke shënuar se cila pjesë e titullit duhet të ekzekutohet për çdo urdhër ekzekutimi”*, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka kryer ndonjë veprim në kundërshtim me këtë dispozitë apo ndonjë dispozitë tjetër të Kodit të Procedurës Civile.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.

47. Denoncim nr. *, datë 30.3.2018, i shtetasve E. A. dhe B. R.,** të cilët pretendojnë se me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 6.3.2018, gjyqtari Arben Kostandini ka rrëzuar kërkesëpadinë e tyre. Bashkëlidhur denoncimit janë depozituar parashtrimet përfundimtare gjatë gjykimit të çështjes nga subjekti i rivlerësimit, si dhe kërkesa ankimore drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë ndaj vendimit të subjektit.

Nga shqyrtimi i këtyre akteve, Komisioni vëren se pretendimet e denoncuesve kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe vetëm në kërkesën ankimore drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, pretendojnë se është zbatuar keq procedura duke cituar nenet 6, 309, etj. të Kodit të Procedurës Civile, duke pretenduar për gjykim skandaloz e të paprecedentë.

Komisioni, pasi administroi⁷⁰ e shqyrtoi kopje të dosjes së gjykuar me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 6.3.2018, vëren se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar çështja civile nr. ***, datë 21.11.2016, me paditës B. R. dhe E. A., të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Civile të Prefekturës së Qarkut Tiranë, person i tretë Sh. B., me objekt “1) shfuqizim i aktit administrativ përgjigje nr. ***, datë 8.11.2016, e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ***) detyrim i zyrës së gjendjes civile të Prefekturës së Qarkut Tiranë që në aktin e vdekjes së A. R. të shënohet dhe akti i vdekjes së bashkëshortes së tij legjitime S. R. për t’u pasqyruar në certifikatën e vdekjes së A. R., në të cilën mungon sot etj.”.

Në përfundim të gjykimit, subjekti, me vendimin nr. ***, datë 6.3.2018, ka rrëzuar kërkesëpadinë si të pabazuar në prova e në ligj. Kundër këtij vendimi, paditësit kanë paraqitur ankim. Gjykata e Apelit Tiranë konfirmon se kjo çështje është regjistruar, por nuk është planifikuar për gjykim.

Nuk rezulton që subjekti të ketë zbatuar keq procedurën në referim të neneve 6, 309 etj. të Kodit të Procedurës Civile, siç pretendon denoncuesi, por nga shqyrtimi i vendimit që ka administruar subjekti, Komisioni vëren se në pjesën hyrëse të tij subjekti citon se: *“Ndodhemi para një mosmarrëveshjeje që buron nga një marrëdhënie pronësie dhe se paditësi pretendon se i janë shkelur të drejtat personale pasurore”*. Në fakt, mosmarrëveshja ka natyrë administrative, që lidhet me pavlefshmërinë dhe ndryshimin e akteve të gjendjes civile. Në asnjë rast nuk citohet në padi ndonjë pronë dhe as pretendohet ndonjë e drejtë pronësie nga paditësit. Si rrjedhojë e këtij arsytimi, subjekti ka gabuar në përcaktimin e kompetencës

⁷⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.1.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën nr. *** prot., datë 9.1.2023, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

lëndore të gjykatës, pasi ka vlerësuar se kjo gjykatë është kompetente për gjykimin e kësaj padie.

Neni 7, germa “a” e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, përcakton se *gjykatat administrative janë kompetente për mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative...; neni 17 i këtij ligji përcakton se padia ngrihet:*

- a) *për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;*
- b) *për ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ apo detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ;*
- c) *për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;*

Neni 3 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton se akti administrativ individual është çdo shprehje vullneti nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.

Në referim të dispozitave të mësipërme dhe të vendimit nr. ***, datë 21.3.2017, të Kolegjit Administrativ, kompetente për gjykimin e çështjes konkret, është gjykata administrative e shkallës së parë dhe jo gjykata e rrethit gjyqësor.

Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit se duket që subjekti i rivlerësimit ka gabuar në përcaktimin e kompetencës gjyqësore të çështjes që ka gjykuar, në kundërshtim me nenin 41 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 7, germa “a” e ligjit nr. 49/2012.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se vetë paditësit e kanë bërë objektin e padisë herë në lidhje me plotësimin apo korrektimin e akteve të gjendjes civile, herë në lidhje me vërtetimin e fakteve familjare të ndodhura ndër vite. Ky lloj gjykimi bëhet për përfituar pronat që ndodheshin në Greqi.

Nga vetë natyra e kërimit të paditësve, objekti i padisë është i ndërthurur si vërtetim fakti me aktet e gjendjes civile dhe vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka qenë kompetente për shqyrtimin e kësaj padie. Kjo çështje është ende në shqyrtim dhe, sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, subjekti pretendon se nuk mund të shqyrtohet nga Komisioni.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe aq më tepër të mos e marrë në konsideratë prapësimin se kjo çështje është në gjykim pranë Gjykatës së Apelit dhe jo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka gabuar në përcaktimin e kompetencës gjyqësore të çështjes që ka gjykuar në kundërshtim me nenin 41 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 7, germa “a” e ligjit nr. 49/2012.

48. Denoncim nr. *, datë 17.5.2018, i shtetasit G. B., i cili pasi përmend emrat e 5 gjyqtarëve dhe disa shkelje të kryera prej tyre, për subjektin e rivlerësimit Arben Kostandini pretendon se ka dhënë vendim të gabuar dhe në bashkëpunim me vlerësuesen B. L. i kanë sjellë dëm të pariparueshëm gjatë vlerësimit të pronës së denoncuesit, që ishte objekt gjykimi. Subjekti i rivlerësimit ka pranuar një aktekspertim jo të rregullt dhe e ka bërë qëllimisht për të favorizuar palën kundërshtare.**

Nga përmbajtja e denoncimit dhe provave bashkëlidhur⁷¹, nuk rezulton që denoncuesi të ketë ngritur ndonjë pretendim për shkelje procedurale, por për vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit që i përket themelit të çështjes. Në referim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, për themelin e çështjeve, Komisioni nuk ka kompetencë vlerësimi.

Për sa më lart, Komisioni nuk mund të marrë në shqyrtim këtë denoncim.

49. Denoncim nr. *, datë 12.12.2022, i shtetases R. K.,** e cila denoncon subjektin e rivlerësimit për njëanshmëri të theksuar në gjykim, shkelje ligjore shumë të rënda, pasi gjyqtari nuk i merr në konsideratë provat e saj të pakontestueshme. Ka edhe shkelje procedurale.

Bashkëlidhur denoncimit është depozituar vërtetimi datë 26.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që konfirmon se pranë kësaj gjykate është duke u gjykuar nga subjekti i rivlerësimit çështja civile me paditës D., E., P. K. dhe E. L., i paditur R. K., me objekt “1) pjesëtim i sendeve në bashkëpronësi pasuri e paluajtshme nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, sip. 62.5 m², apartament në rrugën ‘****’, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. *** dhe pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, sip. 65,70 m², rruga ‘****’, shk. ***, ap. ***) pasqyrimi i ndryshimeve të dy pasurive në regjistrat kadastralë pranë Drejtorisë Vendore Tirana Veri”.

Meqenëse çështja është në proces gjykimi nga subjekti i rivlerësimit, në bazë të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni nuk mund të ndërhyjë për të administruar dosjen gjyqësore dhe për të vlerësuar veprimet e subjektit, për sa kohë nuk ka përfunduar gjykimin.

Për sa më lart, Komisioni vlerëson të mos e marrë në shqyrtim këtë denoncim.

50. Denoncim nr. *, datë 8.10.2018, i shtetasit Y. H.,** i cili denoncon subjektin e rivlerësimit Arben Kostandini dhe prokurorin J. Xh., duke pretenduar se kanë bashkëvepruar me njëri-tjetrin në shkelje të ligjit, në tejkalim kompetencash të Kushtetutës dhe shpërdorim detyre. Këto subjekte kanë arrestuar denoncuesin në zyrën e tij, pa e thirrur dhe pa e pyetur ndërkohë që ky nuk ka pasur dijeni për kallëzimin e bërë ndaj tij. Për një vit e gjysmë nuk është thirrur as nga gjykata, as nga prokuroria. Dosja e tij ka qëndruar 1 vit e ca në sirtarët e Prokurorisë. Subjektet nuk kanë pasur asnjë provë dhe kjo vërtetohet nga fakti që gjykimin është mbyllur për mungesë provash.

Bashkëlidhur denoncimit janë depozituar disa dokumente nga dosja penale.

Në denoncimin e tij përmenden më shumë shkelje të organit të akuzës. Komisioni, pasi administroi⁷² dhe shqyrtoi kopjen e fashikullit të dosjes penale, vëren se në datën 29.12.2015 është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “përndjekje” ndaj shtetasit Y. H.

Me vendimin nr. ***, datë 22.7.2016, subjekti i rivlerësimit ka pranuar kërkesën, datë 21.7.2016, të prokurorit J. Xh. dhe ka caktuar masën e sigurimit “arrest me burg” ndaj shtetasit Y. H. për veprën penale “përndjekje”. Nga përmbajtja e akteve rezulton se ekzistojnë kushtet e përcaktuara nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit personal, ndërsa në lidhje me llojin e masës së sigurimit Komisioni vlerëson se nisur nga rrethanat e çështjes dhe lloji i dënimit, që parashikohet për këtë veprë penale, ka vend për masën e sigurimit personal “arrest me burg”, por sidoqoftë kjo mbetet në bindjen e brendshme të subjektit të rivlerësimit.

⁷¹ Vendimi nr. ***, datë 16.11.2015, që ka disponuar subjektin e rivlerësimit dhe disa akte të tjera.

⁷² Me shkresën nr. *** prot., datë 18.1.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Mbi ankimin e shtetasit Y. H., Gjykata e Apelit Tiranë⁷³ ka zëvendësuar masën e sigurimit “arrest në burg” me “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

Për sa më lart, Komisioni nuk vëren mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.

51. Denoncim nr. *, datë 18.5.2018, i shtetasit L. B.,** i cili denoncon për vendimmarrje në shkelje të ligjit me vendime gjykate të rrëzuara. Gjyqtarët që përmenden në vendimet bashkëlidhur denoncimit kanë abuzuar me detyrën dhe denoncuesi ka vuajtur një dënim të padrejtë, të pambështetur në prova e fakte reale. Çështja ka nisur që në vitin 2005 dhe vazhdon për 13 vjet deri në datën e denoncimit. Vendimet gjyqësore janë marrë në mungesë të denoncuesit dhe proceset gjyqësore janë të parregullta.

Bashkëlidhur denoncimit janë depozituar disa vendime gjyqësore dhe prokurorie, nga të cilat vetëm vendimi gjyqësor nr. ***, datë 19.9.2005, është disponuar nga subjekti i rivlerësimit, pra ky vendim është marrë jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 41, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më lart, Komisioni vlerëson të mos marrë në shqyrtim këtë denoncim.

52. Në përmbledhje të prapësimeve lidhur me kontrollin e aftësive profesionale, subjekti ka shpjeguar se konstatimet e Komisionit nuk qëndrojnë, por edhe sikur të qëndronin, nuk konstatohen gabime që tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar; nuk konstatohet asnjë pasojë e ardhur për palët, asnjë pavlefshmëri, asnjë papërdorshmëri, asnjë kufizim i lirive personale apo ndonjë pasojë tjetër e kësaj natyre. Komisioni, për gjithë periudhën shumëvjeçare të subjektit në detyrë ka konstatuar “gjetje” vetëm për pak raste, të cilat, edhe pse subjekti pretendon se nuk qëndrojnë, nuk konstatohen si shkelje e rëndë.

53. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në prapësimet e tij subjekti pretendon se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit; referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, ka arritur nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit nr. 84/2016; referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016 ka arritur nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit nr. 84/2016.

54. Për sa më lart, subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit profesional

i. Në përmbledhje të konkluzioneve, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit:

- Në 6 raste, në procesverbalet e seancave nuk ka përshkruar orën e fillimit të seancës.
- Në një rast, dosjen gjyqësore e ka dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 11.12.2013, pra 14 ditë nga shpallja e vendimit, duke shkelur afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.
- Në dy raste ka gabuar në përcaktimin e kompetencës gjyqësore të çështjes që ka gjykuar në kundërshtim me nenin 41 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 7, germa “a” e ligjit nr. 49/2012.

⁷³ Me vendimin nr. ***, datë 25.8.2016.

- Në një rast ka shkelur nenet 125, 224/c paragrafi 4, 297, 371 të Kodit të Procedurës Civile, duke pezulluar pa shkak ligjor gjykimin dhe duke mos disponuar me vendim të ndërmjetëm në lidhje me kërkesën e parë të palës së paditur për përjashtimin e ekspertit.
 - Në një rast ka dhënë vendim me ekzekutim të përkohshëm në kundërshtim me nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile.
 - Në një rast ka zvarritur për 9 muaj procesin gjyqësor dhe ka rrëzuar kërkesën e paditësit për sigurim padie, duke vepruar në kundërshtim me nenet 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.
 - Në një rast ka caktuar një seancë gjyqësore me 3 muaj diferencë nga seanca paraardhëse në vitin 2017, duke zvarritur kështu procesin gjyqësor.
- ii.** Referuar analizës së raportit të hartuar nga Grupi i Punës në KLGJ, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, trupi gjykues vlerëson se në vështirimin e përgjithshëm, duke pasur parasysh llojin dhe sasinë e shkeljeve në raport me periudhën e gjatë në detyrë dhe numrin e çështjeve të gjykuara nga subjekti, nuk janë konstatuar shkelje serioze e të përsëritura të natyrës procedurale, gabime thelbësore apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e veprimeve hetimore dhe vlerësimit të çështjeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar nenit Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, krerëve V, VI dhe VII të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Arben Kostandini:

- a. Lidhur me kriterin e pasurisë rezultoi se ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.
- d. Në vlerësimin tërësor të çështjes, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u

mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/c të nenit 58, si dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Kostandini, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 15.3.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj